

**ETIKA E SJELLJES SEKSUALE
NË RADHËT E STUDENTËVE SHQIPTARË**


DORINA ZENELAJ

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës në
Shkenca Sociale, me profil Sociologji-Antropologji Sociale, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor
Prof. Dr. FATOS TARIFA

Numri i fjalëve: 60.029

Tiranë, tetor 2015



DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim i shkruar prej meje, në kërkim të gradës Doktor Shkencash në Sociologji, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar në tërësi, ose në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara. Studimi është punuar me përgjegjshmëri të plotë, duke respektuar të gjitha rregullat akademike dhe etike të shkrimit të një disertacioni. Të gjitha përfundimet shkencore të autorëve të tjerë, të përdorura për analizën teorike dhe empirike, janë deklaruar me korrektësi, sipas punimit origjinal në formë reference brenda në tekst dhe të plota në bibliografinë e studimit. Asnjë pjesë e këtij studimi nuk mund të kopjohet, riprodhohet apo shumëfishohet pa leje të autorit të këtij disertacioni.

E drejta e autorit © 2015. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE

Janë të shumtë ata që dëshiroj të falënderoj dhe t'iu shpreh mirënjohjen për të gjithë mbështetjen e dhënë në këtë studim. Fillimisht, falënderoj Universitetin Europian të Tiranës për mundësinë që më dha për ndjekjen e studimeve të doktoraturës, të gjithë stafin akademik të këtij universiteti me të cilët pata fatin të shkëmbejë eksperiencë të vyera profesionale e akademike. Mund të jenë të shumta pengesat, vështirësitë apo sfidat që kanë dalë gjatë rrugës së punimit të këtij disertacioni, të cilat pa mbështetjen, sugjerimet dhe gatishmërinë e udhëheqësit shkencor, Prof. Dr. Fatos Tarifa, do të ishin krejt të pamundura të kapërceheshin. Me dëshirën dhe bindjen që ky studim t'u jetë afuar sadopak kërkesave shkencore dhe akademike të Prof. Tarifës, i shpreh mirënjohje dhe falënderime të sinqerta për pranimin e kërkesës për të qenë udhërrëfyesi im në këtë punë të madhe, si dhe për të gjithë suportin dhe orientimet e dhëna në çdo hap të këtij punimi. Ky punim do të ishte i pamundur pa këtë mbështetje. Për rrjedhojë, sukcesi është yni, dështimi më mbetet mua.

Gjithashtu, falënderoj të gjithë studentët, pedagogët, shefat e departamenteve përkatëse të çdo universiteti, për pjesëmarrjen dhe mbështetjen gjatë mbledhjes së të dhënave të këtij studimi. Kjo fazë u përmbush me sukses vetëm falë jush. Falënderoj miqtë e mi, Tanin, Floridën, Visarin, Kelën dhe Armandin, të cilët më qëndruan pranë gjatë gjithë këtij udhëtimi. Suporti juaj, për të përmbushur me sukses këtë sfidë më ka dhënë më shumë forcë dhe siguri. Familja ime, së cilës edhe ia dedikoj gjithë këtë punë, ka dhënë mbështetjen maksimale emocionale dhe financiare, duke e bërë më të lehtë rrugën time.

Mirënjohje të thellë për të gjithë JU!

Abstrakt

Ky studim përveç vlerësimit të sjelljes seksuale dhe etikës së studentëve, identifikon impaktin që kanë institucionet sociale si: familja, bashkëmoshatarët, institucionet e arsimit, institucionet fetare dhe media në etikën dhe sjelljen seksuale të studentëve në Shqipëri. Studimi analizon se cili prej institucioneve sociale mund të modelojë sjellje seksuale etike, duke drejtuar vëmendjen drejt nevojës për një etikë të re seksuale dhe jo te edukimi seksual i brezave të rinj mbështetur mbi bazat e një morali të vjetruar. Për këtë studim u anketuan 1213 studentë dhe u intervistuan ballë për ballë 100 të tjerë. Metodologjia e përdorur në këtë studim është ajo e triangulacionit, ku u përdorën procedura të kampionimit të shtresëzuar/rastësor dhe atij me kuota, e rezultatet e të dhënave u analizuan nëpërmjet analizës statistikore/ekonometrike dhe asaj tematike. Rezultatet vërtetuan që ekzistojnë marrëdhënie mes variabëlve të studimit, por edhe se media e bashkëmoshatarët janë institucionet me impakt pozitiv në sjelljen seksuale, ndërkohë që institucionet e arsimit, institucionet fetare dhe familja kanë një impakt negativ. Deri më sot, në Shqipëri, asnjë prej institucioneve më lart nuk garanton edukim seksual mbështetur mbi një etikë të re seksuale në kushtet e një revolucioni seksual. Rekomandohen ndërhyrje imediate në edukimin seksual në institucionet e arsimit, të cilat këshillohen të orientohen drejt programeve gjithëpërfshirëse.

Fjalët Kyçe: *Sjellje seksuale, etikë, institucione sociale, studentë.*

Abstract

Apart from the assessment of sexual behavior and ethics of students, this study identifies the impact of social institutions such as family, peers, educational institutions, religious institutions and media on the sexual behavior and ethics of students in Albania. The study analyses which of social institutions can model ethical sexual behaviors, channeling the attention to the need for a new sexual ethics and not for a sexual education of young generations based on an outdated morality. 1213 students were surveyed and 100 others were subject to face-to-face interviews. The methodology applied in this study is the one of triangulation, where layered/random sampling procedures were used and the quota-based one. Data results were analyzed through the statistical, econometric and thematic analysis. The study results confirmed a relationship between the study variables and that media and peers are positive factors on the sexual behavior. Meanwhile, the religious educational institutions and family have a negative impact. To date, none of the foregoing institutions in Albania guarantees sexual education based on a new sexual ethics in the conditions of a sexual revolution. Immediate interventions are recommended in the sexual education in educational institution, to be advised for a proper orientation to comprehensive programs.

Keywords: *Sexual behavior, ethics, social institutions, students.*

TABELA PËRMBLEDHËSE

Deklarata e Autorësisë.....	I
Falenderime dhe Mirënjohje.....	II
Abstrakt.....	III
Tabela Përmbledhëse.....	V
Lista e Figurave.....	XI
Lista e Tabelave.....	XII
Lista e Grafikëve.....	XIV

KAPITULLI I : PARATHËNIA. 1-40

1. 1. Morali dhe etika e sjelljes seksuale në shoqërinë shqiptare.	1
1. 2. Revolucioni seksual shqiptar dhe ndryshimet në sjelljen seksuale.	8
1. 3. Etika e re e sjelljes seksuale.	14
1. 4. Korniza teorike ku mbështete ky studim.	21
1. 5. Shtrimi i problematikës/ Pse ky studim?.	26
1. 6. Qëllimi i studimit dhe objektivat e studimit.	29
1. 7. Pyetjet kërkimore.	30
1. 8. Modeli konceptual i studimit dhe hipotezat kërkimore.	31
1. 9. Përkufizimet operacionale.	33

1. 10. Përqasja metodologjike e studimit.	36
1. 11. Impakti shkencor i studimit.	36
1. 12. Limitet e studimit.	38
KAPITULLI II: RISHIKIM LITERATURE.	41-111
2. 1. Impakti i familjes në sjelljen seksuale etike të studentëve.	41-57
2. 1. 1. Struktura e familjes shqiptare dhe impakti në sjelljen seksual të të rinjve. .	41
2. 1. 2. Format e komunikimit seksual në familje.	42
2. 1. 3. Sjellja seksuale e fëmijëve me një prind.	50
2. 1. 4. Dallimet gjinore në komunikimin seksual mes prindërve dhe fëmijëve. . .	53
2. 2. Impakti i bashkëmoshatarëve në sjelljen seksuale etike.	58-66
2. 2. 1. Roli i bashkëmoshatarëve në fillimin dhe vazhdimin e aktivitetit seksual të studentëve.	58
2. 2. 2. Normat sociale dhe sjellja seksuale mes bashkëmoshatarëve.	61
2. 2. 3. Dallimet gjinore të sjelljeve dhe qëndrimeve seksuale mes bashkëmoshatarëve.	63
2. 3. Edukimit seksual në shkolla dhe sjellja seksuale e studentëve.	67-81
2. 3. 1. Edukimi seksual në shkollat shqiptare.	67
2. 3. 2. Programet e Abstinencës në edukimin seksual.	73
2. 3. 3. Programet gjithëpërfshirëse të edukimit seksual.	77
2. 4. Feja dhe impakti në sjelljen seksuale të studentëve.	82-95
2. 4. 1. Fryma fetare dhe sjellja seksuale.	82

2. 4. 2. Spiritualizmi dhe sjellja seksuale e studentëve.	91
2. 4. 3. Dallimet gjinore në besimin fetar dhe sjelljen seksuale.	93
2. 5. Ndikimi i medias në sjelljen seksuale të studentëve.	96-111
2. 5. 1. Media dhe impakti i saj në sjelljen seksuale të studentëve.	96
2. 5. 2. Televizioni dhe impakti i tij në sjelljen seksuale.	102
2. 5. 3. Impakti i internetit dhe i medias së shkruar në sjelljen seksuale.	106
2. 5. 4. Dallimet gjinore në sjelljen seksuale të modeluar nga media.	109
KAPITULLI III: METODOLOGJIA KËRKIMORE.	112-125
3. 1. Popullata për studim dhe procedurat e kampionimit.	112
3. 1. 1. Kampionimi i rastësishëm dhe me shtresëzim.	113
3. 1. 2. Kampionimi joprobabilitar me kuota.	115
3. 2. Instrumentet matëse.	117
3. 2. 1. Struktura e pyetësorit.	119
3. 2. 2. Struktura e intervistës.	121
3. 3. Modeli i analizës së të dhënave.	123
3. 3. 1. Modeli ekonometrik/statistikor.	123
3. 3. 2. Modeli i analizës tematike.	123
KAPITULLI IV: ANALIZA E TË DHËNAVE SASIORE.	126-159
4. 1. Karakteristikat demografike të kampionit sasior.	126
4. 2. Mesatarja e ponderuar e sjelljes seksuale dhe etikës.	132

KAPITULLI VI: DISKUTIME

6. 1. Përfundime. 175

6. 2. Rekomandime. 188

BIBLIOGRAFIA.193

SHTOJCA245

A. Formati i pyetësorit. 246

B. Formati i intervistës. 258

C. Tabela të korrelacionit Pearson. 261

LISTA E FIGURAVE

Figura No. 1: Modeli konceptual i studimit.	31
Figura No. 2: Marrëdhëniet korrelative mes moralit të institucioneve sociale dhe sjelljes seksuale të studentëve.	135
Figura No. 3: Marrëdhëniet korrelative mes familjes, bashkëmoshatarëve, medias dhe sjelljes seksuale të studentëve.	137
Figura No. 4: Marrëdhënia korrelative mes institucioneve arsimore dhe atyre fetare me sjelljen seksuale.	140
Figura No. 5: Marrëdhënia korrelative mes institucioneve sociale dhe etikës së sjelljes seksuale.	143
Figura No. 6: Marrëdhënia korrelative mes përkatësisë gjinore, sjelljes seksuale dhe etikës.	145

LISTA E TABELAVE

Tabela No. 1: Kryqëzimi i variabëlve gjini dhe mosha e marrëdhënies seksuale.	131
Tabela No. 2: Kryqëzimi i variabëlve gjini dhe numër partnerësh seksualë.	131
Tabela No. 3: Kryqëzimi i variabëlve gjini me variabëlin numër partnerësh në të njëjtën kohë.	132
Tabela No. 4 : Mesatarja e ponderuar e sjelljes seksuale sipas besimit fetar të studentëve.	140
Tabela No. 5 : Tendenca qendrore e të dhënave për sjelljen seksuale dhe etiken e sjelljes seksuale.	147
Tabela No. 6: Tendenca qendrore e të dhënave për disa karakteristika të kampionit si dhe institucionet sociale si familja, bashkëmoshatarët, arsimi, feja dhe media.	147
Tabela No. 7: Variabiliteti i të dhënave për sjelljen seksuale dhe etikën e sjelljes.	148
Tabela No. 8: Variabiliteti i të dhënave për disa karakteristika të kampionit si dhe institucionet sociale si familja, bashkëmoshatarët, arsimi, feja dhe media.	149
Tabela No. 9: Analiza ekonometrike mes variabëlit të varur “Ss” dhe variabëlve të pavarur.	155
Tabela No. 10: Analiza ekonometrike lineare mes variabëlit të varur “Ess” dhe të gjithë variabëlve të pavarur.	158
Tabela No. 11: Korrelacioni mes moralit në institucione sociale dhe sjelljes seksuale. . .	261
Tabela No. 12: Testet e korrelacionit Pearson për variabëlit familja, media, bashkëmoshatarët dhe impakti i tyre në sjelljen seksuale të studentëve.	262
Tabela No. 13: Marrëdhënia mes kohës së shpenzuar për të frekuentuar median dhe sjelljes seksuale të studentëve.	262

Tabela No. 14: Marrëdhënia mes variabëlve të pavarur si institucioni arsimor dhe besimi fetar me sjelljen seksuale të studentëve.	262
Tabela No. 15: Impakti i institucioneve sociale tek studentët që nuk kanë kryer marrëdhënie seksuale.	263
Tabela No. 16 : Marrëdhëniet korrelative mes gjinisë së studentëve dhe sjelljes seksuale.	264
Tabela No. 17: Marrëdhënia mes variabëlve të varur etik e sjelljes seksuale me të gjitha institucionet sociale si variabël të pavarur.	265
Tabela No. 18: Marrëdhënia korrelative mes fëmijëve të rritur me një prind dhe sjellja seksuale.	266
Tabela No. 19: Marrëdhënia korrelative e frekuentimit të xhamisë dhe sjelljes seksuale.	266

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku No. 1: Gjinia e kampionit sasior.	126
Grafiku No. 2: Mosha e studentëve për kampionin sasior.	126
Grafiku No. 3: Ciklet e studimeve për kampionin sasior.	127
Grafiku No. 4: Universitetet ku ndjekin studimet studentët e anketuar.	127
Grafiku No. 5: Statusi i marrëdhënieve të studentëve.	128
Grafiku No. 6: Rrugët e informimit mbi marrëdhënien seksuale.	128
Grafiku No. 7: Njohuritë e studentëve mbi marrëdhëniet seksuale.	129
Grafiku No. 8: Preferencat seksuale.	129
Grafiku No. 9: Studentët që kanë kryer ose jo marrëdhënie seksuale.	129
Grafiku No. 10: Mosha e marrëdhënies së parë seksuale.	130
Grafiku No. 11: Numri i partnerëve seksualë gjatë një viti akademik.	130
Grafiku No. 12: Vlerat mesatare të sjelljes seksuale.	133
Grafiku No. 13: Vlerat mesatare të sjelljes seksuale etike.	134
Grafiku No. 14: Boxplot i shpërndarjes e niveleve të vlerave të variablave.	150
Grafiku No. 15: Histogramët e shpërndarja simetrike për çdo variabël të studimit.	152
Grafiku No. 16: Kombinimet e mundshme të çdo dy variabëlve (ss)/.	153
Grafiku No. 17: Kombinimet e mundshme të çdo dy variabëlve (ess).	157
Grafiku No. 18: Gjinia e studentëve të intervistuar (kc).	160
Grafiku No. 19: Përqindja e studentëve në universitete (kc).	160

Grafiku No. 20: Prejardhja e studentëve.....	160
Grafiku No. 21: Mosha e studentëve të (kc).	161
Grafiku No. 22: Marrëdhënia e parë seksuale (kc).	161
Grafiku No. 23: Rrugët e informimit mbi marrëdhëniet seksuale (kc).	162

KAPITULLI I : PARATHËNIE

1. 1. Morali dhe etika e sjelljes seksuale në shoqërinë shqiptare

Tranzicioni i gjatë i shoqërisë shqiptare është shoqëruar edhe me kriza të thella të moralit dhe të vlerave morale. Shqipëria e ndodhur nën një sistem të mbyllur e diktatorial, ku mbyllja ishte aq ekstreme, sa askush nuk mund të demonstronte asnjë lloj shfaqjeje eksplicite seksuale, si puthjet në publik, prekjet e përkëdheljet, apo të shprehurit hapur të dashurisë dhe ndjenjave, ku, në asnjë dasmë shqiptare nusja dhe dhëndri nuk putheshin, edhe pse lidhja e tyre ishte legjitimuar.

“Një vend, në të cilin virgjëria e femrës kishte përmasat e një vlere të padiskutueshme morale për çdo femër shqiptare, ku gruaja ishte një objekt seksual për burrin, e denjë vetëm për të plotësuar dëshirat e tij” (Tarifa, 2013:11), dhe këto vetëm në rastet e një martese monogame. Edhe sot, duket se shoqëria shqiptare, ende si shkak i historisë dhe trashëgimisë së sistemit të vlerave të mëparshme morale, ka të paqartë dhe konfuze ndarjen mes asaj që është morale dhe etike në sjelljen seksuale.

Duhet përmendur se në Shqipëri natyra e ndryshimeve sociale dhe sjelljes seksuale në veçanti nuk patën ndikimin e fesë si institucion social, siç ndodhte në disa vende të tjera, ku kryesisht ndryshimet e sjelljes seksuale erdhën si shkak i ndryshimeve politike, ekonomike dhe sociale. Në vende të tjera të zhvilluara të botës këto ndryshime u kryen ngadalë, duke ndeshur në çdo hap pengesa të mëdha, të cilat kishin të bënin me traditën konservatore evangjeliste të shekujve të 18-të dhe të 19-të dhe me moralin seksual mbizotërues të epokës viktoriane.

Në punimin e tij profesor Tarifa thekson se;

“Kjo ishte një periudhë e puritanizmit seksual, gjatë së cilës, njerëzve u mohohet çdo dëshirë për kënaqësi seksuale. Morali viktorian ndalonte kategorikisht çdo lloj masturbimi; djemtë e rinj izoloheshin për t’u trajtuar klinikisht kundër masturbimit, duke përdorur edhe pajisje që pengonin kryerjen prej tyre të këtij veprimi; ndërsa te femrat, reduktimi i kënaqësisë seksuale dhe masturbimi shpesh herë pengoheshin përmes një ndërhyrjeve kirurgjikale, si klitoredektomia etj”(Tarifa, 2014:9).

Themeli i moralitetit seksual në Evropë ishte lidhja e fortë midis jetës seksuale dhe një marrëdhënieje të përhershme, kryesisht martesës. Megjithëse thuajse askush nuk i përmbahej këtij morali, kjo ishte norma ideale gjatë krijimit të marrëdhënieve seksuale. Ky moral mund të kishte qenë racional në një shoqëri në të cilën veçanërisht mjetet e jetesës së grave lidheshin me martesën. Shoqëria nuk ofronte garancinë e nevojshme për fëmijët e lindur jashtë martese (Ross, 1990:59). Disa fëmijë të nënave të pamartuara rriteshin në shtëpi të posaçme për shkak të turpit dhe tmerrit me të cilin kristianizmi e konsideronte seksualitetin jashtë martese (Ekerwald, 1995:234; Pohjola-Vilkuna, 1995:21).

Moraliteti seksual viktorian i shihte seksin dhe kënaqësitë seksuale të lidhura vetëm me martesën, dhe kërkonte që të rinjtë, sidomos meshkujt, t’i përmbanin impulset e tyre seksuale (Tarifa, 2014:9), duke e konsideruar seksin dhe marrëdhënien seksuale si tabu, e për më tepër vepër imorale e deri në perversitet apo sëmundje mendore. Edhe në Shqipëri të tilla dëshira apo sjellje as që duhej të ekzistonin, si shkak i gjithë presionit të moralit shoqëror “askush nuk guxonte të mendonte ndryshe nga çfarë partia në pushtet e shoqëria pranonte si morale në sjelljen seksuale” (Zenelaj & Demnushaj, 2014: 279).

Ajo çfarë Auguste Forel shprehte në librin e tij, *“Ethische und rechtliche konflikteim sexualleben”* ishte e ngjashme me atë moral që konceptohej në shoqërinë shqiptare të para viteve '90, ku me guxim ai deklaronte se: çdo marrëdhënie seksuale, nëse nuk duhet t'u bëj dëm partnerëve e as personave të tretë, nuk mund të jetë imorale, por mbi të gjitha, etika e vërtete seksuale i ka bazat në një martesë monogame me dashuri dhe besnikëri të ndërsjellë dhe të qëndrueshme mes partnerëve, të cilët bekohen me fëmijë (Forel, 1909:23). Në Shqipëri, i vetmi partner me të cilin mund të kryente marrëdhënie seksuale një femër ishte vetëm bashkëshorti, kohë kur pëlqimet seksuale nuk shfaqeshin asnjëherë hapur, edhe në rastet kur kishte çifte që mund të pëlqeheshin mes tyre, shfaqja e dëshirave seksuale të partnerëve jashtë martese konsiderohej si imorale deri në tabu. Aq të forta ishin këto norma morale, sa asnjë studiues, sociolog apo psikolog nuk shkruante, studionte apo përkthente veprat e mëdha mbi këtë fushë studimi, edhe pse në Europë apo Amerikë ajo ishte në kulmin e zhvillimit të saj. Një nismë e tillë do të ishte fatale për këdo që e ndërmernte (Zenelaj & Shoraj, 2013:9).

Sipas Reich, ëndrrat e emancipimit erotik të njerëzimit ishin të lidhura me atë të emancipimit politik të tij (Reich, 1971:48), e parë në këtë këndvështrim Shqipëria e kishte të pamundur një emancipim të tillë për aq kohë sa ishte nën regjimin komunist.

Ashtu siç edhe analizon profesor Tarifa, duke u mbështetur në veprën e Reich, ku shprehej se: “në shoqëritë kapitaliste perëndimore moralizimi seksual kishte pësuar fiasco, se normat morale të sjelljes seksuale ishin zëvendësuar nga një “moralitet seksual-ekonomik” (*sex-economic ‘morality’*), se institucioni i martesës së detyruar është “baza e kontradiktave në jetën seksuale” dhe se shoqëria, përmes martesës së detyrueshme, familjes, ideologjisë dhe

“strukturave kolektive” të saj ushtron një “represion seksual” (Tarifa, 2014:10). Këto forma të moralitetit seksual nuk erdhën në Shqipëri për aq kohë sa ekzistonte një sistem ideologjik dhe me struktura kolektive, modele të komunizmit. Për rrjedhojë, shtypja seksuale zgjati në kohë, të paktën deri në vitet ‘90. Të gjendur të papërgatitur për ndryshime të menjëhershme, ku rrugët e informacionit nga të mbyllura tërësisht u shndërruan në krejt të hapura, padyshim që ndryshimi drejt një shoqërie të hapur e demokratike, solli me vete edhe probleme të shumta sociale që u kuptuan shpesh edhe si liri sociale, apo e drejtë e çdo individit për të vetëvendosur mbi çfarë dëshiron. Kështu, përshtatja me jetën e pas viteve ‘90, me moralin e ri të një individit apo grupi social në një shoqëri kaotike e në tranzicion për sa i përket funksionimit të institucioneve sociale dhe pranimin e një forme jete të re në radhët e të rinjve, ka hasur vështirësitë e veta, të cilat shfaqin sot pasojat në sjelljen seksuale etike të të rinjve.

Shumë sociologë janë të mendimit se shoqëritë e kohës postmoderniste ndodhen në një situatë delikate etike. Edhe në Shqipëri gjithë ndryshimet që pësuan institucionet sociale dhe e gjithë shoqëria pas viteve ‘90 e deri më sot, në një kohë postmoderne, domosdoshmërisht tregojnë që duhet të ketë ndryshuar edhe koncepti mbi të moralshmen; por sërish mbetet e vështirë për t’u thënë që është i qartë dallimi mes një jete moderne morale dhe etike me atë çfarë rëndom rregulli dhe normat shoqërore diktojnë si të moralshme apo imorale e sidomos kur bëhet fjalë për sjelljen seksuale. Sipas Reich, për një shoqëri të zhvilluar parakusht i parë për marrëdhënie të shëndetshme njerëzore dhe seksuale është eliminimi i atyre koncepteve morale, të cilat i bazojnë kërkesat e tyre në rregulla arbitrare mbi sjelljen seksuale të njeriut apo thjesht në traditë dhe zakone. Etika , gjithashtu,

duhet të jetë në gjendje të bazohet mbi gjetjet dhe avancimet shkencore. “Ne nuk mund të lemë që marrëdhënia seksuale të mbetet një kërkesë morale, që kohë më parë i shërbente qëllimit të klasave të caktuara” (Reich, 1971: 34).

Mendimi perëndimor rreth seksualitetit bazohej në barazimin kristian të seksualitetit me mëkatin, që duhet të rikuperohet nëpërmjet lindjes së një fëmije. Për të përmbushur detyrën kristiane, seksualiteti duhet të synohet për riprodhim, dhe kështu zhvlerësohen të gjitha format e shprehjes seksuale dhe kënaqësisë (Boas, 2013:221). Hubbard sugjeron se vlerat kristiane që nënkuptojnë pikëpamjet tona të seksualitetit në perëndim kanë krijuar kontradikta në moralin dhe praktikën tona, që kanë rezultuar në konfuzione sociale dhe konflikte (Hubbard, 1990: 67). Seidman (1996) sugjeron se këto konflikte zbuten nga një “autoritet absolut” (qoftë Zoti ose natyra) që shpjegon seksualitetin, kur në fakt seksualiteti qëndron i ndërtuar në rrënjë shoqërore, dhe si rrjedhojë këto rrënjë nuk janë as morale dhe as biologjike por sociale. Sipas Hubbard dhe Seidman, ne duhet të heqim dorë nga dikotomia “i mirë/i keq” në diskutimin tonë për seksualitetin (Hubbard, 1990:67; Seidman, 1996:43).

“Porositë morale” lindin nga nevoja e jetesës paqësore sociale, ku gjithkush ka të drejta të barabarta dhe mundësitë optimale për zhvillimin e kapaciteteve të tyre. Morali i shëndoshë më së miri i shërben zhvillimit të personalitetit individual dhe formave më të mira të jetës shoqërore. Por, konceptet tona morale dhe kushtet sociale ngjallin hipokrizi seksuale, sëmundje fizike dhe sëmundje të tjera (Reich, 1971:79), ku edhe sipas Freud, “shkaqet më të rëndësishme të çdo sëmundjeje neurotike gjenden në faktorë që kanë të bëjnë me shtypjen e dëshirave të jetës seksuale, si pasojë e moralit shoqëror” (Freud, 1995:56). Reich

theksonte se nuk do të ishte mirë që të nxisim virtyte konfuze të frenimit seksual, duke i shitur si të moralshme dhe as të tolerojmë shoqërinë dhe individët e saj që të ndërtojnë morale të ndryshme për sjelljen seksuale të femrave dhe meshkujve (Reich, 1971:81). Në një prej punimeve të profesor Tarifës mbi “*Erosin dhe Demokracinë*” citohet Freud, i cili duke analizuar moralin seksual, del në përfundimin se: “përmes ndrydhjes dhe shtypjes së jetës seksuale me anë të moralitetit seksual “të qytetëruar” që sundon në shoqërinë moderne, qytetërimi ka luajtur dhe luan një rol shkatërrues në jetën e individit dhe të mbarë shoqërisë (Tarifa, 2014:9).

Megjithatë, morali ka shumë më tepër dimensione që shtrihen midis së drejtës dhe së gabuarës. Në shumë aspekte morali është një objektiv i ndryshueshëm me individë që ndryshojnë qëndrimin e tyre mbi çështje të ndryshme në varësi të kushteve sociale (Larry, 2007:101). Sjellja morale varet pjesërisht nga shkalla, në të cilën perceptohet rëndësia e ngjarjeve sociale në aspektin moral, dhe një vëmendje e tillë morale është e mundshme vetëm "nëse të qenit i moralshëm është i rëndësishëm në kuptimin më të thellë se cili jeni" (Moshman, 1999:23). Nga ana tjetër, pamundësia për të kuptuar rëndësinë morale mund të pengojë aktivizimin e proceseve morale njohëse, dhe natyrisht kjo varet nga shumë faktorë të tjerë si social, kulturor, politik, por edhe ekonomik (Barriga et. al. , 2001:9).

Sipas Tushi (2014):

“Idetë e vjetra të ndarjes së të moralshmes dhe të pamoralshmes, sipas disa koncepteve të ngurta doktrimore të periudhës së komunizmit, sot në Shqipëri kanë ndryshuar, por mund të thuhet se ende ekziston një realitet që si shkak i trashëgimisë reflektohet në situatën sociale dhe gjykimet morale që paragjykojnë njeriun të

perceptohet si i moralshëm ose jo në një këndvështrim të ngushtë dhe ndoshta aspak etik” (Tushi, 2014:32)

Edhe sipas Tarifës, është e qartë tashmë se një mentalitet i mbyllur ka humbur gjerësisht terren në ditët tona, në një shoqëri që po përjeton një transformim të thellë e të shpejtë, që nuk lë pa prekur asnjë lloj marrëdhënieje sociale dhe asnjë fushë të jetës, as marrëdhëniet familjare dhe ato më intime, as etikën dhe sjelljen seksuale të shqiptarëve të sotëm (Tarifa, 2013:23).

Normat e përbashkëta morale që duhen dhe që i kërkon shoqëria postmoderne kanë aftësinë të ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë dhe institucioneve sociale, ndaj ne duhet të bëjmë gjithçka që shoqëria të kuptojë se postmodernizmi nuk ka në thelb ndërtimin e shoqërive pa moral, por kjo e etapë postmoderniste e shoqërisë mund të kombinojë në mënyrë harmonike të drejtën individuale të relativizmit social me parimet humane të universalizmit etik. (Tushi, 2014:17).

Këto ndryshime të 25 vjetëve të fundit, shpesh sjellin konfuzion, nëse do të donim të kuptonin se realisht rruga e këtij ndryshimi ka të bëjë me revolucion seksual apo me një mungesë të funksionimit të institucioneve sociale si shkak i tranzicionit të tejzgjatur, e për rrjedhojë të ketë sjellë një jetë seksuale konfuze dhe jo etike të të rinjve, për aq kohë sa institucionet themelore të shoqërisë si familja, shkolla apo media, e kanë të vështirë të gjejnë rrugën e duhur të edukimit seksual të të rinjve drejt një sjellje etike të hapur e bashkëkohore.

1. 2. Revolucioni seksual shqiptar dhe ndryshimet në sjelljen seksuale

Në Europën Perëndimore, që në vitet '70 u realizuan studime të mëdha mbi ndikimin që pati sjellja seksuale e të rinjve në revolucionin seksual. Revolucioni industrial bëri të mundur ndryshime të rëndësishme në standardet seksuale të shoqërisë angleze, të asaj amerikane dhe në disa vende të Europës së mesit të shekullit të 19-të.

Sipas disa autorëve, është historia e një shoqërie që na ndihmon të kuptojmë sesi seksualiteti dhe sjelljet seksuale të brezave të rinj kanë evoluar gjatë kalimit nga një shoqëri e mbyllur në një shoqëri të hapur, moderne e demokratike (Hefner, 1999:129), ku demokracia në vetvete nuk duhet kuptuar si një manifestim i thjeshtë politik apo kapërcim sistemesh politike, por duhet përcaktuar më së miri në të gjitha dimensionet e saj, përfshirë edhe aspektet e edukimit seksual të brezave të rinj, sepse pas çdo revolucioni apo hapjeje seksuale fshihen edhe probleme të reja për t'u menaxhuar, si dhe përgjegjësia për një etikë të re seksuale në kushtet e një Revolucioni Seksual. (Knijn & Lewis, 2002: 171).

Sipas Reich, është e nevojshme të kuptohet që kapitalizmi ndikon në sjelljet seksuale të njerëzve dhe sidomos tek të rinjtë e që revolucionet sociale shoqërohen edhe me revolucion seksual (Reich, 1971:121). Me gjithë frikërat për dinamikën dhe problematikat që shkakton një revolucion seksual tek të rinjtë, nuk duhet harruar se kontrolli i instikteve seksuale, nuk është pa kosto. Sistemet politike apo sociale ende mund të abuzojnë dhe të çorientojnë shoqërinë, por nuk ka asnjë dyshim që revolucioni seksual është një progres dhe asnjë fuqi në botë nuk mund ta ndalojë (Reich, 1971:128), gjë që është mjaft e dukshme edhe në vendin tonë.

Thelbi i revolucionit seksual, objekti i tij madhor, sipas Tushi (2007), ishte dekurajimi i martesës, dhe konsiderimi i saj si një institucion i vjetruar social, që ndrydh jetën seksuale të njerëzimit dhe inkurajon konceptin e dashurisë së lirë si një kënaqësi personale, por pa përgjegjësi sociale. Martesa, si e vetmja mënyrë e licensuar për marrëdhënie seksuale, u vu në shënjestër të “revolucionit seksual” (Tushi, 2007: 211). Si shkak i kësaj “goditjeje” që pësoi martesa, u rrit sidomos numri i femrave të pamartuara. Planet për ndjekjen e studimeve, nisja e marrëdhënieve seksuale në moshën parauniversitare, përdorimi i kontraktivëve, planifikimi i shtatzanive, e shtynë gjithmonë e më vonë martesën, e në disa raste shtuan mundësinë e zgjedhjes së të qenit të pamartuara (Blum, Buekring & Rinekost, 2000:191).

Ashtu si para viteve 1960, amerikanët besonin tek pastërtia e grave dhe virgjëria e tyre, pavarësisht faktit nëse kjo ishte realisht e mirë apo e keqe, e në anën tjetër meshkujt e shfaqnin hapur oreksin për marrëdhënie seksuale, por kurrësi nuk mund të pranohej kjo tek femrat, të cilat në saj të faktorit edukues të shoqërisë demokratike sot paraqesin tjetër realitet (Peterson, 1999:690). Nëse Amerika përjetonte një realitet të tillë social para viteve '60, Shqipëria ishte në të njëjtat kushte, por natyrisht vetëm në vitet e para të demokracisë, ku ende rolet gjinore apo sjellja seksuale nuk kishin marrë të njëjtën trajtë si sot. Sipas Reiss, për të dalë nga bllokimet tona seksuale, natyrisht që duhet refuzuar sistemi i vjetër tradicional i edukimit të shoqërisë dhe i abuzimit me të moralshmen, në mënyrë që të kuptojmë rëndësinë që ka socializimi në jetën e çdo individi (Reiss, 1960:56).

Në vendet perëndimore, në vitet 1900, edukata seksuale u përqendrua tek anti-masturbimi dhe theksoi se pastërtia seksuale krijonte karakter të fortë tek një individ (Peterson,

1999:674). Në kushte thuajse të ngjashme, Shqipëria e para 25 vjetëve, vlerësonte si njeri me karakter të dobët çdo individ që tentonte të shfaqte hapur kënaqësitë e veta seksuale (Zenelaj, 2014:66). Por realiteti sot paraqitet ndryshe, ku veç bisedave të lira mes miqsh, numri i të rinjve që kryejnë marrëdhënie seksuale paramartesore dhe rritja e numrit të partnerëve seksualë është një fenomen thuajse i natyrshëm për një shoqëri në zhvillim (Zenelaj, 2014:68; White, 2000:52). Natyrisht që përdorimi i pilulave nga femrat në universitet ka bërë që pavarësisht marrëdhënieve të rregullta dhe aktive seksuale të minimizohet risku për shtatzani të parakohshme, e ndërkohë marrëdhënia seksuale në vetvete të jetë maksimalisht e kënaqshme (Peterson, 1999:678). Duket që si shkak i ndryshimeve sociale, të rinjtë e kanë kuptuar që një akt seksual bëhet imoral, joetik apo irracional, jo sepse ai është seksual, por pikërisht sepse mund të jetë joseksual, i gabuar dhe i paefektshëm (Ellis, 1999:163). Ndryshimet në qëndrimet dhe sjelljen seksuale lidhen me mënyra të reja të këndvështrimeve ndaj marrëdhënieve seksuale dhe marrëdhënieve të tjera sociale.

Është karakteristikë e sistemeve moderne të intimitetit dhe miqësisë seksuale që partnerët të zgjidhen vullnetarisht nga një sërë mundësish. Lidhjet e qëndrueshme seksuale, martesat dhe marrëdhëniet shoqërore kanë prirjen t'i afrohen sot të ashtuquajturës marrëdhënie të pastër që janë në kundërshtim me lidhjet e ngushta personale në kontekstet tradicionale, sepse një marrëdhënie e pastër sipas Giddens, nuk mbështetet në kushtet e jashtme të jetës sociale ose ekonomike – “ajo është e pavarur” (Giddens, 1991:212).

Në vitet '60 dhe në fillim të viteve '70 të shekullit të 20-të, çliruesi më i rëndësishëm i jetës seksuale ishte përdorimi i metodave kontraceptive. Mjetet mbrojtëse seksuale dhe

kontraceptivi oral i përdorur nga gratë mundësoi përfshirjen në marrëdhënie seksuale me masa të posaçme në momentin e zgjimit të dëshirës seksuale. Kështu, revolucioni seksual ishte edhe ideologjik, edhe teknik. Ky ishte pjesërisht rebelim kundër moralit fetar dhe ndrydhjes seksuale duke kaluar në hedonizëm dhe në kërkimin e kënaqësisë së çastit pa vonesë (Reiss, 1960:68; Foucault, 1980:119).

Shumica e lëvizjeve sociale dhe kulturore të viteve '60 u bazuan në këtë status të orientuar kundër familjes: vetë lëvizja e re feministe, por edhe lëvizje të tjera të lirisë seksuale, duke përfshirë lëvizjet e homoseksualëve dhe lesbikeve, kultet e ndryshme të ndjeshmërisë dhe vetërealizimit personal (Berger & Berger, 1983:39). Brezi i lindur në vitet '40 theksoi lirinë seksuale si një ideal. Ai dëshironte të eliminonte atë formë autoriteti që prindërit e tyre supozoheshin që e përfaqësonin. Një kusht për formimin dhe praktikën e këtij ideali të lirisë seksuale ishte pjesërisht për faktin se prindërit e këtij brezi nuk ishin aq autoritarë si paraardhësit e tyre dhe pjesërisht se liria seksuale mundësohej nga pikëpamja sociale dhe kulturore (Lyttkens, 1989:36; Haavio-Mannila, Roos & Kontula, 1996:144)

Ndryshimet ekonomike, zhvillimi i medias dhe teknologjisë, mendësitë e reja tek të rinjtë dhe bashkëmoshatarët, ka bërë që të rinjtë të jenë më të hapur, e veç tyre edhe prindërit apo familjarët. Shumë çështje të tilla siç janë shprehitë seksuale të të rinjve sot, bëjnë që shoqëria jonë e sapodalë nga guaska e saj të gjendet në kushte krejt të kundërta sociale dhe morale, që kërkojnë një riorganizim të institucioneve sociale në lidhje me edukimin seksual të brezave të rinj (Zenelaj, 2014:71).

Pyetja lind natyrshëm, ku po shkon shoqëria shqiptare, drejt revolucionit seksual apo degradimit të vlerave të shoqërisë?

Koha ku jetojmë ka një tendencë të fortë të braktisjes së moralit mbi sjelljen seksuale, ku po fiton terren teza se çdo njeri ka të drejtë të bëjë çfarë të dojë me trupin e tij, se është ai që vendos për veprimet seksuale që dëshiron. Të rinjtë në universitete dhe shkolla të mesme jetojnë në një shoqëri seksualisht të hapur, ku dallgët e vonuara të revolucionit seksual janë duke dhënë efekte sociale maksimale mbi martesën, familjen dhe qytetërimin tonë (Tushi, 2007:129). Sot, çdo ditë e më shumë vihet re që adoleshentët dhe studentët në universitete janë shumë më të informuar rreth marrëdhënieve seksuale, sesa gjeneratat e 25 vjetëve të shkuara, si dhe mendësitë e të pasurit të vetëm një partneri seksual kanë ndryshuar (Zenelaj, 2014:73).

Nga ana tjetër, struktura e familjes shqiptare ka pësuar ndryshime të mëdha në këto vite, ku është zëvendësuar nga një familje e madhe ku jetonin disa breza, në një familje numerikisht më të vogël, të përbërë nga një çift i martuar dhe fëmijët e tyre. Numri i fëmijëve të lindur nga një çift i martuar është zvogëluar. Familja shqiptare sot është e karakterizuar nga kontradiktat që shfaqen në marrëdhëniet midis brezave (të konfliktit të gjeneratave) , ose në mes burrave dhe grave (konfliktit gjinor). Në Shqipëri tashmë edhe martesat kanë marrë trajtë tjetër, ku martesat me mblesëri janë më të rralla, dhe është kthyer në normë tashmë martesa me dashuri, ku mosha drejt martesës është shtyrë, e ku nuk është më tabu që një vajzë të mos zgjedh martesën por bashkëjetesën në çift, madje edhe pasjen e fëmijës jashtë kurorëzimit me martesë. Burrat dhe gratë që janë të zhgënjyer dhe të

pakënaqur me martesën e tyre kërkojnë divorcin, dhe kjo nuk është më e ndaluar (Tarifa & Zenelaj, 2014: 17).

Përpos sa më lart, femrat sot mundën të planifikojnë shtatzaninë e tyre, mundën të përdorin kontraktivët apo edhe prezervativët gjatë aktit seksual, gjë e cila nuk ndodhte më parë. Një "revolucion seksual" është në proces në Shqipëri, në mënyrë të ngjashme me atë që u zhvillua në Shtetet e Bashkuara dhe në Europën Perëndimore rreth vitit 1960-1970. Djemtë dhe vajzat adoleshente të flasim lirshëm për seksin dhe dinë më shumë rreth seksualitetit dhe higjienës seksuale sesa prindërit e tyre kur ata ishin të moshës së tyre (Tarifa & Zenelaj, 2014:17).

Një djalë apo një vajzë në shkollë të mesme ka një partner intim, ose madje e zëvendëson atë me një të ri/të re, kur marrëdhëniet ekzistuese intime nuk është e kënaqshme për palët. Nuk është e pazakontë për të rinjtë të bërit seks para martesës; ku virgjëria e ka humbur pothuajse tërësisht karakterin e saj mitik. Sot duket të ketë rënë edhe miti se meshkujt janë biologjikisht poligamë, ndërsa femrat janë monogame. Të gjitha sa u shkruan më lart e bëjnë të qartë që në shoqërinë shqiptare një erë e re, e quajtur në vende të tjera Revolucion Seksual, sot po ndodh (Tarifa & Zenelaj, 2014:21).

E parë në këtë këndvështrim, ku funksionet e familjes nuk janë më ato tradicionale, ku shoqëria shqiptare nuk është më e mbyllur, ku të rinjtë janë të lirë të bëjnë zgjedhjet e tyre seksuale, ku arsimi dhe edukimi seksual i brezave të rinj është në zhvillim (por jo mjaftueshëm i përshtatshëm për këtë periudhë të re), ku media si institucion social luan një rol të madh në edukimin dhe modelimin e sjelljes seksuale si shkak i informacioneve të lira

e pamundësive për t'i kontrolluar ato në aspektin edukues seksual, ku bashkëmoshatarët kanë një tendencë që të kopjojnë sjelljet e njëri-tjetrit, e ku feja si institucion social nuk ndikon në sjelljen seksuale të të rinjve shqiptarë, për aq kohë sa ajo nuk është një fe homogjene (Zenelaj & Demnushaj, 2014:281), lind nevoja për t'u fokusuar në një etikë të re seksuale, e cila është larg dogmave moraliste të së mirës dhe së keqes, dhe më afër përgjegjësive dhe edukimit demokratik seksual të brezave të rinj.

1. 3. Etika e re e sjelljes seksuale

Lëvizja e shoqërisë shqiptare, tranzicioni i gjatë, hapja dhe ndryshimi i funksionimit të institucioneve të caktuara sociale ka bërë që sjellja seksuale e studentëve njëkohësisht të ndryshojë, por edhe të vihen në diskutim çështjet etike të kësaj sjelljeje. Kryesisht studimet mbi sjelljen seksuale të të rinjve apo dhe më gjerë kanë munguar, edhe pse ka disa të tilla që janë të fokusuara në Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme apo vetëm tek HIV-AIDS, gjithsesi mungesa e këtyre studimeve e vështirëson edhe më tej mundësinë për të krahasuar sjelljen seksuale etike të të rinjve.

Çështjet rreth etikës dhe moralit të sjelljes seksuale janë shumë të diskutuara nga autorë e teoricienë të ndryshëm, ato janë aq sa të kritikuar për mënyrën sesi trajtohen, aq edhe të kërkuara për më shumë vëmendje dhe trajtesë në fushën e sociologjisë e sidomos atë të seksualitetit dhe marrëdhënies seksuale të të rinjve. Kështu, sociologët, seksologët apo dhe edukatorët e seksualitetit kanë pasur thirrje të hapura për vëmendje ndaj etikës seksuale. Një ndër ta ka qenë studiuesi Reiss, i cili shkroi se: “problemi ynë kryesor është paaftësia e shoqërisë sonë për të krijuar një etikë të re seksuale” dhe ai gjithashtu e drejtoi thirrjen drejt

studiuesve për më shumë vëmendje dhe profesionalizëm në trajtimin e çështjeve etike. Frika se mos gjykohemi si të papërshtatshëm apo joprofesionalë, ka bërë që ne të gabojmë edhe më shumë duke mos prekur problematika të tilla si etika në sjelljen seksuale (Reiss, 1991:7).

Sipas David Carr (1987), edhe puna e Frojdit, pavarësisht disa hollësive të diskutueshme nga shumë autorë, është me interes të konsiderueshëm moralo-filozofik, kjo sepse shpjegimi frojdian i “normalitetit” dhe “anormalitetit” seksual duket se shfaqet për të përfshirë vlerat gjerësisht tradicionale dhe konservatore lidhur me natyrën dhe domethënien e seksit në jetën njerëzore. Ekzistojnë dy pika kryesore në të cilat moraliteti tradicional natyralist mund të mbështetet sipas Frojdit, si: 1) është e natyrshme të konsiderohet veprimtaria seksuale si e nevojshme për të mirën e njeriut, për sa kohë ajo i shërben qëllimit të duhur të riprodhimit të llojit të vet. Shprehjet infantile autoerotike të seksualitetit, edhe në kontekstin heteroseksual adult, do të duhet të konsiderohen si kushte të nevojshme për të vonuar seksin, ku individit nuk ka arritur të përmbushë tranzicionin e plotë drejt gjendjes së maturimit të marrëdhënies heteroseksuale, në të cilën veprimtaria përgjegjëse seksuale përcaktohet të paktën pjesërisht lidhur me qëllimin e riprodhimit dhe moralitetit seksual. Prandaj, ka të ngjarë të identifikojë atë që nuk është seksualisht në interes të individit në kuptimin e asaj që bie ndesh me virtytin në çështjet seksuale; për të këtë arsye, marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore, marrëdhëniet seksuale me shumë partnerë dhe vese të tjera seksuale thelbësisht antisociale, do të konsideroheshin dukshëm si shprehje të një jete përgjithësisht të mjerueshme dhe të degraduar për qeniet njerëzore. Edhe një herë, hulumtimet frojdiane duket se mbështesin këtë pikëpamje, meqenëse të

gjitha këto forma të sjelljes seksuale njerëzore që ai konsideron se kanë devijuar nga modeli i seksualitetit të orientuar drejt karakterit altruist, heteroseksual dhe riprodhues, konsiderohen në fakt si forma të shëndetit të përkeqësuar mendor. Individit që nuk arrin të përmbushë kushtet frejdiane të një jete normale seksuale konsiderohet si person me probleme dhe i palumtur, të cilit i nevojitet një lloj terapie (Carr, 1987:367).

Frejdi si shkak i analizave të mësipërme, shumë autorë e kanë konsideruar siç duket si një radikal të rrezikshëm për sa u përket pikëpamjeve të tij për psikologjinë seksuale dhe sjelljen. Në fakt ngjan se një pikëpamje mjaft tradicionale dhe konservatore e etikës seksuale nënkuptohet në shkrimet e tij për seksualitetin, për atë kohë sa veprimet e normales dhe anormales frejdiane, mbështeten edhe në baza morale. Por mbi të gjitha, duhet të jetë e qartë se cilado qoftë pikëpamja e gjithkujt lidhur me moralitetin e sjelljes seksuale, shpjegimi i Frejdit është me interes të konsiderueshëm filozofik dhe moral, dhe pse trajtohet si një teori që nxit lirinë seksuale (Wiley, 2002:139).

Sipas Maltz (1995), në këtë pikë të historisë rezulton se studimi akademik i seksualitetit dhe sjelljes seksuale mund dhe duhet të trajtojë etikën “pa na kthyer tek miopia moraliste ose ndrydhja seksuale, e mbi të gjitha pa mbetur vetëm një teori e patestuar morale” (Maltz, 1995:6). Kjo përpjekje synon të trajtohet edhe në këtë studim mbi etikën dhe sjelljen seksuale të studentëve shqiptarë. Edhe shoqata SIECUS (*Sexuality Information and Education Council of the U. S*) në vitin 1998, vërejti se ishte shumë e nevojshme që morali dhe parimet bazë të tij të trajtohen “jo si doktrinë fetare sektare, por si trashëgimi morale të civilizimit perëndimor” (SIECUS, 2001:14). Më tej në vitin 2000, SIECUS deklaroi se: “Shoqëria jonë ka nevojë për një etikë seksuale të fokusuar në marrëdhëniet personale dhe

drejtësinë sociale dhe jo në veprime të caktuara seksuale”. Shoqata kishte si qëllim përmirësimin e edukimit seksual në shkolla me pretendimin se këtu duhet të nisnin trajtesat e para të etikës seksuale, dhe sipas SIECUS programet e edukimit, “duhet të bazohen në një kuptim të qartë të çështjeve etike në aktivitetin seksual” (SIECUS, 2000:18).

Megjithatë vështirësitë për të trajtuar etikën seksuale janë të dukshme, sepse reflektimi i pasigurisë së postmodernizmit, ka bërë që tekstet shkollore mbi seksualitetin edhe pse kanë kryer përpjekje të admirueshme për të mbështetur sjelljen etike, dhe që përgjithësisht i janë shmangur moralit të caktuar (Martin & Sugarman, 2000: 399), gjë që ndodh vetëm në vende të zhvilluara, në Shqipëri nuk është e njëjta situatë.

Edhe në vendin tonë diversiteti i periudhës së postmodernizmit ka dobësuar edhe kuptimin e moralit ose etikës, ky konfuzion tregohet në tekste shkollore të vendit tonë bashkë me shumë problematika të tjera të pranishme në edukimin seksual në Shqipëri. Në mënyrë të vazhdueshme tekstet shkollore mbajnë një qëndrim të dyfishtë për sa i përket sjelljes seksuale dhe edukimit seksual. Ndërsa aprovojnë hapur gjykimet etike, edhe pse përpiqen të shprehin se janë larg moralit të sjelljes seksuale, ato gjithsesi mbështesin vlera dhe norma të caktuara duke kryer kështu vlerësime të nënkuptuara morale, që në këto raste sërish mbeten subjektive dhe aspak profesionale apo me etikë në edukimin seksual të brezave të rinj (Zenelaj & Shoraj, 2013:167).

E në rast se vetë institucionet e edukimit në një vend a shoqëri të caktuar kanë hasur vështirësi në trajtimin e çështjeve të tilla me profesionalizëm, atëherë nuk mbetet të pretendohet se janë institucionet e tjera sociale si familja, media, feja apo bashkëmoshatarët

e studentëve që do të mund ta kryenin këtë diskutim mbi bazën e sjelljes seksuale etike (Hitlin & Vaisey, 2013:68).

Natyrisht nëpërmjet këtij punimi unë përpiqem të shpall hapur paanësinë mbi atë që është morale apo imorale mbi çështjet e seksualitetit dhe sjelljes seksuale të studentëve në sensin e përcaktimit të asaj çfarë është e mirë apo e keqe, por nga ana tjetër gjithashtu përpiqem të mbështes një grup të pajtueshëm të vlerave dhe parimeve etike, të cilat sipas meje nuk mund të anashkalohen. Kështu trajtimi i etikës në këtë studim mbart më shumë konotacionin e vëmendjes ndaj vendimmarrjes për marrëdhënie seksuale, tek veprimi i përgjegjshëm seksual i kryer nën masa mbrojtëse, tek sjellja seksuale me pëlqim të ndërsjellë, tek barazia dhe respekti mes palëve, dhe tek sjellja seksuale a padëmshme për palët (Schwartz, 2010:1188).

Kësisoj në këtë studim i largohem asaj çfarë Oscar Wilde citon se “Morali dhe etika është thjesht qëndrimi që ndjekim ndaj veprimeve të njerëzve që personalisht nuk i pëlqejmë” (Wilde, 2001), por edhe supozimit se shkenca është pa vlera etike, apo se nuk duhet t’i trajtojë ato. Ky, siç thonë edhe shumë autorë të tjerë, reflektoi një pozicion të pamundur dhe jokohorent në fushën e kërkimit shkencor, (Shih: Doran, 1977:18; Habermas, 1970:231; Kane, 1994:78; Richardson & Guignon, 1999:114; Woolfolk & Richardson, 1984:777), sepse siç shprehin edhe Strong, etj (1999) se pikërisht edhe përpjekja për të lënë mënjane gjykimin e vlerave etike është në vetvete një gjykim etik i vlerave, dhe është në fakt mbështetja e relativizmit etik që personalisht nuk e ndjekim (Strong et. al. , 1999:121). Gjithashtu sipas McAnulty dhe Burnette (2001):

“Është e pamundur që shkencat shoqërore të jenë tërësisht pa vlera etike”. Shkencat shoqërore nuk mund të shmangin gjykimet e vlerave etike. Një prej shenjave dalluese të shkencave shoqërore, është aftësia për dhënien e gjykimeve të vlerave etike dhe në fakt, nevoja për të bërë diçka të tillë. Si rrjedhojë, shkencat humane nuk mund të shmangin diskutimin dhe vlerësimin e vlerave etike, edhe pse duhet të jenë të kujdesshme në mënyrën sesi i ngrenë tezat për studim”(McAnulty & Burnette, 2001:56).

Si studiuese e sjelljes seksuale përpiqem që të përshkruaj sjelljen seksuale të studentëve shqiptarë dhe jo ta gjykoj atë mbi bazat e morales ose të së pamoralshmes. Gjithashtu, përpiqem të evidentoj se cilat janë format e edukimit seksual që përdoren sot nga institucione të caktuara sociale si, familja, shkolla, bashkëmoshatarët, media dhe feja, duke nxjerrë në pah pamundësinë apo mundësinë e tyre për tu mbështetur në edukim etik mbi sjelljen seksuale si dhe impaktin që kanë pasur në sjelljen seksuale të të rinjve si shkak i trajtimit të çështjeve të etikës së sjelljes seksuale duke mbetur në grackën e moralit, e asaj çfarë shoqëria mendon se është e mirë, e drejtë, apo të imoralitetit mbi bazën e asaj çfarë shoqëria jonë gjykon se mbetet e keqe, e gabuar dhe e padrejtë apo të gjykimeve të moralit mbi dy standarde, kryesisht me bazë gjinore.

Për etikën dhe moralin ka mjaft diskutime teorike të nxitura nga filozofë, psikologë dhe sociologë, por qëllimi im si studiues nuk është të abstrahoj teorikisht mbi etikën siç mund të bënte një filozof, as të trajtoj etikën dhe moralin në këndvështrimin psikologjik të sjelljes seksuale, të cilët zakonisht fokusohen në tiparet universale të njohjes morale, bazohen në dallime filozofike (p.sh. deontologjike kundrejt atyre utilitare) (Wiley, 2002:142; Hitlin & Vaisey, 2013:61), por si studiuese në fushën e sociologjisë synoj më shumë të testoj empirikisht impaktin që kanë institucionet sociale dhe morali i shoqërisë në sjelljen seksuale etike të studentëve, duke analizuar proceset sociale që krijojnë dhe mbështesin

koncepte të veçanta të moralit dhe etikës, duke kërkuar të kuptoj sesi morali (ai që shoqëria jonë predikon si të mirë, të drejtë) ndikon tek strategjitë e veprimit dhe të sjelljes me kalimin e kohës; dhe nëse ndryshimet sociale dhe historike kanë ndryshuar qëndrimet mbi moralin në shoqëri. Çështjet përkatëse janë empirike dhe aspak filozofike apo semantike (Wiley, 2002:142). Kështu, edhe pse sjellja seksuale e studentëve (*individët*) është njësi matëse, synimi im është të testohet empirikisht ky fenomen duke iu referuar rezultateve të një kategorie ose grupi më të madh shoqëror deri në impaktin e institucioneve mbi sjelljen seksuale etike të këtij grupi të shoqërisë sonë, çfarë e bën këtë studim të jetë në nivel makro.

Nga ana tjetër, sociologët kryesisht bazohen në përkufizimet formale të moralit dhe etikës, duke u përpjekur që induktivisht të përcaktojnë kuptimet morale në kontekste të caktuara kërkimore. Sociologët janë më të interesuar për mënyrën sesi njerëzit ndjekin “strategji veprimi” afatgjata, sesa për mënyrën sesi i bëjnë zgjedhjet individuale (Hitlin & Vaisey, 2013:61), dhe sidomos interesohen në zhvillimin dhe impaktin e institucioneve sesa në skenarë të përmbledhur. Kështu sociologët fokusohen tek morali në vija të trasha, që nënkupton fokusimin jo vetëm tek aktet individuale, por edhe tek praktika dhe identitetet morale në një periudhë me të gjatë kohore dhe kur ata bëhen pjesë e institucioneve sociale si arsimi, familja, media etj (Wiley, 2002:142).

Si konkluzion, në këtë studim etika mbi sjelljen seksuale do të trajtohet mbi atë që Strong, etj (1999), Greenberg etj (2000), dhe Allgeier dhe Allgeier (2000), mbështesin haptazi si kritere racionale të etikës, siç janë p.sh: “pëlqimi i ndërsjellët i partnerëve seksualë për iniciimin e një akti seksual, mosdëmtimi i partnerit, barazia dhe përgjegjësia në

vendimmarrjen për marrëdhënie seksuale nën masa mbrojtëse, mirëkuptimi dhe shqetësimi për ndjenjat e partnerit seksual” (Strong et. al, 1999:28; Greenberg et. al, 2000:79; Allgeier & Allgeier, 2000:21). Kështu standardi bazë për të trajtuar çështjet etike të sjelljes seksuale, është nëse aktiviteti seksual zhvillohet ndërmjet të rriturve me një konsensus dhe mirëkuptim reciprok, pa shkaktuar dëm tek palët e përfshira në marrëdhënien seksuale, por duhet theksuar se ky duhet të jetë një angazhim për vlerësim objektiv të sjelljes seksuale, vëzhgim të gjërave siç ekzistojnë realisht, duke mos u ndikuar nga ajo çfarë ne si studiues ndiejmë ose besojmë se çfarë është etike apo jo në sjelljen seksuale (Strong et. al. , 1999:30).

1. 4. Korniza teorike ku mbështet ky studim

Sipas teorisë së veprimit të arsyetuar, një vendim për t’u angazhuar në një sjellje (për shembull për të kryer marrëdhënie seksuale) parashikohet drejtpërdrejt nga synimi i një individi për të realizuar sjelljen. Nga ana tjetër, synimi është një funksion i dy faktorëve: qëndrimi i individit ndaj sjelljes (sa e dëshirueshme duket të jetë sjellja) dhe perceptimi i individit për normat e përgjithshme morale shoqërore në lidhje me sjelljen (çfarë të tjerët mendojnë se duhet të bëj). Të dyja qëndrimet dhe normat morale formohen mbi bazën e grupeve të besimeve: besimet rreth pasojave të kryerjes së sjelljes (për shembull, do të mbetem shtatzënë), dhe besimet rreth mënyrës sesi persona të tjerë të afërt ndihen rreth kryerjes individuale të sjelljes (për shembull, besimet e shoqes/shokut tim të ngushtë). Secili besim rezultues që përbën bazën e qëndrimit ka dy komponentë: gjasa/mundësia (sa janë shanset që do të mbetem shtatzanë?) dhe vlerësimi (sa pozitive ose negative do të ishte mbetja shtatzanë?) Secili besim normativ ka gjithashtu dy komponentë-norma referuese

(çfarë mendon shoku im/shoqja ime i/e ngushtë se duhet të bëj?) dhe motivimi për të përmbushur këtë koncept (deri në ç'shikallë dua të bëj, çfarë shoku im i ngushtë dëshiron të bëj?)

Kjo teori ka rezultuar e dobishme për parashikimin e aspekteve të tjera të sjelljes seksuale të të rinjve, si për shembull vendimet për përdorimin e prezervativëve (Shih: Hasen-Engquist & Parcel, 1992:273; Gillmore, Morrison, Lowery, & Baker, 1994:222 ; Kegeles, Adler & Irwin, 1989:913; Morrison, Baker & Gillmore, 1998:51; Richard & vanderPligt, 1991:109) dhe mjeteve të tjera kontraceptive (Adler, Kegeles, Irwin & Wibbelsman, 1990:470), dhe shpeshësinë e seksit, e numrin e partnerëve (Hasen-Engquist & Parcel, 1992:270; Jorgensen & Sonstegard, 1984:45). Kështu mbështetur sa më lart, në këtë studim u testua se cilat janë institucionet që mund të ndikojnë në sjelljen seksuale etike, dhe nëse normat morale të institucioneve sociale çojnë drejt një sjellje seksuale etike (Morrison et. al. , 1998: 207).

Të marra në tërësi, këto studime tregojnë se teoria e veprimit të arsyetuar mund të ndihmojë perceptimin tonë të sjelljeve seksuale të të rinjve. Megjithatë, shumica e këtyre studimeve nuk bënë dallimin midis të rinjve që kishin përvojë seksuale dhe atyre që nuk kishin dhe as dallimin se cili institucion mundet ose jo të ndikojë në sjelljen e të studentëve. Në disa studime masa e qëndrimit dukej të vlerësonte më shumë një dimension normativ, sesa një dimension vlerësues të qëndrimeve që përshkruajnë Fishbein dhe Ajzen (1975). Në një përjashtim të rrallë Fisher, Fisher dhe Rye (1995) shqyrtuan mundësinë e teorisë së veprimit të arsyetuar për të parashikuar vendimet e të rinjve, nëse duhet të kryenin marrëdhënie seksuale apo jo dhe se çfarë ndikonte në këtë vendimmarrje, normat sociale të institucioneve të caktuara apo qëndrimet individuale të të rinjve? Edhe në këtë rast, studimi u

mbështet për të trajtuar mundësinë e dallimeve mes të rinjve që kanë nisur një akt seksual dhe atyre që ende nuk e kanë kryer aktin e parë seksual, duke nxjerrë në pah se cilat institucione ndikonin në vendimin e tyre (Fishbein & Ajzen, 1975:137; Fisher et al., 1995:257).

Nga ana tjetër, teoria e veprimit të arsyetuar për djemtë dhe vajzat, ka treguar në mënyrë të qëndrueshme ndryshime në sjelljet seksuale të të rinjve meshkuj dhe femra, megjithëse disa prej këtyre ndryshimeve janë ngushtuar me kalimin e kohës. Për shkak se vajzat kanë kosto më të larta të lidhura me marrëdhënien seksuale (për shembull, shtatzëni e paplanifikuar dhe prirje më të lartë ndaj sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), vajzat dhe djemtë prezumohen të balancojnë kostot dhe shpërblimet e aktiviteteve seksuale në mënyra të ndryshme (Day, 1992:670; DiBlasio & Benda, 1992:229). Fishbein dhe Ajzen (1975) pohojnë se ekzistojnë faktorë të ndryshëm nga ata të përcaktuar nga teoria e tyre, të cilët cenojnë një vendim për përfshirje në një sjellje, si për shembull kryerja e marrëdhënieve seksuale. Megjithatë, ata sugjerojnë se ndikimet e këtyre faktorëve ndërmjetësohen nga koncepte të teorisë më tepër sesa cenimi i drejtpërdrejtë i sjelljes. Kjo nënkupton se marrëdhëniet seksuale, do të jenë të njëjta si për djemtë, edhe për vajzat. Për shembull, megjithëse djemtë perceptojnë normat dhe kanë qëndrime më të favorshme ndaj kryerjes së marrëdhënieve seksuale sesa vajzat (Watts & Nagy, 2000:313), teoria sugjeron që marrëdhëniet midis koncepteve nuk do të ndryshojnë mbi bazë gjinore; domethënë, në të dyja rastet sjellja do të parashikohet nga synimet dhe nga ana e tyre, synimet do të parashikohen nga normat dhe qëndrimet e kështu me radhë. Në këtë studim shqyrtohet kjo pritshmëri, duke testuar nëse ka një ndërveprim statistikor midis gjinisë dhe variabëlites së varur në modelin konceptual të ndërtuar më poshtë (*figura no. 1*).

Gjithashtu, të dhënat e kohëve të fundit (Nahom et. al., 2011:156) tregojnë se faktorët që ndikojnë në vendimin e adoleshentëve për të kryer marrëdhënie seksuale, varen nga fakti nëse të rinjtë kanë përvojë seksuale. Kjo do të thotë se megjithëse mund të ekzistojnë faktorë të ndryshëm që ndikojnë tek vendimi i një personi të virgjër për të filluar aktivitetin seksual të lidhur me ato që ndikojnë tek vendimet e të rinjve me përvojë seksuale për të kryer sërish marrëdhënie seksuale, teoria sugjeron se këto ndryshime reflektohen në ndryshime në besime, norma, qëndrime dhe synime. Në këtë studim testohet impakti i institucioneve mbështetur mbi normat sociale në vendimin për të kryer ose jo aktin e parë seksual, duke shqyrtuar ndërveprimin statistikor midis statusit seksual (i/e virgjër kundrejt personit që nuk është i virgjër) dhe ndikimit të variabëlve të pavarur. Edhe teoria e normave sociale përpiket që të japë përfundime e të bazohet në konceptin se sjellja shpesh ndikohet nga mënyra sesi individët i perceptojnë anëtarët e tjerë të një grupi sociale gjatë sjelljes, edhe nëse ato besime dhe perceptime janë të pasakta (Eaves, 2007:23). Me fjalë të tjera, normat e perceptuara të bashkëmoshatarëve janë pjesë e teorisë së normave sociale për faktin se ato përdoren për të përcaktuar sjelljen e një individi. Teoria e normave sociale sugjeron se kur studentët perceptojnë se shumica e bashkëmoshatarëve të tyre përfshihen në një sjellje të caktuar, vetë ata kanë më shumë gjasa ta bëjnë këtë, pavarësisht nëse bashkëmoshatarët e tyre po veprojnë në mënyrë të drejtë apo jo. (Scholly, Katz, Gascoigne, & Holck, 2005:160). Lear (1997), konstatoi se kur miqtë përjetojnë ndryshime në vlerë dhe besim, kjo shkakton “presion normativ”, një rezultat i përpjekjeve të shokëve për të ndikuar të tjerët ndaj mënyrës së tyre të të menduarit. Kjo e çoi Lear në komentin se “Njerëzit shpesh kërkojnë shokë me vlera të ngjashme sepse ata përforcojnë sjelljen e dëshiruar të njëri-tjetrit” (Lear, 1997:26).

Studiuesit kanë përdorur një shumëllojshmëri të qasjeve për analizimin e marrëdhënieve midis shikimit të televizionit, përdorimit të internetit si dhe qëndrimeve dhe sjelljeve seksuale. Një shpjegim alternativ për ndikimin e televizionit dhe internetit në sjelljen seksuale të shikuesit është teoria sociale konjitive e Bandura-s që mbështetet në teorinë e tij të mëparshme e të mësuarit social, sipas të cilës njerëzit kanë aftësinë e të mësuarit nga ndërveprimet e ndryshme sociale në të cilat angazhohen në jetën e përditshme qoftë kjo edhe media, prindërit apo bashkëmoshatarët për pjesën më dërrmuese të të rinjve (Bandura, 1973:34). Kjo përfshin ndërveprimet me njerëz të tjerë, të tillë si me miqtë, si dhe ndërveprime me personazhet dhe modelet e hasura në media të ndryshme të tilla si muzikë, revista dhe televizioni, interneti, etj. Njerëzit përdorin situatat që kanë përjetuar në të kaluarën, si reale edhe në media, si bazë për veprimet që zgjedhin të ndërmarrin. Kjo është veçanërisht e vërtetë në fushën seksuale, pasi ka pak mundësi jomediatike për të rinjtë për të mësuar se cilat sjellje janë të përshtatshme apo të pranueshme (Sutton et. al. , 2002:53). Kështu, duke u mbështetur në teorinë e normave sociale dhe atë të të mësuarit social, u hipotezua se në fakt media dhe bashkëmoshatarët janë dy modele kryesore që mund të influencojnë tek studentët, krahasuar me shkollën, familjen apo fenë si tri institucione sociale mjaft të rëndësishme.

1. 5. Shtrimi i problematikës/ Pse ky studim?

Shumica e të rinjve (rreth 80%) në SHBA fitojnë përvojë seksuale gjatë viteve të tyre të adoleshencës, zakonisht nga mesi deri në fund të kësaj periudhe (Singh & Darroch, 1999: 211). Sociologët kanë qenë të interesuar për një kohë të gjatë në shpjegimin e kalimit në marrëdhënien e parë seksuale të adoleshentëve, jo vetëm ngaqë është e lidhur me

shtatzaninë e paplanifikuar, formimin e hershëm të familjes dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme (Berman & Rein, 1999:129; Moore, Driscoll & Lindberg, 1998:32), por edhe se marrëdhënia seksuale është një tregues i rëndësishëm i zhvillimit të adoleshentëve (Meschke, Tholomae & Zentall, 2000:145). Ky interes ka çuar në një literaturë të zgjeruar mbi seksualitetin e adoleshentëve, shtatzaninë dhe përdorimin e kontraktivëve. (Meschke, Tholomae & Zentall, 2000:147). Shumica e studimeve janë fokusuar në identifikimin e karakteristikave familjare socio-demografike të lidhura me sjelljet seksuale të adoleshentëve. Çfarë nuk kuptohet mirë, janë faktorët më të ngushtë që ndikojnë tek vendimet e të rinjve për t'u përfshirë në veprimtari seksuale (Carvajal et.al., 1999:443). Këta faktorë janë të rëndësishëm për t'u shpjeguar, pasi mund të ndihmojnë përfundimisht në perceptimin tonë mbi mënyrën sesi faktorë më socialë të jashtëm, për shembull miqtë, shokët dhe shoqet, struktura familjare dhe të tjera kategori sociale, ndikojnë tek sjellja seksuale në nivel individual (Baumer & South, 2001:551).

Ky studim ofron një ekzaminim teorik dhe empirik të mënyrave nga ku të rinjtë marrin informacion mbi marrëdhëniet seksuale dhe etikën e sjelljes seksuale, si dhe mundësinë e institucioneve sociale për të garantuar një edukim seksual të ri dhe më të hapur për të rinjtë në Shqipëri. Pjesë e këtij studimi janë studentët që ndjekin studimet e larta në universitetet shqiptare, që konsiderohen edhe si ajo pjesë e shoqërisë që demonstroi më thellë dhe më gjerë ndryshimin e sjelljes seksuale edhe si shkak i zhvillimit dhe rritjes së tyre në një periudhë tranzitore postkomuniste, ku liria e veprimit dhe sjelljes mori përmasa të tjera, ku të gjitha institucionet sociale pësuan ndryshime rrënjësore (familja, arsimi, media, feja dhe mentaliteti i bashkëmoshatarëve për sjelljen seksuale); demonstroi më qartë mundësinë që kanë pasur deri më sot këto institucionet për të edukuar brezat e rinj, duke u mbështetur në

një periudhe moderne e demokratike, në nevojën për një qasje të re për edukimin seksual etik të të rinjve.

Nëpërmjet këtij studimi synohet të analizohet mundësia që kanë institucionet shoqërore që të edukojnë dhe modelojnë sjelljen seksuale të të rinjve, jo mbi bazat e moralit shoqëror, normave dhe qëndrimeve tradicionale për të frenuar aktin seksual, në një kohë ku sjellja seksuale ka pësuar ndryshime të thella tek të rinjtë e viteve 2000, krahasuar me ata të viteve '90 e më parë, por mbi një moral dhe etikë të re që iu shkon përshtat gjithë zhvillimeve sociale të vendit tonë.

Sot, studentët konsiderohen nga shumë autorë si grupi social më i rriskuar nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe HIV-AIDS, sepse në shumë vende të Europës dhe botës moderne, të rinjtë në universitete në 80% të tyre e kanë nisur aktin e parë seksual në kohën kur ata kanë nisur studimet e larta (Shih: Williams, 2012:43; Rimaza, 2005:9; Roberts 2006:61; Randolph, Pinkerton et. al. , 2007:234; Lewis, 1997:23; Shapiro, 1999:22; Gullette & Lyons, 2006:121; Davis, 2007:56; Randolph, Pinkerton et. al. , 2007:211).

Të rinjtë në universitet janë më të predispozuar që të kenë më shumë se një partner njëherësh, e nga ana tjetër, si shkak i normave dhe moralit të shoqërisë të mos jenë të lirë të kujdesen gjatë aktit seksual, e për rrjedhojë të rrezikojnë për shtatzani të parakohshme dhe aborte (Arnett, 2000:453), e deri në pasojat në shëndetin seksual që mund të jenë afatgjata, shpesh gjatë gjithë jetës, dhe mund të shoqërohen me pasoja fizike, psikologjike dhe emocionale apo me rritje të divorceve, të foshnjave të lindura nga nënat e pamartuara adoleshente, monogami seriale, mosfunksionim seksual, infertilitet, dhe dhunë seksuale. Vendimet seksuale dhe sjellja seksuale e të rinjve do të ndikojë, jo vetëm tek ata si individë, por edhe tek ata që kanë rezultuar të kenë impakt të qëndrueshëm tek familjet, kolegët dhe

komunitetet me të cilët shkëmbejnë marrëdhënie qoftë edhe informacioni (Williams, 2012:91; Eaves, 2007:6). Në këto kushte sociale, morali për frenimin e marrëdhënieve seksuale në familje dhe mbarë shoqërinë, apo programet e edukimit seksual në institucionet e arsimit që mbështeten tek abstenenca (*frenimi i dëshirës seksuale*), në një kohë kur media luan një rol të jashtëzakonshëm në informimin e të rinjve mbi sjelljen seksuale, informacion që nuk e gjejnë në familje, shkollë apo institucione fetare, duket që ka qenë i dështuar, për aq kohë sa nuk kanë dhënë efektin e duhur tek të rinjtë edhe në shumë vende të tjera të botës (Eaves, 2007:21). Sipas Chng dhe Moore (1994), është fenomen i njohur që studentët kanë tendencë për të eksperimentuar shpesh me seksin gjatë kohës së studimeve të larta e sidomos nëse jetojnë në konvikte larg familjes. Sipas teorisë së normave sociale, këto sjellje të studentëve në të vërtetë mund të promovojnë imoralitet, sepse njerëzit priren të mbivlerësojnë dhe modelojnë më lehtë sasinë e sjelljes negative apo të sëmundjeve që po ndodhin rreth tyre dhe nënvlerësojnë numrin e vendime pozitive të shëndetshme që bashkëmoshatarët e tyre mund të bëjnë çdo ditë (Chng & Moore, 1994:65; Perkins, 2002:167). Natyrisht që pretendimi për modelimin e sjelljes seksuale etike të të rinjve është një sfidë e vështirë, e mbi të gjitha nëse ajo bazohet mbi imoralitetin apo moralen, pa u mbështetur në të gjitha kushtet e reja sociale që domosdoshmërisht kërkojnë qëndrime të reja ndaj asaj çfarë një shoqëri do të quaj morale apo imorale, na çon drejt një dështimi në vazhdim. Nevoja për një botëkuptim tjetër, i cili ndihmon të rinjtë të diferencohen nga sjellje seksuale të rrezikshme për shëndetin, por pa predikuar moskryerjen e aktit seksual si më e mira e mundshme për ta, apo si shpëtim nga çdo e keqe imorale, e pa u bazuar vetëm në efektet negative të marrëdhënies seksuale, kërkon një bashkëpunim të të gjithë shoqërisë në mënyrë që të mund ndërtohet një sistem i ri vlerash morale që i përshtaten kohës në cilën

jetojmë (:276). Mbështetur mbi faktet më lart mbi sjelljen seksuale të studentëve, dhe në dëshirën për të dhënë një kontribut sado të vogël në krijimin e një botëkuptimi të ri të vlerave dhe moralit të sjelljes seksuale etike, mori shkas edhe ky studim, që në dijeninë time është studimi i parë në Shqipëri.

1. 6. Qëllimi i studimit dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i sjelljes seksuale dhe etikës, si dhe impaktit që kanë institucionet sociale si: familja, bashkëmoshatarët, institucionet e arsimit , besimi fetar dhe media në sjelljen seksuale dhe etikën seksuale të studentëve në Shqipëri në kushtet e një morali shoqëror që është trashëguar nga periudha e komunizmit, duke bërë të mundur analizimin e faktorëve që sjellin ndryshim në modelimin e sjelljes seksuale etike të të rinjve, si dhe nevojën për një etikë të re seksuale. Kështu, objektivat e këtij studimi janë; 1) Vlerësimi i etikës seksuale si dhe i sjelljes seksuale të studentëve në Shqipëri. 2) Analizimi i institucioneve që mund të sjellin ndryshim në modelimin e sjelljes etike seksuale të studentëve në Shqipëri. 3) Identifikimi i impaktit të institucioneve sociale (familja, bashkëmoshatarët, shkolla, besimi fetar, media) në sjelljen seksuale të studentëve. 4) Identifikim i impaktit të institucioneve sociale tek të rinjtë që kanë kryer marrëdhënie seksuale në krahasim me ata që nuk kanë kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale. 5) Identifikimi i impaktit të moralit për frenimin e aktivitetit seksual në sjelljen seksuale dhe etikën e studentëve në Shqipëri.

1. 7. Pyetjet kërkimore

Interesi im si studiuese mbi sjelljen seksuale dhe etikën e sjelljes në një shoqëri tranzitore si kjo shqiptare, bëri që ky studim të ngrihet mbi disa pyetje kërkimi të cilat çuan më tej në hartimin e modelit konceptual mbi të cilin u mbështetën edhe hipotezat studimore. Pyetjet kërkimore të këtij studimi kanë karakteristika të ndryshme si; përshkruese, ku synohet që nëpërmjet kësaj pyetjeje të përshkruhet sjellja seksuale e studentëve në Shqipëri si dhe të evidentohen dallimet ose jo gjinore në sjelljen seksuale. Gjithashtu, ka pyetje me karakter vlerësues si; pyetjet kërkimore, që kërkojnë të nxjerrin në pah se cili institucion social influencon më shumë në sjelljen seksuale etike të studentëve, sa ndikojnë në fakt institucionet sociale në modelimin e sjelljeve seksuale të studentëve, si dhe sa ndikon morali mbi sjelljen seksuale në modelimin e sjelljes seksuale etike?

Natyra e këtij hulumtimi merr karakter përshkrues dhe vlerësues, duke u përpjekur të përshkruaj realitetin e sjelljes seksuale të të rinjve, si dhe vlerësimin e impaktit të institucioneve të caktuara sociale, dhe moralit të shoqërisë në sjelljen seksuale të të rinjve.

Pyetjet kërkimore të këtij studimi janë;

- Cila është sjellja seksuale dhe etika e studentëve shqiptarë?
- A ndikon morali i shoqërisë dhe institucionet sociale në sjelljen seksuale?
- Sa ndikojnë institucionet sociale në sjelljen seksuale etike në radhët e studentëve në Shqipëri?
- A ka dallime gjinore në sjelljen seksuale etike të studentëve në Shqipëri?

1. 8. Modeli konceptual i studimit dhe hipotezat kërkimore




Figura No. 1: Modeli konceptual i studimit

Duke u mbështetur në këtë model konceptual u ngritën edhe hipotezat e këtij studimi, nëpërmjet të cilave tentohet të analizohen marrëdhëniet mes variabëlve kryesorë të këtij punimi. Hipotezat e këtij studimi mbështeten mbi pyetjet kërkimore, nëpërmjet të cilave u morën në shqyrtim marrëdhëniet mes variabëlve të studimit. Janë ngritur hipoteza shkakësore që pohojnë se me ndryshimin e njërit variabël ndryshon edhe një apo më shumë variabëla të tjerë, si dhe hipoteza të ndërtuara me marrëdhënie shoqërizuese mes variabëlve

për të vërtetuar bindjen se midis dy a më shumë variabëlve ekziston një marrëdhënie. Ku në vijim u pohua se:

H₁. Morali që institucionet sociale përdorin për edukimin seksual të të rinjve nuk ndikon në frenimin e sjelljes seksuale.

H₂. Roli i prindërve në sjelljen seksuale të të rinjve ka rënë ndjeshëm si shkak i influencës së madhe që kanë bashkëmoshatarët dhe media.

H₃. Institucionet e arsimit dhe besimit fetar nuk influencojnë në sjelljen seksuale të studentëve shqiptarë.

H₄. Institucionet sociale (familja, bashkëmoshatarët, arsimi, feja dhe media) nuk ndikojnë në modelimin e një sjelljeje seksuale etike në radhët e studentëve në Shqipëri.

H₅. Nuk ekzistojnë dallime gjinore esenciale në sjelljen seksuale në radhët e studentëve shqiptarë.

1. 9. Përkufizimet operacionale

Sjellja seksuale: Shumë autorë e përkufizojnë sjelljen seksuale të individëve si marrëdhënie seksuale vaginale, anale, orale, me një ose më shumë partnerë të së njëjtës gjini ose të një gjinie tjetër. Gjithashtu, masturbimi dhe forma të tjera të vetëstimulimit të dëshirës seksuale konsiderohen si pjesë e sjelljes seksuale të një individi (Shih: Williams, 2012:112; Bogart, Cecil, Wagstaff, Pinkerton, & Abramson, 2000:110; Boies, 2002:65; O'Reilly, Knox, & Zusman, 2007:362; Pritchard, 2008:54).

Etika e sjelljes seksuale: Pëlqimi i ndërsjellët i partnerëve seksualë për inicimin e një akti seksual, mos dëmtimi i partnerit, përgjegjësia në vendimmarrjen për marrëdhënie seksuale, mirëkuptimi dhe shqetësimi për ndjenjat e partnerit seksual, si dhe kryerja e aktit seksual nën masa mbrojtëse (Strong et. al. , 1999:34; Greenberg et. al. , 2000:121; Allgeier & Allgeier, 2000:43).

Morali i sjelljes seksuale: Ndrydhja dhe frenimi i marrëdhënieve seksuale, si shkak i moralit të shoqërisë që predikon se marrëdhënia seksuale jashtë martese është veprim imoral që çon në shtatzani jashtë martese, sëmundje, vuajtje dhe probleme të ndryshme psikologjike e sociale (Bazerman & Gino, 2012:89; Winch, 2005:203; Miller, 2002:23).

Studentë: Të rinj të cilët ndjekin studimet e larta në universitetet shqiptare private dhe publike në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, të cilët kanë mbushur moshën 18-vjeç.

Familja: Grup social që kanë përgjegjësi për rritjen, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve të tyre (Giddens, 2007:57). Familjet mund të jenë të krijuar nga fëmijë me prindër biologjikë, nga njerku/njerka, nga prindër adaptues, nga motra dhe vëllezër, gjyshër e gjyshe, të cilët kanë qëllim kryesor kujdesin, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve të tyre (Heisler, 2005:310; Riley, 2011:112). Në këtë studim është marrë në konsideratë impakti i prindërve (*biologjik ose jo*) dhe i motrave e vëllezërve në sjelljen seksuale.

Bashkëmoshatarët: Bashkëmoshatarët janë shokët dhe shoqet me të cilët të rinjtë në universitete frekuentojnë dhe ndajnë eksperiencë jetësore përfshi edhe informacionin mbi marrëdhëniet seksuale, që janë përkatësisht të rinj të një brezi (Mirande, 1968:575; Majumdar, 2003:78; Eaves, 2007:114).

Institucionet e arsimit: Institucione të edukimit dhe arsimit të fëmijëve dhe të rinjve, në të cilat për edukimin seksual përdoren programe të ndryshme duke u mbështetur në programe të abstinencës seksuale ose në programet gjithëpërfshirëse të edukimit seksual, të cilat ndihmojnë të rinjtë të përgatiten për pasojat e mundshme, por edhe kënaqësitë që ofron marrëdhënia seksuale në jetën e një njeriu (Seifert, 2006:32), ku me programe abstinence, iu referohem programeve të edukimit seksual, që kanë si qëllim frenimin e dëshirës seksuale dhe shtyrjen e marrëdhënies së parë seksuale tek të rinjtë deri në kohën e martesës, dhe për të rinjtë që rezultojnë të kenë kryer marrëdhënie seksuale këto programe nxisin përdorimin e kontraktivëve dhe prezervativëve (Lewis, 2010:65); si dhe programeve të edukimit seksual gjithëpërfshirës, që u japin nxënësve një gamë të gjerë të dijes mbi sjelljes seksuale dhe seksualitetin e njeriut. Mund të fillohet në një moshë shumë të hershme, që në kopsht, duke iu mësuar fëmijët informacionin e duhur sipas moshës. Këto programe të edukimit seksual u japin studentëve të dhëna mjekësore dhe informacion të saktë në lidhje me kontraktivët, shtatzanitë, sëmundjet ngjitëse seksuale dhe HIV / AIDS, të dhëna për format e riprodhimit dhe funksionin biologjik riprodhues, informacion mbi dashurinë, emocionin, kënaqësitë dhe përfitimet që sjell një marrëdhënie seksuale e shëndetshme. Programet ofrojnë edukim në lidhje me preferencat seksuale, si homoseksualiteti, biseksualiteti, heteroseksualiteti, duke nxitur një tolerancë dhe respekt për preferencat seksuale të çdo individi. Gjithashtu, këto programe aftësojnë të rinjtë që të respektojnë partnerët seksualë dhe vetveten, dhe të reagojnë në rastet e ngacmimeve apo dhunës seksuale në organe kompetente (Jumper, 2014:211).

Besimi fetar: mund të përkufizohet në disa dimensione si: (1) doktrinor dhe filozofik (p.sh, çfarë feja beson të jetë e vërtetë, si për shembull Zoti që krijoi botën), (2) etik ose ligjor

(p.sh. drejtues ose virtyte të një feje), (3) ritualistik ose praktik (p.sh. lutja, ndjekja e shërbimeve të adhurimit fetar ose ndërmjetësimi), dhe (4) social ose institucional (p.sh. aspekti shoqëror). Pra, *besimi fetar* i një individi mund të përcaktohet gjerësisht nga dedikimi i tij ose i saj ose respekti i një ose më shumë prej dimensioneve të mësipërme fetare. Sipas Smart (2000) dhe shumë autorëve të tjerë në studimet të rishikuara, shumë kërkues kanë prekur dimensionin ritualistik ose praktik, ku janë përdorur mjete objektive për vlerësimin e besimit fetar (*p.sh. vajtja në kishë, pjesëmarrja në praktika fetare*) (Shih: Smart, 2000:43; Holder, DuRant, Harris, Daniel, Obeidallah, & Goodman, 2000:297; Reed & Meyers, 1991:945; Zaleski & Schiaffino, 2000:225; Lammers, Ireland, Resnick, & Blum, 2000:45; Pluhar, Frongillo, Stycos, & Dempster-McClain, 1998:477).

Media: Ose masmedia ndryshe konsiderohet si (*televizioni , revista, librat, interneti etj*) që sigurojnë portretizime gjithnjë e më të shpeshta të seksualitetit dhe sjelljeve seksuale, prej ku të rinjtë sigurojnë informacione të shumta (Brown, 2002:46; Perera, 2005:26).

1. 10. Përqasja metodologjike e studimit

Përqasja e këtij studimi nis me një analizë teorike deduktive, duke lëvizur nga marrëdhëniet logjike të njohura mes koncepteve, drejt provave empirike të cilat u përftuan mbështetur në metodën e triangulacionit. Tematika tejet delikate e këtij studimi, nuk mund të mblidhte të dhëna empirike duke e mbështetur vetëm në një metodë studimi. Për rrjedhojë, kjo metodë e përzierë u përdor me synimin e të parit të rasteve dhe ngjarjeve në dy këndvështrime të ndryshme, duke përdorur teknikat e metodologjisë sasiore dhe cilësore (Matthews & Ross, 2010:239). Sipas Tashakkori dhe Teddlie (1998), duke përdorur një model të përzier

metodologjik, siç është triangulacioni, pasurojmë gjetjet origjinale të asaj analize të veçantë të të dhënave sasiore në përzierje me ato cilësoret, ku të dyja plotësojnë njëra-tjetrën si metoda, pa zbehur rëndësinë e tyre në një studim (Tashakkori & Teddlie, 1998:59). Kështu, përpos anketimeve me çdo rast të përzgjedhur sipas procedurave të kampionimit, u realizuan edhe intervista gjysmë të strukturuar me studentë pjesë të kampionit studimor, ku, në total janë kontaktuar rreth 1488 studentë që ndjekin studimet në universitetet publike dhe private në Shqipëri, përkatësisht studentë të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.

1. 14. Impakti shkencor i studimit

Ky studim i pari në llojin e tij për vendin tonë, përveç vlerësimit të sjelljes seksuale të studentëve, ekzaminon edhe faktorët që mund të çojnë drejt një sjelljeje etike seksuale, duke ndryshuar kështu konceptin e vjetruar të etikës në marrëdhëniet seksuale të studentëve dhe duke e përshtatur atë me kushtet e reja sociale në të cilat manifestohet sjellja seksuale e studentëve shqiptarë.

Studimi ofron një ekzaminim të mundësive që kanë institucionet sociale si; familja, arsimimi, bashkëmoshatarët, feja dhe media në frenimin e aktivitetit seksual apo nxitjen e një etike të re seksuale në kushtet e një revolucioni seksual.

Ekzaminimin e formave të edukimit mbi marrëdhënien seksuale dhe etikën e sjelljes në familjet shqiptare, duke evidentuar sesa realisht tematikat mbi seksin dhe marrëdhënien diskutohen në familjet shqiptare dhe se mbi cilat baza mbështeten diskutime të tilla; mbi

baza moralit të shoqërisë, komunikimit të hapur e demokratik me qasje drejt etikës seksuale apo forma tabu, ku sjellja seksuale dhe marrëdhënia seksuale janë tematika të ndaluara në familje.

Studimi gjithashtu ofron, ekzaminimin e formave të edukimit seksual në shkollat shqiptare dhe mundësinë për një nxitje të sjelljeve seksuale etike, duke testuar modelin e programeve të përdorura në vendin tonë për edukimin seksual të të rinjve, nëse ai është një qasje drejt programeve të abstinencës seksuale apo një program mbi baza të edukimit gjithëpërfshirës.

Ekzaminimi i modeleve të edukimit të sjelljes seksuale që shkakton media dhe bashkëmoshatarët si një grup me influencë të madhe tek studentët, si dhe pamundësinë që kanë këto institucione shoqërore për të ofruar një etikë të re në sjelljen seksuale të studentëve, si shkak i qëllimit të funksionimit të tyre që në thelb është shumë pak edukues e sidomos kur flitet për sjelljen seksuale, që gjasat janë të mëdha për një impakt negativ.

Dhe së fundi, studimi thekson pamundësinë që kanë institucionet fetare për të modeluar një sjellje seksuale etike në radhët e të rinjve shqiptarë e kryesisht atyre që konsiderohen si besimtarë dhe frekuentues të një besimi të caktuar fetar, pikërisht si shkak i normave morale doktrimore për sjelljen seksuale që kanë karakteristikë këto institucione sociale në mbarë botën.

Në thelb, përveç paraqitjes teorike me një analizë të gjerë me autorët më në zë të fushës së sociologjisë, seksualitetit, seksologjisë dhe sjelljes seksuale, studimi mbështet edhe në analizën empirike, e cila e mbështetur në analizën teorike teston hipotezat e këtij studimi dhe variablat kryesorë, nga ku dalin edhe rezultatet përfundimtare që ofrojnë një themel të ri në fushën e etikës së sjelljes seksuale dhe hapave konkretë që duhen ndërmarrë për të

parandaluar fenomene të pakëndshme e vuajtje të kota sociale, të cilat predikohen mbi bazat e së mirës apo së keqes relative, subjektive e shoqërore.

14. Limitet e studimit

Do të ishte ideale që ky studim të mos kishte asnjë limit, por kjo në kushte shkencore dhe me një tematikë të kësaj natyre mbetet praktikisht e pamundur.

Në Shqipëri, tematikat mbi sjelljen seksuale dhe marrëdhëniet seksuale janë pak ose aspak të trajtuara, dhe kjo, jo vetëm përpara viteve '90 që nuk ekziston asnjë studim teorik dhe empirik i cili mund t'i vinte në ndihmë këtij studimi, por edhe pas viteve '90, autorët që kanë ndërmarrë të studiojnë këtë fushë janë të pakët, përpos faktit që, edhe nëse ka studime, janë të trajtuar kryesisht si një analizë teorike e autorëve të huaj, por pak e mbështetur në realitetin shqiptar. Për rrjedhojë, mangësitë e studimeve shqiptare e kanë bërë të vështirë një analizë teorike, e cila të mund të demonstronte ndryshimet e mendësive të të rinjve në sjelljen seksuale. Ndaj, studimi është mbështetur në studime të autorëve të huaj, që prej klasikëve e deri tek më bashkëkohorët, duke u përpjekur të analizohen dhe krahasohen me atë që ishte e mundur me kushtet sociale në të cilat ndodhet sot vendi ynë.

Me gjithë përpjekjet akademike e shkencore, trajtimi i etikës së sjelljes seksuale në vetvete mbeten një detyrë e vështirë, sepse është një konstrukt empirik i vështirë për t'u testuar edhe për faktin që instrumentet matës ndërtohen mbi mbledhjen e opinionëve dhe qëndrimeve të të rinjve për sa i përket sjelljes seksuale etike dhe faktorëve që ndikojnë në të. Kësisoj, edhe shkencërisht është e vërtetuar se në këto raste studimesh duhet të bëjmë

maksimumin që të respektojmë të gjitha kriteret e një studim etik shkencor, të mbështetur mbi një vlefshmëri dhe besueshmëri studimi, e cila të mundet të garantojë qëndrueshmërinë e studimit pavarësisht limiteve që mund të kenë opinionet dhe qëndrimet si shkak i të qenit relative dhe të ndryshueshme në kohë të ndryshme.

Një tjetër limit i studimit ka qenë fakti se të qenit studiuese femër mund të ketë ndikuar në intervistat ballë për ballë me meshkujt më shumë sesa me intervistat e realizuara me femrat, kjo si shkak i mendësive që kanë meshkujt në shoqëri patriarkale ku duan të shfaqen aktivë dhe potencialë në lidhje me jetën e tyre seksuale përpara një femre, megjithëse ka edhe studime të cilat deklarojnë se seksi i kundërt i të intervistuarit me studiuesin është më i këshilluar në intervistat ballë për ballë.

Në lidhje me fenë dhe besimin fetar një tjetër limit është fakti se me gjithë përpjekjet e këtij studimi është ende e vështirë për të përcaktuar se çfarë do të thotë “shpirtërore” ose “fetare” në rastin e Shqipërisë, ku haset vështirësi në përcaktimin e një përkufizimi të paanshëm me karakteristika të qarta dalluese. Edhe pse ka të ngjarë që shumë njerëz mund të kenë të dy cilësitë fetare dhe shpirtërore.

Para së gjithash , ky është një studim korrelacional, i cili tenton të tregojë dhe nxjerrë në pah se sa ndikojnë institucionet sociale në sjelljen seksuale etike, por nuk ka për qëllim të evidentojë shkaqet se pse ndodh ky fenomen. Kjo vjen si shkak i natyrës së studimit, numrit të madh të variablave studimore, por edhe sepse kërkon një formë tjetër analize empirike e teorike.

KAPITULLI II: RISHIKIM LITERATURE

2. 1. Impakti i familjes në sjelljen seksuale etike të studentëve

2. 1. 1. *Struktura e familjes shqiptare dhe impakti në sjelljen seksual të të rinjve*

Shumë sociologë mund të kenë analizuar strukturën dhe karakteristikat e familjes shqiptare të viteve të tranzicionit, një ndër ta është edhe profesor Tarifa, që në një prej punimeve të tij thekson se:

“Familja shqiptare është një institucion që po përjeton të gjitha ato dukuri dhe ndryshime që karakterizojnë mbarë shoqërinë shqiptare dhe konkretisht pesë janë ndryshimet kryesore në tiparet e familjes së sotme shqiptare: (1) ndryshimi i strukturës së familjes dhe i karakteristikave demografike të saj; (2) ndryshimi i marrëdhënieve martesore e familjare në qytet dhe në fshat, si edhe ndryshimi i marrëdhënieve bashkëshortore, të para kryesisht si raporte midis burrit dhe gruas për sa i përket pozitës, të drejtave dhe rolit të tyre në familje dhe jashtë saj; (3) ndryshimi i funksioneve tradicionale të familjes; (4) ndryshimi i marrëdhënieve midis brezave në familje, sidomos i marrëdhënieve midis prindërve dhe fëmijëve; (5) dhe për rrjedhojë një etikë e re seksuale që gjithnjë e më shumë karakterizon sjelljen seksuale të një pjese të madhe të shoqërisë, veçanërisht të brezit të ri (Tarifa, 2012:11)”.

Është e qartë se të gjitha këto kanë bërë që të ketë qëndrime dhe sjellje seksuale më liberale tek të rinjtë. Por a janë në gjendje prindërit që ta pranojnë këtë fakt dhe sa munden ata që të jenë të gatshëm për të edukuar si duhet fëmijët e tyre me informacion mbi marrëdhënien seksuale, apo sa munden ta pranojnë revolucionin seksual të shfaqur në sjelljen e brezave të rinj? Në shumë studime në shoqëritë perëndimore mesazhet seksuale prindërore ose komunikimi seksual rezultojnë të jenë të mbushura me mesazhe seksuale të standardeve të

dyfishtë për meshkujt dhe femrat, por femrat në shoqëri tranzitore marrin mesazhe në lidhje me seksin më shumë kufizuese dhe me karakter moral sesa meshkujt (Miller, 2012:121 ; Darling & Hicks, 1989:242.; Downie & Coates, 1999:120; Kim & Ward 2007:30), dhe ky mund të jetë një rast tipik i Shqipërisë. Pothuajse të gjitha studimet kanë konstatuar se komunikimi seksual i prindërve me fëmijët është komunikim verbal dhe joverbal (Kim & Ward, 2007:25), por disa studiues kanë zbuluar se disa komunikime, të tilla si vlerat dhe etika seksuale, shprehen më shumë në mënyrë joverbale sesa në mënyrë verbale nëpërmjet komunikimit të mirëfilltë (Hovell et. al. , 1994:979). Dallimet gjinore në vendosjen e këtyre rregullave mund të ndikojnë në perceptimin e adoleshentëve për një standard të dyfishtë seksual, të shprehur nëpërmjet komunikimit jo verbal nga prindërit tek fëmijët (Vik, 2012:201). Natyrisht që të gjithë autorët theksojnë që prindërit janë me interes parësor për edukimin seksual të fëmijëve të tyre, por Lefkowitz dhe Espinosa-Hernandez (2007), sugjerojnë se të rinjtë kanë më shumë gjasa të diskutojnë mbi temat seksuale me shokët e tyre të të njëjtit seks se sa me prindërit e tyre, veçanërisht në periudhën e kalimit të tyre në universitet dhe kjo për një mori faktorësh (Lefkowitz & Espinosa-Hernandez, 2007:18), por që duken edhe më të shumtë në shoqëri të tilla si Shqipëria e cila vazhdon të përjetojë probleme të shumta sociale në familje si shkak i shumë faktorëve të prodhuar gjatë tranzicionit (Tushi, 2007:68).

2. 1. 2. *Format e komunikimit seksual në familje*

Për të kuptuar se sa efektiv ka qenë komunikimi midis të rinjve dhe prindërve të tyre rreth sjelljes seksuale, periudha e universitetit mund të jetë thelbësore, pasi shkëputja nga prindërit dhe liria e veprimit mund të manifestojë të gjithë gamën e problematikave ose jo

të komunikimit me prindërit lidhur me çështjet e seksualitetit të fëmijëve. Edhe pse komunikimi me njerëzit e tjerë (që përfshijnë partnerët romantike, shokët, mësuesit) ndikon në sjelljen seksuale, studime të mëparshme tregojnë se komunikimi me prindërit ndikon në sjelljen seksuale dhe etikën e saj në varësi të modeleve të përdorura të komunikimit. Edhe pse shpeshësia e komunikimit është vetëm një lidhje midis komunikimit dhe sjelljeve seksuale etike, ekziston mundësia që normat kulturore, ndikimet fetare, vlerat dhe morali, si dhe faktorë të tjerë komunikues dhe sociologjikë të vazhdojnë të ushtrojnë ndikimin e tyre në këtë tematikë delikate diskutimi mes prindërve dhe të rinjve (Vik, 2012:203).

Procesi i komunikimit veçanërisht kur është i hapur dhe pa probleme, është konstatuar të jetë i lidhur me diskutimet mbi seksualitetin dhe etikën dhe sjelljen midis prindërve dhe fëmijëve (Pluhar, et. al. , 2008:39; Fisher, 1990:53; White et. al, 1995:329). Në mënyrë të ngjashme, prindërit të cilët i kanë përshkruar marrëdhëniet me fëmijët e tyre si të afërta kanë raportuar se kanë pasur më tepër komunikim mbi seksin ndërsa prindërit të cilët janë më të rreptë dhe më autoritarë kanë komunikuar që të kenë pasur më rrallë diskutime rreth tematikave seksuale ose aspak dhe se nëse ato kanë ekzistuar kryesisht kanë nuancat e asaj çfarë është e moralshme ose e pamoralshme (Coreil & Parcel, 1983:25). Mes dy prindërve, në studimin e Raffaelli-t dhe studiuesve të tjerë, ka rezultuar se studentët kanë biseduar mirë me nënat e tyre në lidhje me çështjet personale, ku kanë raportuar gjithashtu më tepër diskutim mbi tema seksuale dhe etikën e sjelljes (Raffaelli et. al. , 1998:321).

Gjithsesi, edhe pse prindërit shprehen se komunikimi në lidhje me seksualitetin është i rëndësishëm (Rosenthal, Feldman & Edwards, 1998:378), ka pak të ngjarë të ketë komunikim prind-adoleshent mbi çështjet seksuale, edhe nëse ato ekzistojnë kanë baza të

forta morale (Meschke & Dettmer, 2012:109; Rosenthal & Feldman, 1999:850) sepse kryesisht biseda të tilla fokusohen më shumë në tema më pak intime që, sipas prindërve, kanë karakter më edukues, si temat mbi shtyrjen e aktivitetit seksual, sesa diskutimet mbi etikën seksuale siç janë p. sh. sëmundjet seksualisht të transmetueshme apo përdorimi i prezervativit, dashuria dhe përgjegjshmëria në marrëdhënie (McDermott et. al, 2008:341; Hutchinson & Cooney, 1998:189.). Në veçanti nënat edhe pse janë prindi i cili flet më shumë me fëmijët mbi seksin, kanë tendencën që të nënvlerësojnë sjelljen seksuale të adoleshentëve të tyre, madje ato nisin diskutimet përciptas me fëmijët vetëm nëse kuptojnë që fëmija i tyre ka nisur aktivitetin seksual, që kryesisht kjo kuptohet në një kohë shumë më të vonë sesa akti i parë seksual (Jaccard, Dittus & Gordon, 1998:251). Prindërit besojnë gjithashtu se nuk kanë informacion të mjaftueshëm për këto diskutime dhe se këto biseda nuk do të jenë efektive, do të shkojnë keq ose do të krijojnë situatë të sikletshme për rrjedhojë nuk marrin iniciativë që të nisin komunikimin për tema të tilla në mënyrë të drejtpërdrejtë me të rinjtë. (Guilamo-Ramos et. al, 2006:173; Jaccard, Dittus & Gordon, 2000:192; Rosenthal, Feldman & Edwards, 1998:733).

Pengesat kryesore se përse prindërit mund t'i shmangen temave të tilla mund të jenë të ndryshme, përfshirë turpin, mungesën e informacionit të saktë dhe aftësitë jo të mira komunikuese që ndikojnë në vështirësinë që kanë prindërit për të diskutuar me fëmijët e tyre mbi seksualitetin në mënyrë efektive dhe etike (Ballard & Gross, 2009:48; Hutchinson & Cooney, 1998:191).

Autorë të tjerë pohojnë se komunikimi në lidhje me seksualitetin dhe seksin ndikohet fuqishëm nga disa faktorë si: kapaciteti i prindërve dhe i fëmijëve për të filluar dhe për të

mbajtur të hapur një dialog mbi këtë fushë, njohuritë që kanë prindërit mbi shëndetin seksual dhe atë riprodhues, si dhe normat kulturore së bashku me besimet dhe vlerat etike personale të cilat karakterizojnë mjedisin familjar (Rouvier et. al. , 2011:183; Lehr et.al., 2005:121; Dilorio et. al, 2000:50). Kur marrëdhënia mes prindërve dhe fëmijëve është pozitive, vlerat etike ndahen më lehtë dhe mund të ndikojnë në vendimet e një të riu për sjellje seksuale etike (Resnick et. al, 1997:824; Garnier & Stein, 1998:97). Gjithsesi, për shumë autorë është e qartë se edhe nëse prindërit nuk diskutojnë kurrë me fëmijët e tyre mbi seksualitetin, ata mbeten edukatorët kryesorë mbi seksualitetin, sepse gjatë gjithë jetës ata transmetojnë qëndrime seksuale dhe kjo është e pashmangshme (Geasler, Dannison & Edlund, 1995:186; Kirby, 2002:478), diskutimi qëndron tek modelet e mesazheve të transmetuara, sa ndihmëse ose jo janë ato për një edukim seksual mbi baza etike të fëmijëve dhe brezave të rinj.

Ka prindër të cilët mendojnë se komunikimi familjar rreth seksit do të shtojë kuriozitetin në kokën e fëmijës së tyre dhe më pas do të ndikojë që fëmija i tyre të fillojë marrëdhëniet seksuale më të hershme (Zamboni & Silver, 2009:61; Zamboni & Crawford, 2002:129).

Prindër të tjerë mund t'iu përmbahen mesazheve të vetëpërmbajtjes për arsye morale, megjithatë, Elliott (2010) argumenton se prindërit janë më të interesuar në mirëqenien fiziologjike dhe fizike të fëmijëve të tyre dhe për rrjedhojë morali i vazhdueshëm mbi sjelljen seksuale ka të bëjë kryesisht me shtyrjen e aktit. Edhe pse prindërit dyshojnë në faktin se fëmijët e tyre do të mbeten të vetëpërmbajtur deri në martesë, mesazhet e vetëpërmbajtjes janë ende predominuese, për shkak se prindërit parashikojnë se këto mesazhe do të ruajnë fëmijët e tyre të sigurt në të tashmen dhe të ardhmen, por ata nuk

dalën jashtë moralit të tyre për të biseduar me fëmijët për mënyrat e përgjegjshme të aktit seksual (Elliott, 2010:243).

Schiller, e cila ka themeluar Shoqatën Amerikane të Edukimit Seksual, Këshillimit dhe Terapisë (American Association of Sexuality Educators, Counselors and Therapists), në një prej librave të saj shprehet: Kam dëgjuar shumë prindër të cilët mburren për mënyrën sesi komunikojnë me fëmijët e tyre, ata u thonë: “Mund të më pyesësh për çdo gjë në lidhje me seksin”, por mesazhi i vërtetë joverbal që ata japin është: “Do të mërzhitesha shumë nëse ti ke aktivitet seksual, nëse ti kryen marrëdhënie seksuale” (Kelly, 2012:211). Kësisoj, Schiller e shpreh qartë pamundësinë e prindërve për një komunikim të qartë dhe të drejtpërdrejtë me fëmijët e tyre rreth temave të seksualitetit. Pa harruar edhe faktin që në shumë studime ka rezultuar se prindërit përdorin një standard të dyfishtë në edukimin e vajzave dhe djemve. Standardi i dyfishtë seksual përcakton që; për fëmijët femra është më e papranueshme dhe më pak e moralshme për prindërit që të kenë marrëdhënie seksuale, ndërkohë që është jashtë normave etike dhe morale të mësuara në familje që të kenë marrëdhënie seksuale jashtë një marrëdhënie tjetër dashurie, ndërsa për meshkujt mund të tolerohet që të kenë shumë partnerë seksualë, po ashtu edhe të fillojnë në çdo moshë marrëdhënien e parë seksuale (Miller, 2012:82; Milhausen & Herold, 1999:364). Standardi i dyfishtë seksual ndodh kur ka pritje të ndryshme, për sa i përket sjelljes seksuale tek femrat dhe meshkujt. Për shembull, sjellja seksuale e femrës konsiderohet me më shumë negativitet (ose më pak e pranueshme), sesa sjellja seksuale e mashkullit. Brenda shoqërisë në tërësi, standardet seksuale (p.sh. , seksi paramartesor, imoraliteti) janë më të larta për femrat sesa për meshkujt, prandaj këto sjellje janë konsideruar të papranueshme për femrat

(Foschi, 2000:33). Studimi mbi standardin e dyfishtë seksual filloi në vitin 1960 nga Ira Reiss që shqyrtoi tolerancën seksuale të meshkujve dhe femrave. Teoria e tij bazohej në faktin e ekzistencës së një besimi kulturor, ku meshkujve mund t'u lejohej të kishin marrëdhënie seksuale paramartesore dhe paralele, ndërsa femrave nuk u lejohej një gjë e tillë (Reiss, 1960:69). Në Shqipëri, besoj kjo është akoma më evidente dhe shkak janë faktorë të shumtë social dhe kulturorë. Thuajse në çdo fushë të jetës për femrat dhe meshkujt ekziston një standard i dyfishtë gjykimi. Nga ana tjetër, prindërit e studentëve të ditëve tona, të rritur nën një regjim diktatorial, dhe me prindër të cilët të folurit mbi seksin e konsideronin tabu dhe imoralitet, ku njëkohësisht standardet mbi moralin e gruas ishin edhe më të rrepta, përgjithësisht e kanë të vështirë të krijojnë marrëdhënie të hapura dhe me një standard edukimi seksual me fëmijët e tyre, për aq kohë sa për ta nuk ka ekzistuar një shembull apo edukim i tillë (Miller, 2012:211).

Sipas Koerner dhe Fitzpatrick, rregullat e komunikimit familjar konfigurohen në dy dimensione kryesore: orientimi ndaj bashkëbisedimit dhe orientimi ndaj konformitetit (Koerner & Fitzpatrick, 2002a:39). Sipas tyre, orientimi ndaj bashkëbisedimit përcaktohet si shkalla në të cilën familjet krijojnë një klimë të brendshme në të cilën të gjithë anëtarët e familjes inkurajohen të marrin pjesë në mënyrë të pakufizuar në diskutimin e një numri të gjerë çështjesh" (Koerner & Fitzpatrick, 2002a: 39). Familjet me nivele të larta në çështje të orientimit ndaj bashkëbisedimit ndajnë hapur midis tyre detajet e jetës së tyre dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së tyre, diskutojnë mendimet dhe emocionet personale, dhe angazhohen në bisedë në lidhje me tema të debatueshme (Ledbetter, 2009:138). Ndërkohë që orientimi ndaj konformitetit përcaktohet si shkalla në të cilën komunikimi në familje i

jep rëndësi krijimit të një klime të homogjenitetit të qëndrimeve, vlerave etike dhe besimeve (Vik, 2012:201), në këto raste fëmijët priren të ndjekin normat e familjes dhe t'iu përmbahen besimeve dhe vlerave etike të familjes (Ledbetter, 2009:143).

Natyrisht që llojet e familjeve janë të ndryshme dhe modelet e mësipërme të komunikimit manifestohen ndryshe në varësi të karakteristikave të familjeve. Kështu sipas Koerner dhe Fitzpatrick, ekzistojnë katër lloje familjesh si: familja konsensuale, familja pluraliste, ajo mbrojtëse dhe familja pasive. Sipas tyre, **familja konsensuale** karakterizohet nga shprehja e niveleve të larta të orientimit ndaj bashkëbisedimit dhe konformitetit. Familjet konsensuale "karakterizohen nga një kundërveprim midis presionit për të rënë dakord dhe për të ruajtur hierarkinë ekzistuese brenda familjes, nga njëra anë, dhe një interesi për komunikim të hapur dhe eksplorimin e ideve të reja, nga ana tjetër" (Vik , 2012:209).

Familjet pluraliste kanë nivele të larta në orientimin ndaj bashkëbisedimit, por nivele të ulëta në orientimin e konformitetit. Këto familje duke shprehur se "komunikimi në familjet pluraliste karakterizohet nga diskutime të hapura të pakufizuara që përfshijnë të gjithë anëtarët e familjes" (Vik , 2012:211; Koerner & Fitzpatrick, 2002a:40).

Familja mbrojtëse është e kundërta e familjes pluraliste, ka nivele të larta të konformitetit, por nivele të ulëta të orientimit të bashkëbisedimit. "Komunikimi në familjet mbrojtëse karakterizohet nga theksimi i bindjes ndaj autoritetit prindëror dhe nga shqetësimi i pakët për çështje konceptuale ose për komunikim të hapur brenda familjes" (Vik , 2012:211; Koerner & Fitzpatrick, 2002a:43).

Së fundi, lloji i katërt i familjes është ai pasiv në origjinal *“laissez-faire”*, këto familje karakterizohen nga nivele të ulëta si në orientimin ndaj bashkëbisedimit, ashtu dhe në orientimin ndaj konformitetit. Në familjet *“laissez-faire”*, komunikimi karakterizohet nga biseda të pakta dhe zakonisht mospërfshirëse midis anëtarëve të familjes, që zakonisht angazhohen në një numër të kufizuar të çështjeve për diskutim" (Vik , 2012:209; Koerner & Fitzpatrick, 2002a:47).

Gjithsesi, studiues të tjerë kanë shprehur me kohë se prindërit janë kanali kryesor për shoqërizimin, duke përfshirë edhe shoqërizimin seksual (Darling & Hicks 1983:234; Thornton & Camburn, 1987:644). Edhe nëse seksualiteti nuk është diskutuar brenda një familjeje, prindërit fillojnë të komunikojnë (direkt ose indirekt), të shfaqin qëndrimet dhe moralin e tyre për identitetin gjinor, të sjelljes së përshtatshme gjinore dhe vlerave morale brenda disa muajve të parë të jetës së fëmijës së tyre (Darling & Hicks, 1983:235). Prindërit gjithashtu ndikojnë në sjelljen dhe besimet seksuale të fëmijëve përmes dhënies së shembullit të tyre, krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm dhe komunikimit të sjelljeve normative seksuale (Thornton & Camburn, 1987:326). Greene dhe Faulkner (2005) shprehen se personazhet "veprojnë dhe ndërveprojnë në tri nivele të ndryshme: nivelet kulturore, ndër-personale, dhe ndër-fizike". Mënyra sesi një individ parashikohet të sillet (seksualisht) mësohet ose jo nëpërmjet "shkollës, udhëheqësve fetarë, prindërve si edukatorë të seksit, dhe shfaqjeve të maskomunikimit " (Greene & Faulkner, 2005:243).

Figura autoritare të tilla, si prindërit, mund të ndikojnë në sjelljen e fëmijëve të tyre nëpërmjet një procesi të referuar si socializim (Riley, 2011:145; Maccoby, Grusec & Hastings, 2007:39). Socializimi seksual përfshin komunikimin mbi seksin ndërmjet prindit

- adoleshentit, shkëmbimin verbal ose joverbal të informacionit seksual mes një prindi dhe adoleshentit të tij. Qëllimet e komunikimit mbi seksin ndërmjet prindit dhe adoleshentit përfshijnë krijimin e qëndrimeve, vlerave etike dhe besimeve të ngjashme për seksin tek adoleshentët e tyre (Riley, 2011:133; Warren, 1995:179). Problemi qëndron sesa profesionale janë këto diskutime, sa ngrihen ato mbi bazat e etikës seksuale dhe jo të moralit apo ndrydhjes seksuale të të rinjve, dhe sa realisht ndikojnë në ndryshimin e sjelljes?

2. 1. 3. Sjellja seksuale e fëmijëve me një prind

Jo të gjithë të rinjtë rriten në kushte të ngjashme. Struktura e familjes në të cilën të rinjtë rriten, statusi martesor i prindërve të tyre ndryshon nga një i ri tek një tjetër. Duke u rritur në familje të thyera, me prindër të divorcuar, të rinjtë priren të fillojë marrëdhënie seksuale më herët dhe në një mënyrë të ndryshme nga ata që rriten në familje të zgjeruara ose me të dy prindërit, një anë tjetër kjo, që shoqëron jetën e një të riu me probleme në identitetin seksual. Tarifa (1992:89), Mattox (1999) dhe të tjerë, arrijnë në konkluzionin se adoleshentët vajza që ishin rritur në një shtëpi pa baba ishin të prirura të silleshin në një mënyrë seksuale më të shthurur, të angazhoheshin në aktivitete seksuale para martesore, të merrnin pjesë në bashkëjetesë, të kishin shtatzani të parakohshme dhe para martesës apo të kryenin një abort (Mattox, 1999:23; Wallerstein & Lewis, 2000:116). Kërkimet tregojnë se vajzat nga familjet e divorcuara kanë më shumë gjasa të kenë marrëdhënie seksuale në një moshë më të hershme dhe të kenë pasur më shumë partnerë seksualë (Hetherington & Kelly, 2002:87; Wallerstein & Lewis, 2000:115; Belsky, Steinberg & Draper, 1991:651;

Gabardi & Rosen, 1991:183; Beal & Hochman, 1991:54). Nga ana tjetër, edhe për meshkujt sipas një studimi të Longmore etj (2005), nëse jetojnë në një familje me njerë/ë kanë shumë më tepër gjasa për të kryer seks në një moshë të parakohshme në krahasim me meshkujt në familje me dy prindër (Longmore, 2005:291). Familjet e prindërve të vetëm lidhen me sjellje seksuale tolerante të adoleshentëve (Browning, Leventhal, & Brooks-Gunn, 2004:701). Në mënyrë të ngjashme, jetesa pa të dy prindërit biologjikë rezultoi të ishte e lidhur me fillimin më të hershëm të aktivitetit seksual të adoleshentëve (Miller & Gur, 2002:402). Për më tepër, studime të tjera në fakt mbështesin faktin se adoleshentët e rritur në familje të rregullt ishin përfshirë në më tepër aktivitet seksual paramartesor (Flewelling & Bauman, 1990:173; Furstenberg & Teitler, 1994:178; Kieman, 1992:224; Ellis et. al, 2003:809).

Në Shqipëri, numri i familjeve me një prind, po bëhet gjithnjë e më i madh, nga njëra anë divorcet e shumta, nga ana tjetër pavarësia e femrave që ka çuar drejt vendimeve për shtatzani jashtë kurore, ka çuar në rritjen e familjeve që rrisin fëmijë kryesisht nga nëna të vetme, dhe domosdoshmërisht do të ketë edhe pasoja në sjelljen e fëmijëve (Mërkuri, 2013:87).

Shumë studime tregojnë se angazhimi i babait është i dobishëm për një numër rezultatesh sociale dhe sjelljesh tek fëmijët, adoleshentët, dhe studentët (Furstenberg & Harris, 1993:91; Marsiglio, Amato, Day & Lamb, 2000:1179). Për më tepër, mungesa e angazhimit të babait që shpesh përkufizohet si mungesa e babait, ka rezultuar në mospërshtatje psikologjike, çrregullime të sjelljes dhe probleme të edukimit (Biller, 1993:91; Biller & Kimpton, 1997:162; Blanchard & Biller, 1973:321).

Për Frojdin, shfaqja dhe zgjidhja e kompleksit të Edipit ishin mjaft të rëndësishme për përcaktimin e formimit dhe karakterit të strukturës së personalitetit të një të rrituri (Frojd, 1924:17; 1925:61). Frojdi pohoi se babai është ai që luan rol parësor në zhvillimin dhe zgjidhjen e dramës edipiane të një fëmije. Sipas pikëpamjes së Frojdit, gjatë fazës së Edipit djemtë kuptojnë se kanë një penis si baballarët e tyre. Ata dëshirojnë nënat e tyre dhe kështu bëhen rivalë me baballarët. Për shkak të ankthit të tredhjes, ky rivalitet "nuk ndryshohet, por në fakt ndahet në copëza. Fiksimi patologjik ndaj libidos ndërfitet tek uni ku formon bërthamën e superunit dhe i jep asaj strukture të re cilësitë e saj karakteristike " (Freud, 1925:91). Frojdi pohon se "në përgjithësi perceptimi ynë për këto procese zhvillimi tek vajzat është i pakënaqshëm, i paplotë dhe i paqartë "(Frojd, 1924:21). Pavarësisht nga vështirësia e tij për pajtimin e kompleksit të Edipit tek femrat dhe neglizhimit nga ana e tij të marrëdhënieve të hershme ndërmjet babait dhe fëmijës, është e qartë se Frojdi e shihte babain si figurë qendrore në zhvillimin seksual të fëmijëve.

Në një përpjekje për të shpjeguar se përse femrat, baballarët e të cilave mungonin në shtëpi, tregonin shkallë më të lartë të aktivitetit të hershëm seksual dhe shtatzëni në adoleshencë, në krahasim me femrat që kishin një baba të pranishëm, Ellis etj (2003) sugjeruan se mungesa e babait ndikon drejtpërdrejt, dhe diskuton dy teori që mund të shpjegojnë këtë fenomen (Ellis et. al. , 2003:811). Perspektiva evolucionare sugjeron se kur babai është i pranishëm në familje, një fëmijë femër mund të besojë se mund të gjenden "meshkujt investues" dhe miratojnë një strategji për të pasur një të tillë. Një mashkull investues tregon gatishmëri për të investuar kohë dhe burime për të lënë gruan shtatzënë dhe për të rritur fëmijë. Sipas kësaj teorie, meshkujt pëlqejnë femrat të cilat sillen në një mënyrë të ndrojtur,

janë seksualisht të rezervuara dhe zhvillojnë një lidhje të qëndrueshme me një mashkull. Nëse nuk ka prani të një mashkulli, siç ndodh shpesh kur prindërit ndahen, teoria sugjeron se vajza do të mësojë se investimi i babait nuk është i nevojshëm apo është i pabesueshëm dhe i parëndësishëm. Kjo ndikon drejtpërdrejt dhe përshejton strategjinë riprodhuese të fëmijës, e cila ka gjasa të jetë seksualisht e papjekur dhe e shturur në një moshë të re (Rossi, 1997:374; Ellis et. al., 1999:394; Hetherington & Kelly, 2002:98). Kështu, teoricienët bashkëkohorë racionalë kanë pohuar se baballarët (*si dhe nënat*) luajnë një rol në strukturimin e seksualitetit të fëmijëve të tyre (Slavin, 2002:39).

2. 1. 4. Dallimet gjinore në komunikimin seksual mes prindërve dhe fëmijëve

Edhe pse prindërit citohet të jenë njerëzit më me ndikim, kur të rinjtë vendosin për të bërë seks, autorët theksojnë se ka dallime gjinore në impaktin e prindërve tek fëmijët, ku është pohuar se nënat kanë ndikim më të madh në diskutime rreth sjelljeve seksuale dhe seksualitetit sesa baballarët, si për djemtë ashtu edhe për vajzat e tyre. Jo pak është konstatuar se nënat komunikojnë më hapur sesa baballarët (Youniss & Smollar, 1985:119; Miller et. al. , 1998:227; Rosenthal et. al. , 1998:736; Rosenthal & Feldman, 1999:838). Të gjithë anëtarët e familjes, gjithsesi, e konsiderojnë seksualitetin si një temë të vështirë për të komunikuar (Kirkman et. al. , 2002:120), megjithëse adoleshentët që raportuan komunikim të hapur me familjen, raportuan gjithashtu edhe se merrnin më tepër edukim seksual në shtëpi nga nënat e tyre (Baldwin & Baranoski, 1990:44), dhe sa më hapur familjet komunikojnë mbi seksin, aq më shumë ndodh që në kohën e universitetit studentët të

reagojnë më mirë në lidhje me seksin (Booth-Butterfield & Sidelinger, 1998:59). Një studim ka treguar se vajzat e rritura kujtojnë se komunikimi i tyre me nënat mbi seksin ka qenë në fillim negativ, asgjë më tepër sesa rregulla dhe paralajmërime. Ajo çfarë vajzat e rritura kishin dëshiruar nga nënat e tyre ishte një përgjigje me ndjenjë, komunikim i hapur (Brock & Jennings, 1993:119). Warren (1995) ka qenë i mendimit se “komunikimi mbështetës mbi seksin varet nga çiltërsia, me të gjithë ngërçet jo verbale të saj” (Warren, 1995:191).

Dutra dhe kolegët e saj (1998), kanë arritur në konkluzionin se nuk ka asnjë efekt në sjelljen seksuale të të rinjve nga komunikimi atëror, por evidentoi se baballarët mund të ndikojnë tek sjellja në mënyra të tjera, të tilla si vendosja e vetes së tyre në rolin model apo të personit për zgjidhjen e problemit. Dallimet gjinore midis dy prindërve për komunikimin mbi seksin janë vlerësuar se kanë ndryshime, ku ka studime që kanë arritur në përfundime të dallimeve gjinore për këto çështje, që do të thotë se djemtë flasin më shumë me baballarët e tyre sesa vajzat (Dutra et. al. , 1998:11; Miller et. al. , 1998b:219), vajzat kanë më shumë gjasa të bisedojnë me bashkëmoshatarët e seksit të kundërt në lidhje me temat seksuale, sesa me baballarët e tyre (DiIorio et. al. , 1999:56), dhe prindërit flasin përkatësisht më shumë me fëmijët e tyre të njëjtës gjini sesa me seksin e kundërt (Schouten et. al. , 2007:62).

Por për Wyckoff (2008), etj. si femrat, edhe meshkujt komunikojnë rreth seksit me nënat e tyre më shumë sesa me baballarët, megjithëse djemtë e bëjnë këtë më shumë me baballarët e tyre sesa vajzat (Wyckoff et. al. , 2008:21). Në të njëjtën kohë, adoleshentët që komunikojnë më shumë me nënat kishin vlera etike më konservatore (DiIorio, Kelley, &

Hockenberry- Eaton, 1999:307). Megjithatë, studime të tjera kanë konstatuar se baballarët kanë një rol më të fuqishëm në aktivitetin seksual të adoleshentëve, sesa mendohej më parë (Anagurthi et. al. , 2012:198; Ohalet, 2007:65; Moore & Chase-Lansdale, 2001:1146). Por nënat priten të jenë edhe më me ndikim se baballarët kur një adoleshent është në procesin e marrjes së vendimit për t'u angazhuar në një sjellje seksuale. Po ashtu, nënat janë më të angazhuara dhe të pranuara nga djemtë dhe vajzat e tyre që kanë më shumë ndikim në diskutime rreth angazhimit seksual dhe seksualitetit (Somers & Tynan, 2006:161).

Teoricienët modernë psikoanalitikë kanë shkruar rreth rolit të të dy prindërve në zhvillimin e seksualitetit të fëmijëve të tyre (Davies & Fraeley, 1994:32; Ross, 1990:56; Slavin, 2002:11). Davies dhe Frawley (1994) kanë sugjeruar se reagimi i prindërve ndaj zhvillimit të interesit seksual të fëmijës është thelbësor për integrimin normal të vetes si një person që ofron dashuri, që të duhet nga të tjerët, dhe për integrimin seksual. Ata deklaruan se prindi është një “pjesëmarrës i plotë” në procesin e zbulimit të seksualitetit nga fëmija. Megjithatë, ata nuk shtellojnë dhe shpjegojnë se çfarë do të thotë të jesh “pjesëmarrës i plotë” dhe cili do të ishte një reagim i përshtatshëm prindëror (Davies & Frawley, 1994:29).

Ross (1990) dhe Slavin (2002) kanë shtjelluar më tej kontributin e prindërve ndaj seksualitetit të fëmijëve të tyre. Ross (1990) ka pohuar se midis prindërve dhe fëmijëve zhvillohen dialogë të ndryshëm në një cikël jetësor dhe këta formojnë mënyra të ndryshme, në të cilat fëmijë të ndryshëm përjetojnë seksualitetin e tyre. Ai diskutoi specifikisht për baballarët dhe deklaroi se jo vetëm nënat, por edhe baballarët kanë rol në strukturimin e seksualitetit të fëmijëve të tyre nga foshnjëria deri në adoleshencë (Ross, 1990:58; Slavin, 2002:19). Megjithatë, përveç kësaj, ka ndryshime strukturore në të cilat marrëdhëniet me

baballarët përshkruhen si “marrëdhënie shokësh” (d. m. th, më egalitare) sesa marrëdhëniet me nënat (Killoren et. al. , 2011:709; Parke & Buriel, 1998:79).

Megjithatë shumë prindër dhe madje edhe më shumë adoleshentë nuk janë të kënaqur me sasinë e komunikimit seksual prind-fëmijë ose cilësinë e tij, ose me të dyja (Byers et. al. , 2008:89; Weaver et.al., 2002:24). Përvojat e prindërve që marrin edukim shëndetësor seksual nga prindërit e tyre mund të ndikojnë në komunikimin me fëmijët e tyre. Edhe pse prindërit shpresojnë që t’ia dalin mbanë më mirë (Geasler, Dannison, & Edlund, 1995:187), edukimi seksual që ata ofrojnë i afrohet nivelit që kanë marrë nga prindërit e tyre (Fisher, 1990:61; Kniveton & Day, 1999:34; Lehr, Demi, DiIorio, & Facticeau , 2005:123). Jaccard, Dittus dhe Gordon (2000) zbuluan se dy rezerva më të rëndësishme që nënat kishin për diskutimin e seksualitetit me adoleshentët e tyre ishin të lidhura me njohuritë dhe lirshmërinë, frika se atyre do t’u kërkohet diçka, që nuk e dinë dhe sikleti kur flasin me adoleshentët e tyre në lidhje me seksualitetin (Jaccard, Dittus & Gordon, 2000:196). Më tej, prindërit që kanë marrë edukim shëndetësor seksual, ata që presumohet të ndihen më të ditur dhe më të lirshëm kur flasin për seksualitetin, kanë më shumë gjasa për të komunikuar hapur me fëmijët e tyre (King, Parisi & O'Dwyer, 1993:291).

Pavarësisht nga lloji i edukimit seksual të marrë para ndjekjes së shkollës së lartë, shumë studentë nuk veprojnë në përputhje me këto njohuri. Prindërit janë një ndikim i rëndësishëm socializues dhe shpesh citohen nga të rinjtë se kanë ndikimin më të madh në njohuritë, vlerat etike dhe qëndrimet e tyre rreth seksit (Byno et. al. , 2009:319; Arnett, 2007:54; Jensen, de Gaston & Weed, 1994:912). Por nga ana tjetër Kirby (2001), zbuloi një marrëdhënie midis lidhjes më të madhe ndaj familjes, fillimit të mëvonshëm të seksit dhe

marrëdhëniet seksuale më pak të shpeshta (Kirby, 2001:278). Megjithatë, disa studiues (Rosenthal & Feldman, 1999:840; Somers & Paulson, 2000:634) kanë raportuar se komunikimi i prindërve me fëmijët e tyre rreth seksualitetit nuk ndikon në sjelljen e mëvonshme seksuale të fëmijëve të tyre, sepse thuajse asnjëherë bisedat rreth seksit nuk bazohen mbi etikën e re seksuale, por mbi moralin dhe normën shoqërore, për të mos thënë që thuajse gjithmonë bisedat rreth seksit në familje nisin shumë më vonë sesa akti i parë seksual i fëmijëve (Rosenthal & Feldman, 1999:839; Somers & Paulson, 2000:639).

2. 2. IMPAKTI I BASHKËMOSHATARËVE NË SJELLJEN SEKSUALE ETIKE

2. 2. 1. Roli i bashkëmoshatarëve në fillimin dhe vazhdimin e aktivitetit seksual të studentëve

Nga shumë autorë gjatë 25 vjetëve të fundit është dokumentuar saktë se bashkëmoshatarët ushtrojnë ndikim tek sjellja seksuale e njëri-tjerit. (Shih: Bearman & Brückner, 1999:21; Billy et. al. , 1984:664; Hampton et. al. , 2005:118; Kinsman et. al. , 1998:1189; Treboux & Busch-Rossnagel, 1995:472). Bears (2009) dhe shumë autorë të tjerë, kanë konstatuar se ndikimi i bashkëmoshatarëve është parashikuesi më i fuqishëm i fillimit të aktivitetit seksual (Bears, 2009:62; Bearman & Bruckner. 1999:21; Kinsman et. al. , 1998:306; Moore & Rosenthal, 1993:1154; Woodruff, 1986:451).

Të rinjtë kanë prirjen të zgjedhin shokë që janë të ngjashëm me veten për sa i përket statusit të qenit i virgjër/jo i virgjër, në lidhje të qëndrueshme apo rastësore. Kjo mbështetet nga përfundimi se të rinjtë që kanë bashkëmoshatarë më aktivë seksualisht kanë më shumë gjasa të jenë vetë seksualisht aktivë si shkak i presionit dhe ndikimit që kanë bashkëmoshatarët në jetën e tyre. (Miller et. al. , 2000:318; Romer et. al. , 1994:978).

Gjithsesi, ndikimi që bashkëmoshatarët kanë në aktivitetin seksual të njëri-tjetrit ndryshon për studentët që janë në prag të aktivitetit seksual tek studentët që tashmë janë seksualisht aktivë (Majumdar, 2003:21). Megjithatë, studimet janë ende të paqarta lidhur me faktin nëse prirjet e meshkujve apo femrave janë për përzgjedhjen e shokëve mbi bazën e përvojave të ngjashme seksuale apo mbi tendencën për të modeluar sjelljet e tyre (Kirby, 2002:29; Lear, 1997:19). Studimet tregojnë se presionet normative midis

bashkëmoshatarëve ndikojnë në sjelljet, qëndrimet dhe vlerat etike të tyre (Kirby, 2002:30; Lear, 1997:19). Miqësia sidomos midis meshkujve prodhon përforcim shoqëror të sjelljeve dhe qëndrimeve stereotipike mashkullore. Ndërkohe ajo mes femrave mund të ketë kah të kundërt ose të njëjtë në varësi të kulturës, normave dhe vlerave etike seksuale (Kirby, 2002:30). Sipas Cyranowski dhe Andersen (2000), përcaktuan se femrat ndryshojnë në mënyrën sesi ato përpunojnë nga pikëpamja konjitive informacionin seksual, si për shembull përvojat seksuale personale, por edhe femrat nuk dalin jashtë kornizave normative të përcaktuara nga shoqëria, ku e moralshmja dhe imoralja janë pjesë e këtyre kornizave (Cyranowski & Andersen, 2000:529). Rrjedhimisht, vetë-skema seksuale zhvillohet në bazë të faktorëve të ndryshëm nga përvojat seksuale personale, mundësisht duke përfshirë mesazhe socio-kulturore rreth seksit (Stephens, 2003:43).

Për sa iu përket bashkëmoshatarëve si një burim i mesazheve kulturore, në studimin e Stone (2007) por dhe të Ansuini etj, (1996) , një sërë intervistash evidentuan miqtë si burimin më të rëndësishëm të informacionit seksual (Stone, 2007:99; Ansuini et. al. , 1996:287). Premisa kryesore e teorive të ndikimit të shokëve është se nëpërmjet procesit të përzgjedhjes, njerëzit zgjedhin shokë, qëndrimet dhe besimet e të cilëve përputhen me qëndrimet dhe besimet e tyre (Kandel, 1978:311). Nëpërmjet socializimit me shokët, qëndrimet dhe besimet e dikujt përforcohen dhe bëhen më ekstreme pasi personat e tjerë të rëndësishëm i aprovojnë këto qëndrime dhe besime, si dhe nxisin shprehjen e tyre. Studimet tregojnë dy motivues kryesorë të studentëve dhe të rinjve në përgjithësi për angazhimin në aktivitete seksuale të cilat janë: kursi natyror i marrëdhënieve, lidhjet personale me dikë dhe përvoja e fituar në marrëdhëniet e tyre gjatë një lidhjeje me një

bashkëmoshatar (Shalet, 2011:58). Motivimi i dytë në një përfshirje seksuale, është dëshira për vizibilitet shoqëror, fitime të perceptuara të vëmendjes apo popullaritetit, ndjenjë të komoditetit, dhe arritje të provës së pjekurisë, që është shumë herë më e dallueshme në adoleshencën e hershme dhe në atë të vonë, kryesisht në studentët e viteve të para të studimeve universitare (Shalet, 2011:71). Në varësi të arsyeve të angazhimit në një marrëdhënie, fundi i kësaj marrëdhënie mund të shkaktojë ose përforcojë perceptime të ndryshme rreth seksualitetit të secilit person (Collins, 2003:22).

Një studim i kryer nga Little dhe Rankin (2001) konstatoi se të rinjve iu atribuoheshin arsyet e mëposhtme për kryerjen e marrëdhënieve seksuale: presioni i bashkëmoshatarëve/dëshira për të respektuar rregullat e shoqërisë së tyre, një mjet dënimi ose shpërblimi të partnerit seksual, devijim nga tensionet dhe presionet, simbol pjekurie dhe burim/mjet i eksperimentimit dhe zbulimit të kënaqshëm (Little & Rankin, 2001:713). Përveç bashkëmoshatarëve të përkufizuar si shokë që kanë një presion të caktuar mes tyre, kërkuesit kanë analizuar ndikimin e vëllezërve dhe motrave dhe partnerëve romantikë në fillimin e aktivitetit seksual, të cilët kanë diferenca moshore të vogla mes tyre. Rodgers etj (1992), Widmer (1997) dhe Argys, Rees, Averett dhe Witoonchart (2006), ofrojnë të dhëna se individët me motra ose vëllezër më të mëdhenj kanë prirjen të fillojnë më herët aktivitetin seksual, si shkak i ndikimit që kanë motrat/vëllezërit e tyre, dhe ky ndikim mund të vijë në formën e një presioni normativ për t'u njehsuar me motrën ose vëllain, ose në formën e një modeli pozitiv, ku seksi perceptohet si arritje personale dhe kënaqësi (Rodgers et. al. , 1992:148; Widmer, 1997:931; Argys, Rees, Averett & Witoonchart, 2006:223).

Lear (1997), në studimin e saj arriti në përfundimin se, mënyra dhe fakti sesi shokët pëlqenin apo bisedonin rreth seksit dhe ushtrimit të seksit më të sigurt ishin ndikime të fuqishme për parashikimin nëse një pjesëmarrës ishte duke kryer seks më të sigurt. Në rastet kur vlerat e një individi janë të papajtueshme me ato të shokëve të tyre, ekziston një konflikt, nëse ata mund të përpiqen të ndikojnë tek njëri-tjetri ose nëse njëri prej tyre po orvatet në mënyrë të pavarur për të përfshirë vlerat e shokëve (Lear, 1997:69). Megjithatë, duhet përmendur se ashtu si edhe ky kërkim, i cili pohon se diskutimet mes të rinjve zakonisht përfshijnë histori personale rreth seksit dhe takimeve dashurore, si dhe aspekte pozitive dhe rastësore të seksit (Epstein & Ward, 2008:119), të rinjtë kryesisht fokusohen tek përfitimet seksuale dhe jo tek rreziku seksual, i cili nuk është konsideruar dhe nuk ka rezultuar të jetë një diskutim i përhapur tek bashkëmoshatarët (Trinh et. al. , 2014:211). Për rrjedhojë, bashkëmoshatarët sado të informuar të jenë, kanë tendencën të ndajnë mes tyre atë çfarë i bën më të veçantë në sytë e miqve të tyre, që për rrjedhojë nuk ka të bëjë me edukimin e mirëfilltë seksual, apo me sjelljen etike seksuale si masat mbrojtëse apo seksi i sigurt, respekti, përgjegjshmëria, etj (Marks, 2005:176).

2. 2. 2. Normat sociale dhe sjellja seksuale mes bashkëmoshatarëve

Lidhjet me bashkëmoshatarët janë një prej shumë mënyrave me të cilën adoleshentët e vonë apo studentët e viteve të para fillojnë të përkufizojnë veten jashtë sferës familjare. Ky identitet i ri është jashtëzakonisht i rëndësishëm për një student për t'u pranuar në një grup shoqërie të caktuar (Warr, 2002:202). Për më tepër, studentët e sidomos ato të viteve të para të studimit janë jashtëzakonisht të cënueshëm ndaj pikëpamjeve alternative morale në këtë fazë të jetës së tyre dhe i drejtohen bashkëmoshatarëve për mbështetje emocionale gjatë

kësaj periudhe tranzicioni (Warr, 2002:203). Nga shumë studiues adoleshenca e zgjatur, e njohur edhe si fillimi i moshës së rritur i referohet periudhës 18-25 vjeç (Nelson, Badger, & Wu, 2004:28), periudhë e cila është e ndryshme nga ajo që njihet tradicionalisht si adoleshencë, pasi ky grup është shumë më i çliruar nga kontrolli prindëror, e mbi të gjitha në këtë periudhë të jetës është koha e eksplorimit më të madh të pavarur e sidomos atij seksual (Eaves, 2007:74).

Bashkëmoshatarët krijojnë një normë sociale se seksi ndodh në komunitet me model të gatshëm, njëri-tjetrin. Sipas Kowenski-t (2012), dy tema u evidentuan për të shpjeguar mënyrën sesi bashkëmoshatarët ndikonin në synimet ose sjelljet seksuale – “sjellja seksuale e normalizuar” dhe “qëndrimi jogjykues”. Femrat, 20% dhe meshkujt, 55. 2% pretendojnë se bashkëmoshatarët e tyre ishin përfshirë në aktivitet seksual, gjë që i kishte shtyrë vetë ata të angazhoheshin në akte seksuale. Ndërsa 70% e femrave dhe 41. 4% e meshkujve shpjeguan se shokët e tyre i kishin ndihmuar të pranonin bashkëmoshatarët e tyre për atë çfarë ata ishin dhe t’i mësonin të mos gjykonin, pavarësisht nëse bashkëmoshatarët e tyre ishin përfshirë në aktivitet seksual apo jo (Kowenski, 2012:119). Kësisoj, presioni i perceptuar nga shokët dhe qëndrimet e besimet personale pritet të kenë ndikime kryesore tek rezultatet dhe të ndërveprojnë. Presioni nga shokët për të pasur shumë përvoja seksuale dhe qëndrimet e burrave rreth marrëdhënieve seksuale rastësore pritet të lidhen me numrin e tyre të partnerëve seksualë, si shkak i pranimi nga bashkëmoshatarët dhe i gjykimit të këtij veprimi si normal dhe i suksesshëm (Jacques-Tiura, 2010:75).

Motivimet për sjelljen seksuale u shqyrtuan edhe nga Kinsman dhe Romer (1998). Ata zbuluan se perceptimi i sjelljes së bashkëmoshatarëve, si dhe përfitimet sociale të

perceptuara formonin vendimmarrjen seksuale tek pjesëmarrësit meshkuj. Parashikuesi më i fuqishëm i sjelljes seksuale ishte synimi dhe parashikuesi më i fortë i synimit ishte besimi se shokët tashmë po përfshiheshin në sjellje seksuale të caktuara (Kinsman & Romer, 1998:1187). Këto rezultate mbështesin më tej konceptin se perceptimet rreth sjelljes së bashkëmoshatarëve motivojnë vendimet seksuale, në përpjekje për të harmonizuar sjelljet për të reflektuar atë të normave të perceptuara në rrethin e tyre të bashkëmoshatarëve por që kurrësi në pjesën më të mirë të rasteve nuk ka pasur të dhëna që këto sjellje seksuale të jenë të modeluara si etike, por kryesisht janë të bazuara në aktivitet më të hershëm seksual dhe në numër më të madh partnerësh (Brown et. al. , 2009:362).

2. 2. 3. Dallimet gjinore të sjelljeve dhe qëndrimeve seksuale mes bashkëmoshatarëve

Natyrisht që gjinia është një variabël kyç për analizimin e sjelljes seksuale të studentëve. Në të gjitha studimet që i dedikohen sjelljes seksuale së të rinjve gjenden edhe dallime në sjelljen seksuale, qoftë në komunikimin mes bashkëmoshatarëve apo edhe në vetë sjelljen seksuale (Trinh et. al. , 2014:217). Në përgjithësi, studentët raportojnë se mësojnë më shumë rreth seksit nga bashkëmoshatarët e tyre të së njëjtës gjini (Ward, 2003:349). Në studimin e Trinh etj, (2014) dhe Lefkowitz etj, (2004), studentët amerikanë të universiteteve raportojnë nivele të larta lirshmërie dhe hapjeje gjatë diskutimeve rreth seksit me shokët e tyre më të mirë të së njëjtës gjini, dhe kjo vërehet veçanërisht tek femrat (Trinh et. al. , 2014:218; Lefkowitz, Boone, & Shearer, 2004:341). Studimet e ndikimit të grupit të bashkëmoshatarëve tregojnë se grupet e bashkëmoshatareve femra frenojnë imoralitetin dhe

grupet e bashkëmoshatarëve meshkuj e nxisin atë (Du Bois-Reymond & Ravesloot, 1996:183; Maticka-Tyndale, Herold, & Mewhinney, 1998:258). Kjo përcakton qartë faktin se përse bashkëmoshatarët flasin më lirshëm dhe modelojnë sjelljen seksuale, duke u mbështetur në bashkëmoshatarë të së njëjtës gjini. Janë pikërisht normat dhe besimet shoqërore që vendosin besime shoqërore të caktuara, të tilla si standardin e dyfishtë, që përcaktohet si qëndrime dhe sjellje që nxisin dhe vlerësojnë aftësitë seksuale tek meshkujt dhe ndëshkojnë sjellje të ngjashme tek femrat, për rrjedhojë si meshkujt dhe femrat gjejnë më lehtë përkrahjen dhe miratimin për një sjellje të caktuar seksuale tek bashkëmoshatarët e së njëjtës gjini, të cilët gjykojnë në të njëjtën mënyrë si shkak i normave sociale të cilat pranojnë dhe respektojnë (Drew, 2012:69).

Por gjithsesi, konstruktet shoqërore, si standardet e dyfishta, ndikojnë negativisht tek rinia e kohës së sotme duke rritur më tej mashkulloritetin heteroseksual që shkurajon barazinë dhe ndrydh eksplorimin e një shumëllojshmërie të rrugëve seksuale (Castaneda & Bums-Glover, 2004:73). Efektet e roleve specifike gjinore dhe përvojave kulturore mund të ndikojnë në sjelljen seksuale. Kjo është e dukshme në rastin e standardit të dyfishtë, ku sjelljet seksuale me rrezik të lartë janë më të pranuar për meshkujt sesa për femrat (Crawford, 2003:21). Normat dhe mesazhet shoqërore vazhdojnë të nxisin trajtimin e femrave si objekt, një koncept i mbështetur përmes mesazheve shoqërore që shprehen veçanërisht në media nëpërmjet gazetave, televizionit, apo filmave (Hust, Brown, & L'Engle, 2008:21). Hardee, etj, (1996), kërkues kryesor për *Family Health International*, besojnë se djemtë dhe vajzat gjatë të gjithë fëmijërisë marrin mesazhe të ndryshme rreth sjelljeve që priten prej tyre. Këto mesazhe iu komunikohen adoleshentëve nga shoqëria më

e gjerë e largët, si dhe nga burime të afërta si prindërit, bashkëmoshatarët dhe kurrikula e edukimit seksual. Akoma më shumë e mundshme është që ky standard i dyfishtë të jetë edhe më i thellë në shoqëritë në zhvillim apo në shoqëritë e tilla si ajo shqiptare që janë patriarkale (Hardee et. al. , 1996:231).

Në përgjithësi, djemtë adoleshentë kryejnë marrëdhënie seksuale në një moshë më të hershme (Lyons, 2009:48; Spriggs & Halper 2008:157) dhe raportojnë një numër më të madh partnerësh seksualë (Luster & Small, 1994:629; Tubman, Windle & Windle 1996:187), megjithatë hendeku midis meshkujve dhe femrave po vjen gjithmonë e më shumë duke u ngushtuar. Në vitin 2002, duke përdorur të dhëna nga Sondazhi Kombëtar i Zhvillimit Familjar, Abma etj, (2004) raportojnë se e njëjta përqindje 46% e meshkujve dhe femrave 15-19 vjeçare kanë pasur marrëdhënie seksuale të paktën një herë (Abma et. al. , 2004:158). Kësisoj, dallimet gjinore në lidhje me sjelljen seksuale mund të dallohen tek seksi rastësor, ku vajzat adoleshente sipas studimit të Manning , kanë më pak gjasa të përfshihen në seks rastësor në krahasim me djemtë (Manning et. al., 2005:401; Manning et.al., 2006:460). Në mënyrë të përmblodhur, kërkimet paraprake mbi adoleshentët tregojnë se ekziston një dallim gjinor midis djemve dhe vajzave në lidhje me sjelljen seksuale, djemtë fillojnë të kryejnë seks në një moshë më të ulët, kanë më shumë partnere seksuale dhe më shumë partnerë seksualë rastësor (Lyons, 2009:41).

Studimet e ndryshme gjinore përdorin kryesisht një perspektivë sociale konstruksioniste (Tolman, 2003:11; Muehlenhard, et. al. , 2003:154, Castaneda & Burns-Glover, 2004:78) në kuadrin e dallimeve gjinore dhe seksualitetit. Kjo ka sjellë reflektimin mbi proceset me të cilat konteksti kulturor ndikon në sjelljen gjinore përmes mesazheve të qarta dhe të

nënkuptuara (Muehlenhard et. al. , 2003:158). Sipas Oliver dhe Hyde (1993), dallimet gjinore bazohen në katër perspektivat teorike si; biologjia evolucionare, përvojat e hershme familjare, teoria e të mësuarit social dhe roli social dhe teoria e skenarit (Oliver & Hyde, 1993:38). Sipas teorisë feministe seksualiteti femëror ndrydhet dhe seksualiteti mashkullor nxitet, duke treguar se femrat duhet të kenë më pak përvojë seksuale në krahasim me meshkujt, dhe kjo si shkak i presionit të normave të shoqërisë (Koedt, 1970:59).

Megjithatë, sipas Herold dhe Mewhinney (1993) femrat dhe meshkujt nuk ndryshojnë për numrin e partnerëve seksualë rastësorë gjatë jetës, sepse me rritjen e moshës dhe kalimin në rininë e vonë këto eksperiencë janë të ngjashme dhe pa dallime (Herold & Mewhinney, 1993:41). Po ashtu edhe, Bailey, etj (2008) nuk konstatojnë një dallim gjinor në përvojën e seksit rastësor në një popullatë të rinjve në moshë madhore gjashtë muaj pas diplomimit nga studimet pasuniversitare. Ndërsa njerëzit rriten dhe përparojnë në rrugën e jetës, lidhja gjinore ku burrat kanë më shumë partnerë rastësorë seksualë mund të ndryshonte ndërsa pranueshmëria e sjelljes seksuale rastësore rritet më shumë tek femrat. Në tërësi autorët pohuan se me rritjen e moshës dallimet gjinore nuk ekzistojnë në sjelljen seksuale. Nëse meshkujt kanë më shumë seks rastësor, më shumë seks oral, seks anal apo vaginal, duhet ta kuptojmë se këtë gjë në pjesën dërrmuese e bëjnë pikërisht me femrat (Bailey et. al. , 2008:574).

2. 3. EDUKIMIT SEKSUAL NË SHKOLLA DHE SJELLJA SEKSUALE E STUDENTËVE

2. 3. 1. Edukimi seksual në shkollat shqiptare

Pavarësisht rëndësisë së njohur gjerësisht të shëndetit seksual, edukimi dhe promovimi i tij mbetet një çështje sensitive dhe ndonjëherë e diskutueshme, pikëpamjet liberale dhe konservatore mbi mënyrën e duhur për të ofruar edukim seksual mbeten gjerësisht divergjente. Mosmarrëveshjet kryesore rreth edukimit seksual kanë qenë çështje mjaft të rëndësishme në shumë vende perëndimore në lidhje me premisat bazë dhe përmbajtjen e edukimit seksual dhe se kush është komponenti më i mirë për ta siguruar, prindërit apo shkollat duhet të jenë edukuesit parësorë seksualë (Shtarkshall et. al, 2007:117). Konfliktet sociale kryesore mbi programet e edukimit seksual janë kontradikta jashtë rolit të qeverisë në jetën familjare dhe edukimit seksual si; kontrolli prindëror për përmbajtjen e edukimit seksual, vlerat themelore që duhet të përfshihen në edukimin seksual, të tilla si barazia gjinore dhe përgjegjësia personale, dhe kryesisht, ajo që përbën sjellje përshtatshme seksuale të adoleshentëve (Shornack & Shornack, 1982:539).

Nivelet e larta të lindjeve të parakohshme tek adoleshentët dhe të rinjtë, dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme, kanë treguar qartë se prindërit nuk mund ose nuk duan t'i mësojnë të rinjtë rreth sjelljeve seksuale, ndërkohë besimi që lind tek bashkëmoshatarët apo media si institucione të tjera sociale, u jep adoleshentëve një pikëpamje të shtrembëruar të seksualitetit. Studimet tregojnë se shumica e prindërve dhe adoleshentëve dëshirojnë edukim seksual në shkolla (MacDonald et. al. , 2011:451)

Gjithsesi, me gjithë pikëpyetjet nga shumë studime është konkluduar se shkolla është vend i rëndësishëm për realizimin e ndërhyrjeve për të parandaluar dhe ndryshuar sjelljen e rrezikshme seksuale (UNAIDS, 1997:8). Shkolla ofron një vend alternativ për shumë adoleshentë që nuk ndihen komodë kur u kërkojnë prindërve informacione mbi shëndetin seksual, të cilët jo në çdo rast kanë mundësinë t'u japin informacione cilësore mbi seksin (Kirby, 2000:69). Megjithatë, edhe pse shkolla si një institucion edukimi ka të dhëna kontradiktore në lidhje me efektivitetin e programeve shkollore të shëndetit seksual, sërish Kirby, Laris dhe Roller (2007), kanë identifikuar të paktën 10 studime të 10-vjeçarit të fundit tregojnë përmirësim në një ose më shumë sjellje seksuale të rrezikshme si p.sh; numri i partnerëve, përdorimi i prezervativëve, me anë të ndërhyrjeve dyvjeçare të bazuar në post-kurrikula të edukimit seksual në shkollë (Kirby, Laris & Roller, 2007:44).

Instituti i Shëndetit Publik ka bërë publike studimet e kryera mbi marrëdhëniet seksuale dhe sjelljet seksuale të adoleshentëve në shkollat 9-vjeçare, dhe sipas të dhënave të nxjerra nga anketimet me 2974 nxënës në këto shkolla, ka rezultuar se 14% e nxënësve kanë kryer marrëdhënie seksuale që në moshën 13-vjeçare (ISHP, 2014:11).

Është e qartë që vendi ynë ka problematika të thella lidhur me edukimin seksual në shkolla. Nëse edukimi seksual i të rinjve dhe adoleshentëve duket një detyrë e vështirë për prindërit, atëherë kjo përgjegjësi kalon tek shkollat, si një nga institucionet më të rëndësishme të shoqërisë. Institucionet e arsimit në Shqipëri, gjatë pesë viteve të fundit janë përpjekur t'i japin më shumë rëndësi pjesës së edukimit seksual në shkolla, nëse do ta krahasonim këtë përpjekje me vite më parë, e cila thuhet nuk ka ekzistuar (Zenelaj, 2013:79).

Në tekstet shkollore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, ka kapituj ose faqe, të cilat i kushtohen edukimit seksual, por këto nuk janë të mjaftueshme dhe të trajtuara gjerësisht. Përkatësisht, në shkollat 9-vjeçare, në lëndën “*Biologji dhe Edukim Shëndetësor ose Seksual 7*” ekziston vetëm një kapitull në të cilin kryesisht flitet për organet e riprodhimit, pjekurinë seksuale dhe shtatzëninë, veçoritë e pubertetit, kontraktivët dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme (Ruka dhe Sokoli, 2007:62; Ruka dhe Nashi, 2012:83), dhe me këtë kapitull konsiderohet i mjaftueshëm edukimi seksual i nxënësve që ndjekin 9-vjeçaren edhe pse statistikat flasin për rritje të numrit të adoleshentëve që kryejnë marrëdhënie seksuale në këtë moshë. Me sa është vënë re edhe gjatë vëzhgimit nëpër shkollat e klasa është për t’u theksuar fakti se edhe mësuesit nuk i kushtojnë vëmendje të veçantë këtyre temave, ose edhe më keq e trajtojnë një program të tillë në formë demagogjike, e cila është larg edhe edukimit seksual abstinencë në vetvete, sepse i mëshon më së shumti anëve të errëta të marrëdhënies seksuale si një e keqe për nxënësit në 9-vjeçare, ku i trajton këto tematika mbi bazat e moralit, të mirës së pritshme nga shoqëria, asaj sesi duhet të dukemi më shumë, sesa asaj sesi duhet të jemi (Zenelaj & Shoraj, 2013:106).

Më tej, me fillimin e studimeve në shkollat e mesme të përgjithshme apo profesionale, në tekstet shkollore, ajo çfarë gjen për seksin, seksualitetin dhe edukimin seksual në tërësi janë disa faqe në tekstet e “*Aftësimi të Karrierës dhe Aftësimi të Jetës 10*”, ku i dedikohen edukimit seksual, seksualitetit, marrëdhënies seksuale në adoleshencë dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (Qirjako, 2008:73). Përgjithësisht, trajtohen kuptimi i termave seks dhe seksualitet, dashuri apo marrëdhënie seksuale, si dhe përdorimi i

kontraktivëve. Në lëndën e “*Biologjisë 11*” trajtohet sërish një kapitull mbi riprodhimin e njeriut, kontrollin riprodhues, ndërsa “*Psikologjia 11*”, e cila është një lëndë me zgjedhje trajton pëlqimin seksual dhe bukurinë fizike. Pa harruar edhe faktin që Sociologjia si një lëndë që mund të ofrojë informacion të rëndësishëm mbi rolet gjinore dhe seksualitetin në profilet e shkencave natyrore është lëndë me zgjedhje dhe praktikisht rezulton se më shumë se gjysma e nxënësve nuk marrin një program mbi Sociologjinë. Edhe me vazhdimin e studimeve të larta, deri para 15 vjetësh, Sociologjia që ishte një lëndë e cila zhvillohej në auditorët e të gjitha universiteteve, prej kohësh ajo nuk është më lëndë e cila merret nga të gjithë studentët, pavarësisht degës së studimeve të larta, edhe pse studentët në universitete publike përbëjnë pjesën më të madhe të numrit studentëve. Këtë privilegj e kanë vetëm studentët që ndjekin studimet në disa universitete private, edhe në këtë rast jo në çdo universitet privat (Zenelaj & Shoraj, 2013:113).

Siç shohim më lart, në përgjithësi në shkollat tona çështjet që kanë të bëjnë me edukimin seksual dhe seksualitetin trajtohen kryesisht si një rrezik nga i cili të rinjtë duhet të kujdesen, pa përmendur faktin që seksi është pjesë e jetës që sjell kënaqësi. Përgjithësisht edhe nxënësit e shkollave të mesme, të pyetur mbi temat që trajtohen rreth seksualitetit dhe edukimit seksual shprehen që janë të fokusuar tek metodat kontraktive dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme, ose për to nuk flitet fare, dhe se psikologët në shkolla thuajse nuk realizojnë takime në grupe apo takime individuale me këta nxënës (Zenelaj & Shoraj, 2013:116). Në shkollat tona dhe në familje ne u flasim të rinjve për anët e errëta të seksit, si sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe shtatzaninë e padëshiruar, por pa përmendur që marrëdhënia seksuale, nevoja biologjike për të kryer marrëdhënie seksuale

dhe kënaqësia që përfitohet nga kjo marrëdhënie është pjesë e jetës, e cila natyrisht për të mbetur e tillë kërkon edukimin e duhur mbi higjienën dhe etikën seksuale. Akoma më shumë ne nuk trajtojnë çështje të barazisë, respektit, dashurisë dhe mosdëmtimit të partnerit seksual, duke i konsideruar si çështje të panevojshme për trajtesë (Zenelaj, 2012:79), ndërkohë që nga një studim i kryer në Universitetin e Tiranës me femrat studente, rezulton se rreth 46% e tyre nisin përfshihen në marrëdhënie seksuale pa dëshirën e tyre, thjesht për t'i plotësuar dëshirën partnerit seksual, dhe në 28% të rasteve femrat nuk kanë marrë kurrë iniciativën për marrëdhënie seksuale si shkak i frikës së paragjytimeve nga partneri seksual. Ende edhe sot, tema të kësaj natyre trajtohen me zë të ulët, në rastin më të mirë, apo nëpërmjet moralit në raste të tjera, duke iu dhënë rëndësi mesazheve predikuese të shoqërisë patriarkale në të cilën ne jetojmë. Pa u thelluar më tej, del që studentëve shqiptarë është e vështirë t'u mësohen rolet gjinore apo është e vështirë të trajtohen hapur çështjet e homoseksualitetit. Debatet për tematika të tilla mungojnë, duke bërë që të rriten breza homofobikë (Zenelaj & Shoraj, 2013:116).

Institucionet arsimore, siç janë shkollat, përcjellin mesazhe kontradiktore për të rinjtë, dhe thuajse kurrë nuk merren në konsideratë autorë të shquar që i kanë shërbyer hapjes dhe zhvillimit të shoqërive të sotme moderne. Kështu ne e cilësojmë një akt të pamoralshëm, joetik dhe irracional vetëm sepse ai është seksual. Duket sikur nuk guxojmë të pranojmë atë që Michell Foucault në librin e tij “Care of the Self” shpreh, që marrëdhënia seksuale është një nevojë biologjike për njeriun, ashtu sikurse janë ushtrimet fizike në natyrë, ashtu sikurse është higjiena dhe kujdesi shëndetësor i trupit tonë, apo ashtu siç janë bisedat me miqtë tanë më të ngushtë (Foucault, 1958:135). Ngjan se nuk biem dakord as me Freud, i

cili shpreh se “neurozat shkaktohen aty ku pengesa të jashtme apo të brendshme pengojnë plotësimin e vërtetë të nevojave erotike” (Freud, 1925:61). E kësisoj, ne nuk trajtojmë atë që është vërtetë imorale (Reiss, 1990:74)

Miller dhe Murray (2008) argumentojnë se një nocion ideografik i pastërtisë i ballafaquar me ideografinë e njollosur krijon një klimë shoqërore angazhimi në një sjellje seksuale jashtë martese dhe është gjithnjë e më pak i pranueshëm. Ky ndryshim kulturor ka krijuar hapësirë në sferën sociale për mbështetjen e politikave të edukimit të bazuara mbi vetëpërmbytjen seksuale (Miller & Murray, 2008:58), të cilat kanë treguar në vazhdimësi se kanë qenë të paefektshme në reduktimin e sëmundjeve ngjitëse seksuale, infeksioneve seksualisht të transmetueshme apo vonimin e sjelljeve seksuale deri në martesë (Starkman & Rajani, 2002:315). Këto norma kulturore të përforcuara mund të ndikojnë në mënyrën sesi familjet, por edhe shkollat ndërtojnë mesazhet rreth kohës dhe mënyrës më të përshtatshme për t'u angazhuar në sjellje seksuale. Normat sociale përforcohen në rastet se nuk do të ketë ndërhyrje mbi formën e programeve të edukimit seksual të paktën në institucionet e arsimit (Hitlin, 2012:59).

Të ndryshuarit e traditës dhe mendësisë së shoqërisë sonë duket shumë i nevojshëm, po aq sa edhe i vështirë, sidomos kur flasim për sjelljen seksuale, e cila ende konsiderohet tabu në disa zona të caktuara të Shqipërisë së veriut apo jugut. Ky do të ishte një hap i parë drejt formimit të një shoqërie që nuk duhet të shmang më përshtatjen me modernen dhe bashkëkohoren. “Vetëm duke u përshtatur me kohën, ne mund të përballemi dhe të parandalojmë vuajtjet e kota. Kjo është sociologjia e një edukimi të ri seksual” (Ellis,

1999:32), për të cilën ne kemi kaq shumë nevojë dhe që nuk duhet të vonojmë më për ta arritur.

Programet e një edukimi seksual gjithëpërfshirës, trajnimet e mësuesve apo hartimi i teksteve të posaçme, dhe sidomos ulja e moshës kur nis për herë të parë një edukim seksual duhet të jenë imediate për vendin tonë. Në vijim të këtij kapitulli, do të paraqiten karakteristikat e programeve të edukimit seksual më të përdorura në botën moderne, për të kuptuar natyrën e programeve të edukimit seksual që përdoret në shkollat shqiptare, nëse kanë qasje abstinente (*frenojnë seksin*) apo qasje gjithëpërfshirëse (Zenelaj & Shoraj, 2013:97).

2. 3. 2. Programet e abstinencës në edukimin seksual

Nëse dikur pikëpyetja qëndronte në faktin, nëse edukata seksuale duhet të mësohet apo jo në shkolla, sot është e qartë që edukimi seksual duhet të përfshihet në shkolla, por debati aktual qëndron në tipin e edukimit seksual që duhet të aplikohet në nivele të ndryshme arsimimi. Në vende të zhvilluara si në Amerikë, Canada dhe disa vende në Europë, janë aplikuar në kohëra të ndryshme disa modele të edukimit seksual (Lewis, 2010:116).

Kështu, ka pasur mbështetës të edukimit seksual të orientuar vetëm ndaj edukimit mbi abstinencën (*frenimin seksual*) të cilët propagandojnë se kjo është mënyra e vetme për shmangien e rreziqeve të shoqëruara me aktivitetin seksual, model edukimi i cili ofron një mesazh të fokusuar tek shtyrja e aktit seksual deri në kohën kur nevojat zhvillimore të adoleshentëve janë të plotësuar. Edukimi mbi abstinencën seksuale mund të përkufizohet

edhe si edukim shëndetësor seksual që mbështet idenë se njerëzit, nëpërmjet zhvillimit moral dhe vlerave etike, mund të vonojnë marrëdhëniet seksuale deri në një moshë të caktuar ose martesë. Kjo metodë e ndërtimit të programeve të edukimit seksual fokusohet në faktet e riprodhimit bazë dhe nuk përfshin diskutime apo udhëzime mbi prezervativët apo kontracepsionin dhe për rrjedhojë edukimi mbi abstinencën zakonisht përfshin treguesit e dështimit të përdorimit të prezervativëve dhe kontraceptivëve, gjë që është larg formave të edukimit të drejtpërdrejtë (Seifert, 2006:152).

Sipas Young (2004), edukimi i orientuar vetëm ndaj abstinencës nënkupton një program arsimor që ka si qëllim të tij ekskluziv mësimdhënien e përfitimeve sociale, psikologjike dhe shëndetësore që duhet të nxirren nga frenimi prej aktivitetit seksual ku të rinjtë të:

(a) mësojnë mbi frenimin nga aktiviteti seksual jashtë martese si standardi i pritshëm për të gjithë fëmijët në moshë shkollore; (b) mëson se frenimi nga aktiviteti seksual është mënyra e vetme e sigurt për të shmangur shtatzëninë jashtë martese, sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe probleme të tjera sociale shëndetësore; (c) mëson se një marrëdhënie reciprokisht monogame besnike në kontekstin e martesës është standardi i pritshëm i aktivitetit seksual tek njerëzit; (d) mëson se aktiviteti seksual jashtë martese mund të ketë ndikime të dëmshme psikologjike dhe fizike; (e) mëson se lindja e fëmijëve jashtë martese mund të ketë pasoja të dëmshme për fëmijën, prindin e fëmijës dhe shoqërinë; (f) mëson të rinjtë si të kundërshtojnë gjestet/kërkesat seksuale dhe sesi përdorimi i alkoolit dhe drogës rritet me gjestet/kërkesat seksuale; dhe (g) mëson rëndësinë e arritjes së vetë-realizimit para përfshirjes në aktivitet seksual (Young, 2004:151).

Por studimet kërkimore kanë treguar se nuk ka asnjë ndryshim në sjelljen seksuale midis adoleshentëve të përfshirë në programe të orientuara vetëm ndaj abstinencës dhe të atyre që nuk janë përfshirë në këtë mënyrë (SIECUS, 2013a:18). Pra, duket që ky model i edukimit

seksual në shkolla nuk ka funksionuar. Young (2004) në studimin e tij ka vërejtur se ekziston një problematikë në programet për abstinencën. Në këto programe paraqitet një informacion rreth përdorimit të prezervativit, por janë neglizhuar të dhëna të qarta që tregojnë se prezervativët janë efektivë për parandalimin e shtatzënisë, duke ulur transmetimin e HIV-it dhe sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme. "Të rinjtë dëshirojnë dhe kanë nevojë për informacion të saktë, por shumë programe mbi abstinencën ofrojnë informacion të paplotë dhe çorientues, si dhe nxisin një pikëpamje negative mbi seksin" (Young , 2004:149), për rrjedhojë efektiviteti i tyre dhe impakti në edukimin e brezave të rinj ka qenë i pandjeshëm.

Një tjetër shqetësim i rëndësishëm për sa iu përket politikave edukative mbi seksualitetin të orientuara vetëm ndaj abstinencës, është përjashtimi i diskutimeve mbi preferencat e ndryshme seksuale. Këto programe shmangin diskutimet për lesbiket, homoseksualët, biseksualët, transeksualët dhe pederastët (Weiser & Miller, 2010:418). Programet e orientuara vetëm ndaj abstinencës përkrahin frenimin nga çdo formë e kontaktit seksual jashtë martesës ligjore dhe jashtë çdo preference tjetër seksuale përveç asaj heteroseksuale, duke neglizhuar dhe nxitur paragjykimet e diskriminim për studentët me preferenca seksuale të tjera, veç atyre heteroseksuale (Wernersbach, 2013:184). Programe të tilla janë kritikuar nga shumë grupe ligjore, politike dhe përkrahjeje ligjore për shkak të diskriminimit të tyre ndaj të rinjve me preferenca homoseksuale dhe që kanë kontribuar për mjedise të rrezikshme për këta individë (Fisher , 2009:69), dhe janë përshkruar si "jo etike, të pakujdesshme dhe jodemokratike, për të mos përmendur mospërshtatjen me realitetin e jetës së të rinjve pavarësisht seksualitetit të tyre" (Elia & Eliason, 2010:28).

Këto programe mund të kontribuojnë në "heshtjen aktive" (shmangien) në lidhje me diskutimin e orientimit seksual, të keqinformojnë mbi rreziqet që lidhen me sjelljen seksuale të të njëjtit seks (p. sh., HIV e ekzagjeruar dhe nivele të tjera të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme) dhe iu mohojnë studentëve me preferenca homoseksuale "një hapësirë të sigurt shoqërore të sanksionuar për shprehjen e ndjenjave dhe dëshirave të të njëjtit seks"(Fisher, 2009:70).

Refuzimi për të pranuar ekzistencën e studentëve me preferenca seksuale homoseksuale apo biseksuale etj, nxit homofobinë tek studentët duke neglizhuar mundësitë për të mësuar tolerancën dhe pranimin (Rienzo, Button, Sheu, & Li, 2006:94). Përveç kësaj, mohimi i normalitetit të eksplorimit seksual të adoleshentëve është potencialisht i dëmshëm për të gjithë nxënësit dhe veçanërisht e dëmshme për individët LGBTQ (Elia & Eliason, 2010:29). Duke qenë se edukimi i orientuar vetëm ndaj abstinencës vazhdon të debatohet dhe kritikohet për shkallën dhe efikasitetin e tij, ndikimi i këtyre politikave për të rinjtë LGBTQ mungon në shumë nga këto diskutime (Wernersbach, 2013:184).

Përveç sa u shkrua më lart, autorë të tjerë si, Goodson, Suther dhe Wilson (2003) kanë pohuar se edukimi seksual është i mbushur edhe me probleme të lidhura me terminologjinë e përdorur në tekste, me përkufizimet dhe kuptimet e përbashkëta (Goodson, Suther & Wilson, 2003:92).

Më vonë si shkak i problematikave që u hasën në programet e edukimit seksual mbi abstinencën u hartua dhe miratua programi i edukimit seksual *shitesë* mbi abstinencën që përveç të mësuarit mbi abstinencën mësonte dhe përdorimin e metodave mbrojtëse për

parandalimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, si dhe përdorimin e kontraceptivëve. Sipas Masters, Beadnell, Morrison, Hoppe dhe Gilmore (2008),

"programet shitesë të edukimit seksual mbi abstinencën iu ofrojnë të rinjve informacion mbi shtatzaninë, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, marrëdhëniet seksuale, orientimin dhe vlerat etike; vendimmarrjen, negocimin, përdorimin e prezervativit dhe seks më të sigurt. Me gjithë avancimin e këtyre programeve, krahasuar me programin e parë, sërish u theksuan probleme në trajtimin e seksualitetit dhe roleve gjinore. Për rrjedhojë, studiues të shumtë hartuan programet gjithëpërfshirëse të edukimit seksual" (Masters, Beadnell, Morrison, Hoppe & Gilmore, 2008:89).

2. 3. 3. Programet gjithëpërfshirëse të edukimit seksual

Duke parë që programet e edukimit seksual mbi abstinencën si dhe më vonë ato të *abstinencës shitesë* nuk rezultuan efektive, madje patën kritika mbi mënyrën sesi i edukonin të rinjtë mbi seksin dhe seksualitetin, u hartuan programet e *Edukimit Gjithëpërfshirës Seksual* që u konsideruan si një përvojë të mësuar gjatë gjithë jetës që përfshin zhvillimin seksual të një personi, shëndetin seksual dhe riprodhues, marrëdhëniet ndërpersonale, afeksionin, intimitetin, imazhin trupor dhe rolet gjinore (SIECUS, 2013c:23).

Sipas agjensisë *Informacion mbi Seksualitetin dhe Këshillim Arsimor i Shteteve të Bashkuara* (SIECUS, 2013a:18), lidhur me iniciativat për edukim gjithëpërfshirës seksual kërkohet që edukimi seksual të fillojë që kur fëmija të lindë, mënyra sesi prindërit dhe/ose kujdestarët e tyre ndërveprojnë me ta në lidhje me rolet gjinore të mësuara që në familje, që kur një fëmijë mëson fillimisht kuptimin e dashurisë dhe të marrëdhënieve. Ndërsa një fëmijë bëhet adoleshent, faktorë të tjerë si bashkëmoshatarët dhe media fillojnë të luajnë rol

në zhvillimin e tyre dhe në kuptimin e jetës. Sipas SIECUS (2013b:19), një program gjithëpërfshirës i edukimit seksual ka disa synime.

“Ai duhet të ofrojë informacion të saktë që iu jep mundësinë adoleshentëve të zhvillojnë qëndrimet, vlerat etike dhe besimet e tyre. Të mësojnë çdo gjë mbi marrëdhënien seksuale si akt njerëzor që sjell kënaqësi, sëmundje apo vuajtje. Një program gjithëpërfshirës i edukimit seksual duhet të ndihmojë për zhvillimin e marrëdhënieve dhe aftësive ndër-personale dhe t’u japë adoleshentëve mundësinë të marrin vendime të përgjegjshme, nëse duhet të përfshihen apo jo në sjellje seksuale, dhe nën masa mbrojtëse. T’i aftësojë ata për respekt reciprok mes partnerëve, e të drejta të barabarta gjinore gjatë aktit seksual dhe më gjerë. T’i aftësojë ata që të reagojnë dhe të orientohen sesi të reagojnë në rastet e ngacmimeve seksuale. Informacioni i SIECUS mbi edukimin gjithëpërfshirës seksual deklaron gjithashtu se varet nga ligjbërësit shtetërorë, anëtarët e bordit shkollor dhe mësuesit që të vendosin se cili lloj i programit gjithëpërfshirës seksual duhet të përdoret brenda një sistemi arsimor shtetëror (SIECUS, 2013b:20).”

Edukimi gjithëpërfshirës seksual nuk e neglizhon çështjen e abstinencës, pasi e sheh si një aspekt të gjerë të kurrikulës së edukimit gjithëpërfshirës mbi seksualitetin, duke e vlerësuar mënyrën më të mirë për t’u mbrojtur nga një shtatzëni e padëshiruar ose nga marrja e një infeksioni seksualisht të transmetueshëm. Por, programet gjithëpërfshirëse pranojnë gjithashtu faktin se ka shumë studentë, të cilët janë të angazhuar në disa lloje të sjelljes seksuale që përfshijnë seksin oral, anal ose vaginal dhe për rrjedhojë informacioni dhe edukimi seksual bazuar mbi abstinencën nuk është i mjaftueshëm dhe efikas. Për rrjedhojë programet gjithëpërfshirëse të seksualitetit, përveç informacionit mbi abstinencën, japin edhe edukim mbi format e ndryshme të kontracepsionit, i cili mund të jetë i dobishëm për ata që janë apo mund të jenë së shpejti seksualisht aktivë (Milstein, 2006:98).

Edukimi gjithëpërfshirës mbi seksualitetin është konceptuar më tepër sesa thjesht një diskutim mbi kontracepsionin. Kjo qasje mbi edukimin seksual është e plotë, pasi trajton të gjitha aspektet e seksualitetit të të rinjve dhe jo thjesht sjelljet në të cilat mund të angazhohen. Shumë programe trajtojnë gjithashtu marrëdhëniet familjare, komunikimin, vlerat, identitetin seksual dhe imazhin e trupit, përveç abstinencës dhe kontracepsionit. Ashtu si programet që orientohen vetëm ndaj abstinencës, ekziston diversitet në përmbajtjen dhe cilësinë e programeve të edukimit gjithëpërfshirës mbi seksualitetin. Në shumë programe të kurrikulave gjithëpërfshirëse ato që përdoren janë objektivat e edukimit seksual të vendosura nga Këshilli mbi Informacionin dhe Edukimin Seksual të Shteteve të Bashkuara (SIECUS, 2013:18).

Gjithsesi, edhe programi gjithëpërfshirës mbi seksualitetin është kritikuar për faktin se mund të t'i bëjnë studentët seksualisht më aktivë edhe kur mund të mos jenë të tillë. Në fakt, studimet kanë treguar se ndodh e kundërta; pjesëmarrja në një program gjithëpërfshirës mund të vonojë fillimin e aktivitetit seksual (AGI, 1994:31). Studime të tjera kanë treguar se programet gjithëpërfshirëse janë efektive edhe në rritjen e njohurive dhe ndryshimin e sjelljeve të të gjitha shtresave të popullsisë (Coyle et. al. , 1999:183; Coyle, Kirby, Martin, Gomez & Gregorich, 2007:845).

Mbështetësit e edukimit seksual gjithëpërfshirës e konsiderojnë si një të drejtë të studentëve përfshirjen në programet e informacionit mbi kontracepsionin (AVERT, 2006:519). Edukimi seksual gjithëpërfshirës përfshin gjithashtu një kuadër të përgjithshëm të abstinencës, por nuk lë mënjanë ndihmesën e studentëve për të zhvilluar aftësi që zvogëlojnë sjelljet e rrezikshme nëpërmjet përdorimit të informacionit të saktë mbi sjelljet e

rrezikshme dhe efektivitetin e kontraktivëve. Kjo qasje e edukimit seksual thekson dhe kërkon përzgjedhjen e materialeve të përshtatshme me moshën, me përvojat e ndryshme (Seifert, 2006:79).

Shumica e vendeve që kanë ndërtuar edukimin seksual mbi abstinencën besojnë se abstinencia seksuale deri në martesë nuk është realiste dhe për rrjedhojë mbështesin edukimin gjithëpërfshirës seksual. Shumë shtete kanë përmirësuar programet e tyre, jo vetëm për të testuar dhe parandaluar shtatzaninë dhe transmetimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, por edhe për të rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin e studentëve mbi shumë aspekte të ndryshme të seksualitetit, përfshirë orientimin seksual, vetëidentitetin dhe respektin për veten dhe të tjerët (Milstein, 2006:58). Qëllimi i përgjithshëm i edukimit seksual, qoftë nëpërmjet qasjes së abstinencës, ose nëpërmjet qasjes gjithëpërfshirëse, duhet të jetë përgatitja e studentëve për ndryshime psikologjike që vijnë nga puberteti, adoleshenca si dhe pasojat e mundshme të aktivitetit të hershëm seksual (Seifert, 2006:79).

Ky lloj edukimi iu ofron adoleshentëve informacion të saktë në lidhje me kontraktivët, sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe shtatzëninë, si dhe pasojat reale të seksit (Weiser & Miller, 2010:421), dhe ka rezultuar i suksesshëm në vonimin e fillimit të seksit, duke zvogëluar numrin e partnerëve seksualë, si dhe duke rritur përdorimin e kontraktivëve dhe prezervativëve (Kirby, 2007:208; WHO, 2004:32). Studimet tregojnë se programet më efektive të edukimit seksual mësojnë metodat për uljen e rrezikut seksual, trajtimin e presionit shoqëror, duke përforcuar vlerat individuale, si dhe nxitjen e besimit në aftësinë e dikujt për t'u angazhuar në seks të përgjegjshëm (Kirby et. al. ,1994:359). Për

shkak se ka më pak agjenda morale (p. sh., ndikimet fetare, homofobike/vlerat heteronormative) të pranishme në edukimin gjithëpërfshirës seksual, këto programe kanë më shumë gjasa për të trajtuar nevojat e të gjithë adoleshentëve, duke përfshirë adoleshentët LGBTQ, duke respektuar kështu të drejtat e të rinjve për të njohur çdo gjë rreth seksualitetit në mënyrë sa më profesionale, duke i bërë ata të aftë e të përgjegjshëm për vendimet seksuale që dëshirojnë ose jo të ndërmarrin (Wernersbach, 2013:109; Friedman, 2011:44).

2. 4. FEJA DHE IMPAKTI NË SJELLJEN SEKSUALE TË STUDENTËVE

2. 4. 1. Fryma fetare dhe sjellja seksuale

Shqipëria është një vend laik, ku mbizotërojnë tri besime kryesore si katolicizmi, myslimanizmi dhe ortodoksia. Në periudha të ndryshme historike jemi konsideruar si vend ateist, laik, por që kryesisht njihemi si vend me bashkëjetesë dhe harmoni fetare. Natyrisht feja në vetvete është një institucion mjaft i rëndësishëm social për jetën e çdo besimtari të secilës prej feve, që shpesh dikton sjellje dhe qëndrime të caktuara, pavarësisht se vendi ynë nuk shquhet për besimtarë fetarë konservatorë, kjo të paktën jo në një numër të konsiderueshëm të popullsisë.

Për disa autorë, feja portretizohet si një fenomen që ka formuar perceptimin njerëzor në lidhje me qëndrime dhe sjellje të caktuara. Gjithsesi, ata pohojnë se feja në lidhje me seksualitetin dhe sjelljen seksuale ka formuar perceptime në mënyrat negative dhe kryesisht mbi demagogjitë e morales dhe imorales (Yarhouse, 2005:31).

Rrjedhimisht, është e rëndësishme të analizohen orientimet ndaj sjelljes seksuale të feve të caktuara për të parë më qartë nëse të gjitha besimet fetare kanë të njëjtat qëndrime ndaj sjelljes seksuale. Konkretisht, islamizmi dhe kristianizmi si fe monoteiste abrahamike ndalojnë aktivitetin seksual jashtë martesës heteroseksuale. Kisha katolike ka një qëndrim të qartë kundër kontracepsionit, ndërkohe që feja islame është më pak rigoroze dhe e qartë në këtë drejtim (de Visser et. al. , 2007:67). Studimet e fesë dhe seksualitetit zakonisht konstatojnë se besimet dhe/ose veprimtaritë fetare shoqërohen me më shumë qëndrime seksuale konservatore, fillim më të vonshëm të sjelljes seksuale dhe një gamë më të

kufizuar të përvojave seksuale (Shih: Cochran, Chamlin, Beeghley, & Fenwick, 2004:54; Davidson, Moore, & Ullstrup, 2004:339; Jones, Darroch, & Singh, 2005:283; Rostsoky, Eilcox, Wright, & Randall, 2004:691). Konkluzioni i nxjerrë nga këto studime në kulturat kristiane është se feja ofron dhe përforcon një ideologji seksuale që ndalon marrëdhënien seksuale sidomos të adoleshentëve (Rostsoky et. al. , 2003:359).

Në përgjithësi, kërkimet kanë treguar në mënyrë të përsëritur një lidhje negative midis frymës fetare dhe sjelljes seksuale (Shih: Nonnemaker, McNeely, & Blum, 2003:2050; Pluhar et. al.,1998:478; Thornton & Cambum, 1989:648; Zaleski & Schiaffino, 2000:223). Megjithatë, disa studime nuk kanë identifikuar asnjë marrëdhënie midis këtyre faktorëve (Shih: Ali & Naidoo, 1999:27; Donnelly, Duncan, Goldfarb, & Eadie, 1999:429; Wyatt, Carmona, Loeb, Guthrie, Chin, & Gordon, 2000:471). Shumica e diskutimeve mbi sjelljen seksuale në gjirin e besimeve të ndryshme fetare theksojnë pastërtinë seksuale, dhe eposhin si problemin parësor (Edger, 2012:167). Nga përkufizime të ndryshme eposhi përshkruhet rëndom si një dëshirë seksuale e diçkaje të ndaluar nga Zoti (Harris, 2003:19). Virgjëria vazhdimisht konsiderohet si diçka që duhet të mbrohet dhe vlerësohet. Ruajtja e vetes për martesën është pjesë thelbësore e lëvizjes mbi pastërtinë seksuale (Gresh, 2007:89; Elliot, 2006:119). Kështu p.sh.; çiftet kristiane duhet të festojnë seksin vetëm brenda kontekstit të martesës dhe seksi jashtë martese konsiderohet mëkat (White, 1993:73; Dobson, 1982:51), por jo vetëm kristianët edhe në fe të tjera marrëdhënia seksuale nuk duhet t'i paraprijë lidhjes me martesë. Feja me bazë krishtërimin në vendet perëndimore mbështetet në vetëkontrollin dhe jetesën në përputhje me urdhëresat dhe angazhimet morale, si ndershmëria, përgjegjësia dhe respekti për autoritetin dhe trupin e secilit person (Landor et.

al. , 2011:301; Smith, 2005:29). Një mësim i zakonshëm i besimit fetar është që njerëzit nuk duhet të kenë marrëdhënie seksuale jashtë martesës, e cila e bën angazhimin në aktivitet seksual para martesës një gjë moralisht të papranueshme. Si rezultat, ndikimi i supozuar i fesë në sjelljet seksuale është kryesisht funksion i vlerave që ajo përçon. Këto parime janë parë si të shuguruara në mënyrë hyjnore, dhe sjelljet që i shkelin ato konsiderohen të pamoralshme (Simons et. al. , 2004a:560; 2004b:281; 2004c:53).

Pavarësisht diskutimeve rreth ndasive fetare, studiuesit i kanë kushtuar vëmendje të kufizuar çështjes së kuptimit të dallimeve në sjelljet që rrjedhin nga respektimi i feve të mëdha botërore, të përcaktuara këtu si Islamizmi, Hinduizmi, Krishtërimi, Budizmi, dhe Judaizmi. Edhe pse shkrimet e shenjta të këtyre feve përjashtojnë disa nga këto sjellje, institucionet fetare nuk janë po aq efektive në formimin e veprimeve të individëve (Adamczyk & Hayesa, 2012:176). Përveç kësaj, kur një pjesë e konsiderueshme e një popullate iu bindet këtyre besimeve fetare, pasuesit e tyre mund të ndikojnë në klimën makrokulturore dhe të legalizojnë kufizimet formale, të cilat mund të formojnë sjelljen e të gjithë banorëve brenda një kombi. Fuqia makro e kulturës mund të ndikojë fuqishëm në formimin e qëndrimeve të individëve (Inglehart & Norris, 2003:112; Scheepers, Te Grotenhuis, & Van Der Slik, 2002:163). Por, në shoqërinë shqiptare gjenden tri besime fetare, të cilat duke mos qenë një fuqi makro e kulturës fetare mund ta kenë të vështirë që me moralin e tyre mbi sjelljen të brendësojnë dhe formojnë sjelljen e tërë pjesës së mbetur jashtë besimit fetar, por dhe brenda tij.

Durkheim (1951) mbështet mendimin se feja i bashkon njerëzit në një komunitet moral, duke detyruar zbatimin e bindjeve morale dhe detyrimeve të grupit të tyre (Durkheim,

1951:87). Në bazë të kësaj teze, studiuesit kanë zhvilluar argumentin moral të komuniteteve (Hazelrigg, 1991:284). Ideja është se kur individët fetarë janë rreth njerëzve të tjerë fetarë, "feja hyn lirshëm në ndërveprimet e përditshme dhe bëhet pjesë e vlefshme e sistemit normativ, duke forcuar lidhjet midis fesë dhe sjelljeve personale" (Coleman, 1986:1321). Nga ana tjetër, kur individët fetarë janë në pakicë, feja bëhet pjesë e fragmentuar e jetës dhe ka më pak të ngjarë të formësojë sjelljen, siç mund të jetë edhe rasti i besimtarëve në Shqipëri. Kështu, Durkheim (1995) parashtroi tezën që kur individët fetarë janë së bashku, qëndrimet dhe besimet e tyre mund të forcojnë dhe konsolidojnë grupin e tyre, duke krijuar një ndikim që është '*sui generis*' që do të thotë një ndikim që nuk mund të reduktohet në pjesët e tij përbërëse. Ja përse nga disa studiues, Islami është konsideruar të ketë një efekt kulturor '*sui generis*' në nivel kombëtar, natyrisht në rastet ku feja islame ka një pjesë dërrmuese të popullsisë si pasuese të saj (Coleman, 1986:1321; Collins, 1981:991; Hazelrigg, 1991:284, Ritzer, 1990:364), dhe ja përse individët myslimanë dhe kombet me shumicë myslimane kanë shkallë më të ulët të HIV/ SIDA-s dhe sëmundjeve të tjera seksuale. Por nuk mbeten më pas edhe vende të cilat kanë një popullatë homogjene fetare të çdo besimi tjetër qoftë ky kristian, judaist, etj.

Kështu, nëse kultura fetare është forca makro përgjegjëse për sjelljet, atëherë ndryshimi i sjelljeve nëpërmjet ligjeve dhe iniciativave të politikave bëhet veçanërisht i vështirë, sepse normat kulturore apo bindjet personale fetare janë më të fuqishme dhe mund të koordinohen me kufizime formale për të formësuar sjelljet seksuale të individëve. Autorët në studimin e tyre mbi forcën e ndikimeve makrokulturore synuan të veçojnë ndikimet makrokulturore nga kufizimet formale, si dhe nga shumë procese në nivel mikro për

formësimin e sjelljeve seksuale të individëve. Kështu, për shkak të mekanizmave sociale të kontrollit (Clayton, 1969:471), të rinjtë që janë të lidhur fuqimisht me besimet e tyre, me prindërit myslimanë, dhe me miq dhe ithtarë të tjerë fetarë, kanë më pak gjasa për të shkelur parimet e besimit të tyre, pasi kjo mund të rrezikojë lidhjet e tyre si shkak i shkeljes së normave të përcaktuara nga grupi apo komuniteti.

Studimet e fesë dhe seksit tek studentët e universitetit kanë një histori të gjatë, por edhe komplekse, sepse janë disa faktorë që duhen analizuar, dhe shumica janë shoqëruar me një marrëdhënie të kundërt ndërmjet fesë dhe aktit të parë seksual (Clayton, 1969:471, Davidson, Moore, & Ullstrup, 2004:338; Jessor & Jessor, 1975:481). Kështu në një studim të Uecker (2008), vetëm 55% e femrave në universitet që ndjekin shërbesat fetare çdo javë kanë pasur marrëdhënie seksuale, krahasuar me 83% të atyre femrave që i kanë ndjekur shërbesat fetare vetëm disa herë në vit (Uecker, 2008:731). Rreth 40% e femrave të universitetit që e shohin veten e tyre si “shumë besimtare” kanë pasur marrëdhënie seksuale paramartësore (Pluhar, Frongillo, Stycos, & Dempster-McClain, 1998: 481). Ata që marrin pjesë në shërbime fetare vetëm disa herë në vit, kanë pa dyshim më shumë partnerë se ata që marrin pjesë një herë në javë apo në muaj në këto shërbesa. (Davidson etj, 2004:340). Por duhet kuptuar që feja dhe fryma fetare janë të lidhura ngushtë. Shpeshtësia e frekuentimit të kishës (d.m.th fryma fetare) mund të ushtrojë ndikimin e saj në mënyra më të ndryshme, pra të dyja janë studiuar për ndikimin e tyre tek qëndrimet dhe sjelljet seksuale (Davidson, Moore & Ullstrap, 2005:364). Ndërsa vetëm feja nuk mund të përcaktojë mënyrën dhe arsyen përse njerëzit do të sillen në një mënyrë të caktuar ose çfarë besojnë, “feja pretendohet universalisht si burimi dhe autoriteti për kodet morale, kontrollin

e impulsive dhe masat e pushtetit social” (Beit-Hallahmi, 2004:123). Studimet kanë treguar se vetëm feja nuk parashikon gjithmonë sjelljet ose opinionet në një drejtim moral apo tjetër. Pabarazitë midis veprimeve dhe besimeve morale ekzistojnë brenda jetëve fetare të individëve. Megjithëse një individ mund të kërkojë një besim fetar të caktuar me një grup të caktuar doktrinash, kodet dhe etika e kësaj feje nuk mund të respektohen nga të gjithë besnikët fetarë. Për më tepër, këto kode fetare nuk cenojnë gjithmonë drejtpërdrejt sjelljet, veçanërisht sjelljet seksuale që nuk mund të diskutohen hapur në mjedise fetare. Fryma fetare dhe praktikat seksuale personale, specifikisht përfshirja në marrëdhënie seksuale paramartesore, janë konstatuar të kenë një lidhje të anasjellë tek studentët e universiteteve (Beit-Hallahmi, 2004:124). Ky model ka rezultuar i vërtetë, në fakt në tri breza të studentëve të universiteteve (Earle et. al. , 2007:49). Për shkak të mjediseve të reja, lirisë së re dhe gatishmërisë për të marrë në konsideratë zgjedhje të reja në jetë, studentët mund të jenë pre e shfrytëzimit seksual.

Edhe pse institucionet e arsimit, fesë dhe familjes besohet të kontrollojnë sjelljen seksuale nëpërmjet stigmatizimit, socializimit dhe mbikëqyrjes, procese që shpalosen ndërsa individët brendësojnë normat e seksualitetit dhe bëhen vetërregullues (Davidson et. al. , 2008:129; Euingson, Van Haitsma, Laumann, & Tebbe, 2004:343), duhet të theksohet se feja në vetvete nuk mund të çojë në sjellje dhe qëndrime seksuale më konservatore. Për shembull, disa studime të të rinjve tregojnë se ndjekësit e feve të caktuara jo-kristiane mund të kenë qëndrime dhe modele sjelljeje më liberale (Leiblum et. al. , 2003:348; Lottes & Kuriloff, 1994:214). Megjithatë, rezultatet e Meier (2003) treguan se fryma fetare vazhdon të jetë një parashikues i rëndësishëm i sjelljes seksuale dhe këto rezultate u konfirmuan

edhe nga Davidson, Moore dhe Ullstrup (2004), të cilët konstatuan se studentët që ishin më shpirtërorë/ose më të përfshirë në fenë e institucionalizuar kishin më pak gjasa për të qenë seksualisht tolerantë (Davidson, Moore & Ullstrup, 2004:339).

Fryma fetare mund të përkufizohet si një grup besimesh, doktrinash dhe ritualesh të institucionalizuara dhe standarde etike për të jetuar një jetë të mirë (Haglund & Fehring, 2010:465; Holder et. al., 2000:298). Shumica e kërkimeve ka mbështetur konceptin se sidomos tek adoleshentët që ishin më fetarë kishin tendencën të vononin aktivitetin seksual (Kirby, 2002:475; Rostosky et. al., 2004:679). Për adoleshentët meshkuj dhe femra, ndjekja e shpeshtë e shërbimeve fetare dhe aktiviteteve rinore fetare, nivele më të larta të rëndësisë së fesë në jetën e përditshme dhe ndjenjat fetare, si dhe bindja e zgjeruar ndaj mësimave fetare lidheshin me nivele më të ulëta të fillimit të vullnetshëm të aktivitetit seksual (Fehring et. al., 1998:234; Holder et. al., 2000:298; Lammers et. al., 2000:43; Lefkowitz et. al., 2004:153; McCree et. al., 2003:5; Nonnemaker et. al., 2003:2051; Rostosky et. al., 2003:361). Pasja e një mbështetjeje më të madhe sociale nga shokët në një kontekst besimi lidhej me mundësi më të kufizuara të fillimit të aktivitetit seksual që kishin bashkëmoshatarët të cilët ndiqnin kishën rregullisht (Holder et. al., 2000:301; Manlove et. al., 2008:112; Mott et. al., 1996:16).

Një fushë tjetër e frymës fetare me interes për kërkuesit e seksualitetit është fundamentalizmi ose bindja që qëndrimet dhe sjelljet duhet të diktohen nga doktrina dhe tradita formale fetare (Tierney et. al., 2011:627; Altemeyer & Hunsberger, 1992:123). Fundamentalizmi ndryshon nga fryma e brendshme fetare për faktin se individët me shkallë të lartë fryme të brendshme fetare mund të njohin disa burime besimi si tradita ose rituali,

arsyetimi personal ose interpretimi ose shkrimet e shenjta, ndërsa individët me fundamentalizëm të lartë fetar kanë prirjen t'i konsiderojnë dogmat fetare si burimin e vetëm të vërtetë të autoritetit moral (Hood, Spilka, Hunsberger, & Gorsuch, 1996:104). Fundamentalizmi është lidhur pozitivisht me qëndrime negative ndaj seksit para martese në një popullatë model kolegji (Bassett, Smith, Newell, & Richards, 1999:213), si dhe pritshmëritë e roleve tradicionale mashkullore/femërore tek studentet femra të kolegjeve (Bang, Hall, Anderson & Willingham, 2005:234).

Për të rinjtë seksualisht me përvojë, ndjekja më e shpeshtë e shërbimeve fetare dhe pjesëmarrja në aktivitete fetare të organizuara lidhej me shpeshtësi më të ulët të marrëdhënies seksuale dhe masturbimit, si dhe numrit të partnerëve seksualë (Fehring et. al., 1998:239; Lefkowitz et. al. , 2004:347). Megjithatë, nuk është e qartë, nëse frekuentimi është tregues i saktë i frymës fetare tek grupet e besimit, ndërsa anëtarët e shoqatave fetare ndryshojnë ndjeshëm në pritshmëritë e pjesëmarrjes fetare. Për më tepër, frekuentimi fetar nuk reflekton qëndrime dhe motivime specifike fetare që shoqërohen me frymën fetare, as nuk shpjegojnë ndikimet e jashtme që përcaktojnë pjesëmarrjen (p.sh., ndikimi social i bashkëmoshatarëve dhe familjes). Këto kufizime kundërshtojnë supozimin se frekuentimi fetar reflekton frymën fetare në institucionet fetare (Farmer et. al. , 2009:859). Edhe në studimin e tyre mjaft të njohur të Kinsey, Pomeroy, Martin dhe Gebhard (1953), u raportua fillimisht se ndryshimi në përkushtimin fetar brenda grupeve fetare ishte më i rëndësishëm sesa anëtarësimi dhe frekuentimi për përcaktimin e modeleve të sjelljes seksuale, si për shembull masturbimi për të arritur orgazëm, përkëdheljet paramartesorë dhe akti seksual para martese (Kinsey, Pomeroy, Martin & Gebhard, 1953:349).

Funksioni integrues i fesë që stabilizon sjelljen dhe ofron një avantazh nga pikëpamja sociale në shoqëri u bë më parë temë e debatit midis Holbein, Helvetius, Machiavelli dhe Hobbes. Edhe sipas Hegel, "Në veçanti, feja kërkonte dhe rekomandonte për rastet e vështirësisë publike të konfuzionit dhe ndrydhjes dhe theksoi komfortin për padrejtësi dhe shpresë si zëvendësim për humbjen" (Hegel, 1970:73). Feja konsiderohet si kompensim për zhgënjimin dhe për vuajtjet tokësore. Ky mendim u transmetua më vonë nga Karl Marks: "Feja është teoria universale e kësaj bote, bazat e saj universale të komfortit dhe justifikimit. Feja është psherëtimja e krijimit të dëshpëruar, shpirti i botës pa zemër, pasi është shpirti i një gjendjeje pa shpirt. Është opiumi për masat" (Marx, 1970:37). Me Sigmund Frojdn ky funksion kompensues u vu në funksion në një sistem të fillesës së fesë me anë të të cilit njeriu primitiv humanizon natyrën që e rrethon për të ulur rrezikun dhe frikën e tij që rrjedh nga kjo e fundit. Për Frojdn feja është psikologjia e projektuar tek bota jashtë (Freud, 1925:69), Parsons (1967) grupet referuese u ofrojnë njerëzve një grup të gatshëm me të cilin të vlerësojnë rrethanat e tyre dhe të formojnë qëndrime të reja. Ai shtjelloi dy lloje grupesh referuese: krahasues dhe normativ. Grupet krahasuese referuese ofrojnë një kuadër reference që individët përdorin për t'u krahasuar me të tjerët, ndërsa grupet referuese normative caktojnë dhe ofrojnë standarde për individin. Grupet fetare supozohet të ofrojnë më shumë tipin normativ sesa tipin krahasues. Sipas tij, normat fetare zakonisht përcaktojnë kontekste të përshtatshme, në të cilat njerëzit duhet të përfshihen në aktivitete seksuale. Institucionet fetare ofrojnë skenarë informalë se kur aktiviteti seksual është dhe nuk është i përshtatshëm (Parsons, 1967:28). E gjitha kjo sipas teorisë së normave sociale do të thotë se normat e grupeve ose grupet referuese të një individi bëhen mjet i fuqishëm në zgjedhjet që individët bëjnë në lidhje me sjelljen e tyre, për faktin se

këto sjellje inkuadrohen nga ato norma (Perkins, 2002:165). Institucionet fetare nxisin një sërë vlerash, normash dhe mbështetjesh sociale të lidhura me marrëdhëniet, të cilat shërbejnë për të nxitur më shumë mundësi në martesë dhe për të frenuar sjelljen e dëmshme për martesën (Perkins, 2002:166). Shumica e traditave fetare i japin një vend të privilegjuar martesës si kontekstin optimal për aktivitetin seksual dhe munden, por jo gjithmonë, të stigmatizojnë nga pikëpamja sociale veprimet që tregojnë seksin paramartesor (Helm et. al., 2009:235). Për rrjedhojë, duhet thënë se përkatësia në një grup që përdor një kuadër normativ referues veprimi nuk garanton që individët do të pajtohen me atë kuadër reference (Helm et. al., 2009:237). Kështu, edhe ndikimi i fesë në sjelljen seksuale, që pretendohet të jetë në lidhje të ngushtë mes tyre, ku fryma fetare dhe besimi i një studenti ul mundësinë për seks të parakohshëm nuk garanton që studentët besimtarë të pajtohen me normat e komunitetit fetar që praktikojnë (Helm et. al., 2009:241).

2. 4. 2. Spiritualizmi dhe sjellja seksuale e studentëve

Spiritualizmi është një nënloj i frymës fetare që qendërzohet në një përvojë subjektive të brendësuar të besimit në një qenie hyjnore ose të mbinatyrshme që dallohet nga besimet e ndjekura nga fe specifike (Hyman & Handal, 2006:271; Marler & Hadaway, 2002:294). Spiritualizmi përkufizohet si "marrëdhënia e dikujt me Zotin ose çfarëdo që dikush percepton të jetë si *Kapërcimi i Kufirit të Fundit (Transdeshenca)*" (Moore, 2010:73; Hodge, 2003:51). Për më tepër, tendencat e kohëve të fundit tregojnë se një numër më i madh njerëzish e konsiderojnë fenë si jashtë mode. Kjo nuk nënkupton se njerëzit po braktisin besimet e tyre fetare, por ata mund ta ushtrojnë pa nevojën për t'u lidhur me një institucion më të zgjeruar (Michaelides, 2011:94). Shumë studime kanë studiuar tendencën

e re të uljes së identifikimit me një fe të organizuar (Peterman, Fitchett, Brady, Hernandez, & Cella, 2002:54).

Më specifikisht, nivele më të larta të spiritualizmit janë identifikuar si faktorë rreziku për përfshirjen në praktika të ndryshme të rrezikshme seksuale (Burris, Smith, & Carlson, 2009:289). Murray-Swank, Pargament dhe Mahoney (2005), lidhja pozitive midis spiritualizmit dhe sjelljes seksuale të rrezikshme ka konstatuar të ketë ndryshime gjinore tek të rriturit në moshë madhore, ku spiritualizmi është parashikues i sjelljes seksuale të rrezikshme, por jo i sjelljes seksuale mashkullore (Murray-Swank, Pargament & Mahoney, 2005:203). Për shembull, Burris, Smith dhe Carlson (2009) zbuluan se spiritualizmi tek gratë duhet të lidhet me numrin e rritur të partnerëve seksualë, shpeshtësinë e seksit dhe mospërdorimin e prezervativit, ndërsa këto lidhje nuk ishin të rëndësishme për burrat (Burris, et.al., 2009:291). Në të kundërt, burrat evidentuan një lidhje negative midis spiritualizmit dhe shpeshtësisë së seksit. Ata shpjegojnë se femrat ndryshojnë në motivimin e tyre për t'u përfshirë në seks, specifikisht, ata përmendin se femrat përfshihen në seks "për të arritur intimitet emocional dhe bashkim" (Burris, Smith & Carlson, 2009:287). Gjithsesi, rezultatet kanë treguar se tek faktorët shpirtërorë dhe fetarë, marrëdhënia e vetme e rëndësishme me sjelljen seksuale ishte ajo e lidhjes me të tjerët dhe jo me vetë fenë (Holder et. al. , 2000:301).

Ndërkohë në dijeninë time, dhe në hulumtimet e gjata të bëra mbi fenë, për ateizmin dhe individët që pohojnë se nuk besojnë në fe apo në ekzistencën e Zotit, nuk ekzistojnë studime të mirëfillta, akoma më pak për ata që vetëquhen si agnostikë, "apo individë që e

njohin ekzistencën e Zotit, edhe pse nuk i luten dhe as nuk i tremben ekzistencës së tij" (Fee & Ingram, 2004:112).

2. 4. 3. Dallimet gjinore në besimin fetar dhe sjelljen seksuale

White bën gjithashtu dallimin midis burrave dhe grave dhe vendos burrat në nivelin e seksit superior. Në argumentin e White, burrat seksualisht devijantë janë viktimë, pasi ata nuk janë në gjendje për të kontrolluar dëshirat e tyre seksuale, ndërsa gratë e tyre nuk ua plotësojnë nevojat seksuale (White, 1993:71).

Në shumë pjesë të letërsisë predikuese ungjillore, dalin në dritë tema të qarta si, gruaja është në një mënyrë apo tjetër përgjegjëse për dëshirat e pakontrollueshme seksuale të burrit të saj, ndërsa burri konsiderohet si dikush që varet nga gruaja e tij për ta parandaluar atë nga humbja e kontrollit (Edger, 2012:94). Por mesa duket, edhe sipas Landor etj. (2011), në studimet e deritanishme rezulton se besimi fetar ka më shumë efekt në sjelljen seksuale të femrave sesa të meshkujve (Landor et.al., 2011:303; Rostosky et.al., 2003:364). Si rrjedhojë, pritshmëritë janë që të dhënat për rrugët që lidhin fenë dhe sjelljen seksuale të jenë më të larta tek femrat, ndaj edhe ndodh që gratë të jenë më të tërhequra seksualisht dhe për rrjedhojë meshkujt të kenë më pak gjasa për kënaqësi seksuale me femrat më besimtare. Kjo ndodh edhe në rastet kur të dy partnerët seksualë janë besimtarë fetarë, rezultati shfaqet sërish nga disa studime mbi adoleshentët e rinj dhe studentët e universitetit, të cilët janë pyetur të vlerësojnë se sa e rëndësishme është feja për ta, për vajzat feja vlerësohet më e

rëndësishme sesa për djemtë edhe në rastet kur si femrat dhe meshkujt kanë paraqitur shkallë të lartë të frymës fetare (Rosario et. al., 2006:19).

Brody dhe kolegët (1996) konstatuan se sa më *intensiv* të ishte një person rreth besimit të vet fetar, si për burrat edhe për gratë, aq më pak të ngjarë do të kishte që ata të përfshiheshin në marrëdhënie seksuale apo seks oral. Po këta kërkues zbuluan se për gratë fetare, gjithsesi, ato kishin më pak partnerë seksualë, kishin më pak gjasa për t'u përfshirë në sjellje masturbuese dhe shpeshtësi më të ulët për t'u përfshirë në sjellje të tilla (Brody et. al. , 1996:621).

Fryma fetare shoqërohet, gjithashtu, me përgjegjësi më të madhe seksuale edhe tek vajzat adoleshente, duke përfshirë një numër më të vogël partnerësh seksualë, perceptime më të zgjeruara të pasojave të mundshme të marrëdhënies seksuale të pambrojtur dhe ndjenja më të thella përgjegjësie dhe planifikimi për përdorimin e kontrollit të lindjeve (Miller & Gur, 2002:406). Për më tepër, Burdette, Ellison, Hill dhe Glenn (2009) konstatuan se gratë protestante të moshës së kolegjit kanë shumë më pak gjasa për t'u përfshirë në marrëdhënie seksuale rastësore, sesa gratë katolike dhe gratë që nuk mbështeteshin në një anëtarësim fetar (Burdette, Ellison, Hill & Glenn, 2009:543). Shumë komunitete myslimane e kanë më të theksuar ndasinë mes femrave dhe meshkujve, madje ata shkurajojnë përzierjen e lirë të gjinive. Femrat që jetojnë në vende me një përqindje të lartë myslimane mund të ndjekin qëndrime më konservatore seksuale sesa femrat e tjera myslimane. Përveç kësaj, normat kulturore joformale që kufizojnë ndërveprimin me seksin e kundërt mund të kufizojnë takimet me partnerët e mundshëm romantikë, dhe e bëjnë edhe më të thellë diferencën mes seksit paramartesor tek femrat myslimane krahasuar me ato jomyslimane (Adamczyk &

Hayesa, 2012:430). Edhe në dallimet gjinore në besimin fetar e më tej në sjelljen seksuale është e qartë që normat e komuniteteve apo grupeve të caktuara fetare paracaktojnë sjelljet më konservatore për femrat sesa për meshkujt, dhe sidomos në lidhje me marrëdhënien seksuale (Michaelides, 2011:309).

2. 5. NDIKIMI I MEDIAS NË SJELLJEN SEKSUALE TË STUDENTËVE

2. 5. 1. Media dhe impakti i saj në sjelljen seksuale të studentëve

Masmedia (*televizioni, interneti, revistat, librat. . . etj*), janë edukatorë të rëndësishëm mbi seksin dhe sjelljen seksuale. Megjithatë, mediat kanë qenë rrallëherë të shqetësuara për rezultatet e edukimit seksual që përçojnë në shoqëri. Zakonisht, ata që zotërojnë dhe krijojnë mediat e komunikimit kanë qenë më të shqetësuar për tërheqjen e audiencës dhe shitjen e produkteve të tyre sesa për promovimin e një seksualiteti dhe sjelljeje seksuale të shëndetshme dhe etike për shoqërinë. Shumica e tyre janë motivuar nga marzhet e fitimit dhe jo nga përgjegjshmëria shoqërore, kështu nëse audienca tërhiqet nga sjellja e papërgjegjshme dhe joetike seksuale (Brown & Keller , 2000:217), atëherë, bizneset përkatëse do të synojnë të prodhojnë këto programacione e sidomos në një shoqëri të tillë, në të cilën që prej rënies së komunizmit, media ashtu si çdo gjë tjetër në Shqipëri u liberalizua, ku natyrisht u shoqërua me anët pozitive dhe negative të saj për mbarë shoqërinë e sidomos për brezat e rinj. Në mungesë të një institucioni rregullues profesional dhe me eksperiencë për median dhe programacionin e tyre, për disa vite me radhë liria e mediatike u shndërrua në një botë virtuale të rrezikshme për edukimin e fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve shqiptarë. Imazhet seksuale dhe ato të dhunës shfaqeshin në çdo orë të ditës dhe dëmi psiko-social që po i shkaktohej një shoqërie të tërë, e cila ishte e etur për liri informimi po bëhej gjithnjë e më i madh (Zenelaj, 2014:93).

Statistika të ndryshme në Shqipëri të realizuara nga INSTAT, tregojnë se në çdo familje shqiptare ka një televizor dhe 62% prej tyre kanë një kompjuter me akses në internet. 62% e familjeve shqiptare preferojnë që kompjuterin ta mbajnë në dhomën e fëmijëve, e kjo

ndoshta sepse e konsiderojnë si një mjet ndihmues në realizimin e detyrave të lëna nga shkolla, dhe pjesa më e madhe e prindërve nuk kanë kontrollin e duhur mbi site-t të cilat vizitojnë çdo ditë fëmijët e tyre. Ndërkohë nga një studim tjetër i realizuar po nga INSTAT, rezulton se 44% e fëmijëve që kishin një kompjuter në dhomë pohuan se çdo ditë shohin materiale pornografike në site të ndryshme në internet. Vetëm në tregun mediatik shqiptar numërohen rreth 70 stacione televizive (ISHM dhe UNICEF, 2011:69), dhe në disa studime në nivel kombëtar rezulton se më shumë se gjysma e respondentëve rreth 1/3 kanë pohuar se e përdorin televizorin nga 1-3 orë në ditë, por këto instrumente të komunikimit mund të krijojnë një impakt jo të mirë të mënyrës sesi mendojnë të rinjtë sot si dhe të sistemit të tyre të vlerave (Lami, 2014:198).

Sipas një studimi të Lami (2014), nga 2072 të rinj të shkollave të mesme dhe profesionale, 2/3-tat e tyre ose 49, 7 %, kanë pohuar se informacionin mbi shëndetin riprodhues e marrin nga televizioni, duke vijuar më tej me internetin ku pohojnë të marrin informacion rreth 36% e të rinjve, nga gazetatat rinore 5. 1%, gazetatat në përgjithësi 2. 1%, nga librat 2, 4% e studentëve, broshurat dhe fletëpalosjet 2, 1% dhe nga radio 1. 9% e studentëve (Lami, 2014:199).

Në një prej studimeve të mia, të realizuara me studentë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, konkretisht të Fakultetit të Shkencave të Edukimit në janar 2014, rezultoi se nga 167 studentë të anketuar, rreth 72% e studentëve janë rezidentë në konvikte ose në shtëpi me qira, larg familjeve të tyre dhe 91% e tyre pohojnë se në ambientet e tyre ka televizor, ku 62% ndjekin kryesisht programacione të televizioneve publike shqiptare, 38 % kanë aparat digjitalb ose kabllor. Të pyetur rreth programacioneve që ndjekin më shumë pohuan

se; 34% janë ndjekës aktiv të programeve muzikore, videoklipeve të tyre. 32% janë ndjekës të rregullt të telenovelave, 12 ndjekës të programeve sociale, dhe 22% e tyre preferojnë filmat më shumë. Studentët gjithashtu u pyetën rreth kohës që shpenzojnë për të ndjekur programet e tyre të preferuara, dhe pohuan se; 16% e tyre shpenzojnë më pak se 2 orë në ditë, 2-4 orë në ditë 26% e studentëve të anketuar, 49 % e tyre shpenzojnë 4-orë në ditë, dhe 9% më shumë se 6 orë në ditë (Zenelaj, 2014:98).

Nga shumë studiues të tjerë është vënë re sesi tek fëmijët edhe tek të rriturit është konstatuar se besojnë që media është një burim qendror i informacionit mbi seksin dhe seksualitetin e tyre (Malamuth & Impett, 2001:293), edhe pse ka programacione të ndryshme që janë immune ndaj historive të natyrës seksuale si ato të lajmeve, debateve politike dhe sociale, etj, sërish një pjesë e mirë e programeve mund të ofrojnë lehtësisht informacione me impakt negativ në sjelljen seksuale të studentëve, ku në rastin e medias shqiptare këto janë të shumta. Telenovelat e shumta në televizionet shqiptare, videoklipet muzikore, filmat e ndryshëm apo edhe stacionet televizive me programacione të caktuara pornografike, janë të shumta në televizionet tona, nga ku studentët mund të modelojnë sjelljet e tyre në kushtet e një lirie prindërore dhe mediatike njëkohësisht. Ndërkohë, pak, për të mos thënë aspak, krahasuar me këto lloje programesh të përmendura më lart, zënë programet edukuese mbi sjelljen seksuale, sëmundjet seksualisht të transmetueshme apo për përdorimin e masave mbrojtëse për një akt seksual të sigurt dhe një shtatzani të planifikuar (Zenelaj, 2013:98).

Në disa vende si Kanadaja dhe Australia, në shkolla mësohet njohuria mbi mediat në të gjitha klasat dhe gjatë gjithë programit mësimor, në mënyrë që fëmijët të mësojnë sa më

herët që mediat janë ndërtuar për të përcjellë një grup të veçantë të vlerave, dhe në përgjithësi, ato janë projektuar për të shitur produktet e tyre (Brown & Keller, 2000:219), ndërkohë në shkollat shqiptare kjo nuk ndodh. Nga ana tjetër, roli i televizionit si një edukator seksual në kultura moderne, por dhe në ato më tradicionale, është plot me mesazhe kontradiktore për të rinjtë e këtij shekulli dhe as që bëhet fjalë që mesazhet seksuale të kenë përmbajtje etike (Eggermont, 2005:463). Aksesit i lirë në televizion dhe ekspliciteti u ofrojnë të rinjve të mësojnë mbi seksin pa asnjë siklet apo barrierë (Eggermont, 2005:463), edhe pse mesazhet televizive nuk janë domosdoshmërisht të qarta ato sërish japin informacione për të rinjtë që nuk mund t'i gjejnë në forma të tjera, apo që do të ishte shumë e sikletshme për ta të pyesnin (Ward & Rivadeneyra, 1999:241).

Sipas Mërkuri (2013), media elektronike dhe ajo e shkruar vazhdojnë të mbeten ndër burimet kryesore të informacionit seksual. Media e cila ka rezultuar më tepër informative për studentët shqiptarë, ka qenë interneti me 61.1 %, pasuar nga televizioni 60.6 %, dhe media e shkruar (gazetat, revistat, librat) me 46.4 % (Mërkuri, 2013:118).

Siç duket, mediat janë një mënyrë mjaft e thjeshtë që të rinjtë të marrin informacione në lidhje me seksin, të cilat për shumë burime literature konstatojnë se kanë një ndikim të dëmshëm në edukimin e të rinjve në mbarë botën. Warren, Gerke, dhe Kelly, (2002) kanë konstatuar se modelet prindërore të përfshirjes në ekspozimin televiziv të fëmijëve të tyre mund të jenë ndërmjetësues kryesorë të një shumëllojshmërie ndikimesh të mundshme negative të televizionit (Warren, Gerke, & Kelly, 2002:89). Mediat janë konstatuar të ndikojnë tek rezultate të tilla si shqetësimi social dhe mbi të gjitha tek sjellja joetike e një të riu (Somers & Tynan, 2006:2168; Holbert, Kwak, & Shah, 2003:543).

Ekspozimi ndaj përmbajtjes seksuale në televizion (për shembull zhanre ose programe specifike të orientuara seksualisht) shoqërohet edhe me pritshmëritë rreth seksit, perceptimet rreth sjelljes seksuale të bashkëmoshatarëve dhe qëndrimet liberale rreth seksit dhe sjelljes seksuale në tërësi (Bleakley et. al. , 2011:311; Collins, Elliot, & Miu, 2009:163). Provat shkencore të një numri të madh studimesh dhe autorësh si; Bleakley, Hennessy, Fishbein, & Jordan, 2008:448; Hennessy, Bleakley, Fishbein, & Jordan, 2009:588; L'Engle, Jackson, & Brown, 2006:99; Somers & Tynan, 2006:169, dhe shumë të tjerë që do të citohen edhe në vazhdim të këtij studimi, tregojnë se ekspozimi i pakontrolluar ndaj përmbajtjes seksuale në media shoqërohet me fillimin e hershëm të aktivitetit seksual ose përparim të aktivitetit seksual, përgjegjëshmëri gjatë aktit seksual, si dhe një sërë sjelljesh të tjera seksuale të dëmshme për partnerët (Shih: Bleakley, Hennessy, Fishbein, & Jordan, 2008:451; Hennessy, Bleakley, Fishbein, & Jordan, 2009:587; L'Engle, Jackson, & Brown, 2006:101; Somers & Tynan, 2006:169).

Sipas disa autorëve është argumentuar se ekziston një bazë e fuqishme teorike për të supozuar se përmbajtja seksuale në media formon besimet, qëndrimet, normat dhe synimet e të rinjve për të kryer marrëdhënie seksuale (Hennessy, Fishbein, & Jordan, 2008:589; Buhi & Goodson, 2007:13). Pohimi i efekteve të mundshme negative të mediave për të rinjtë ka prirjen të vërtetohet nga studimet kërkimore që i drejtohen lidhjes midis niveleve ose llojeve të veçanta të ekspozimit ndaj medias (manipulohen ose eksperimentalisht, ose në mënyrë natyrale) dhe rezultateve të tilla si besimet normative rreth aktivitetit seksual Chia & Gunther, 2006:67), shtrirjes dhe periudhës së marrëdhënieve seksuale (Aubrey, Harrison, Kramer, & Yellin, 2003:454), dhe një sërë sjelljeve të tjera seksuale,

përgjegjshmëria, ndërgjegjshmëria dhe respektimi i partnerit seksual (Somers & Tynan, 2006:170). Në studimin e saj në 1995-n, Arnett identifikoi pesë arsye të përdorimit parësor të medias seksuale nga adoleshentët dhe të rinjtë si: argëtimi, formimi i identitetit, emocione të forta, trajtimi i problemeve dhe identifikimi i kulturës rinore. Sipas Arnett, si mjet socializues, media ndryshon nga anëtarët e familjeve, shkollat, anëtarët e komunitetit dhe zbatimi i ligjit për shkak të faktit se kryesisht ajo nuk është një institucion edukues me baza të forta etike (Chapin , 2000:147; Arnett, 1995:528).

Gjithsesi, ka edhe shumë studime të realizuara në vende të ndryshme të botës ku ka mjaft të dhëna për impaktin e medias seksuale tek të rinjtë si p.sh.; në Europë $\frac{3}{4}$ -at e të anketuarve tek të rinjtë në një sondazh deklaruan se ata mësonin rreth sëmundjeve seksualisht të transmetueshme nga TV, librat ose revistat, çfarë lë të kuptohet se në këtë rajon ka programacione televizive dhe jo vetëm nga ato që ofrojnë edukim seksual për të rinjtë (Brown & Keller, 2000:213), ndërsa në SHBA vetëm $\frac{1}{4}$ deklaruan se e merrnin këtë informacion nga media (ASHA, 1996:34; Brown, Steele, & Walsh- Childers, 2001:187).

Në Indi, Afrikë dhe Amerikën Latine, telenovelat popullore që përfshinin skenarë rreth planifikimit familjar dhe parandalimit të HIV-it, sipas raporteve kanë shtuar vizitat klinike dhe kanë ndryshuar sjelljet shëndetësore (Shih: Katende, Bessinger, Gupta, Knight, & Lettenmaier, 2000:94; Rogers etj. , 1999:198; Singhal & Rogers, 1999:111; Vaughan & Rogers, 2000:221). Çfarë nuk duket e qartë në këtë studim është fakti nëse këto programe kanë ndërgjegjësuar popullsinë rreth shëndetit riprodhues dhe sëmundjeve të ndryshme seksualisht të trasmetueshme apo kanë shtuar sjelljen seksuale të rrezikshme dhe të

pambrojtur, çfarë për rrjedhojë ka bërë që të ketë më shumë vizita në klinika gjinekologjike?

Jo pak studime i kanë kushtuar një vëmendje të madhe imazheve seksuale që portretizohen sidomos në telenovela. Në Shqipëri bumi i telenovelave turke, indiane apo braziliane në thuajse çdo orë të ditës, madje në orët e pikut të shikueshmërisë, ofron mjaft skena të cilat përcjellin mesazhe seksuale sa kontradiktore aq edhe jo edukative për shoqërinë, duke bërë që edhe ky institucion të jetë larg tipareve që mund të ketë një institucion edukues (Perera, 2005:115).

2. 5. 2. Televizioni dhe impakti i tij në sjelljen seksuale

Përveç faktit që media mund të jetë një edukator i mirë i studentëve dhe të rinjve, ekspozimi ndaj medias me karakter seksual në televizion lidhet me qëndrime më liberale seksuale, pranim më të gjerë të çrregullimeve seksuale, pranim më të gjerë të seksit paramartesor, miratim më të fuqishëm të qëndrimeve argëtuese ndaj seksit, dhe pritshmëri më të larta të aktivitetit seksual tek bashkëmoshatarët (Ward & Rivadeneyra, 1999:240). Implikimi është se efektet mediatike, ndoshta të kombinuara me ekspozim paraprak ndaj medias me karakter seksual, rrisin mundësitë e ekspozimit ndaj pornografisë, duke marrë parasysh edhe faktin që televizioni në kohën e sotme është i aksesueshëm nga çdo njeri, duke ulur kështu, mundësinë për marrëdhënie seksuale të përgjegjshme dhe etike (Bryant & Bryant, 2015:421).

Të ekspozuarit ndaj medias me karakter seksual, e sidomos televizioni, mund të rrisin perceptimet e aktivitetit seksual tek bashkëmoshatarët, të cilat të kombinuara me përfitimet e perceptuara të seksit, të shpjeguara nëpërmjet reklamimit dhe presionit të bashkëmoshatarëve, zgjerojnë synimet për të bërë seks (Chapin, 2000:146). Brown dhe Newcomer (1991), konstatuan sesa më e madhe të ishte përqindja e kohës së shikimit të televizorit që përmban përmbajtje seksuale, më shumë gjasa ekzistonin që një student të përfshihej në marrëdhënie seksuale (Brown & Newcomer, 1991:77), madje Courtright dhe Baran në një studim të tyre në vitin 1980, konstatuan se të rinjtë që ndiqnin më gjatë programe televizive me përmbajtje seksuale prireshin për të mbajtur qëndrime më negative ndaj ruajtjes së virgjërisë, marrëdhënies seksuale me masa mbrojtëse, apo të bazuar mbi emocionin dhe dashurinë mes palëve (Courtright & Baran, 1980:109). Brown dhe Newcomer (1991) shqyrtuan lidhjen midis shikimit të televizorit dhe përvojës seksuale të adoleshentëve, konstatoi se ndjekja nga adoleshentët e programeve televizive të orientuara drejt seksit lidhej pozitivisht me aktivitetin e tyre seksual, në kuptimin që sa më shumë kohë të shpenzuar për të ndjekur programacione të tilla, aq më shumë marrëdhënie seksuale tek të rinjtë (Brown & Newcomer, 1991:79).

Presupozohet se të rinjtë që frekuentojnë kanale televizive pornografike mund të jenë në kërkim të formimit të identitetit seksual, duke lehtësuar aktivitetin e hershëm seksual (Bryant & Bryant, 2005:418), ose lehtësia e aksesit dhe sinqeriteti i përmbajtjes e bëjnë televizionin një burim tërheqës informacioni për përgjigjet e pyetjeve të njerëzve, për cilat ata nuk ndihen komodë të pyesin ndryshe (Greenberg, Linsangan, & Soderman, 1993:205). Kjo është veçanërisht tërheqëse për të rinjtë të cilët ndjehen sadopak në siklet për të folur

rreth seksit me prindërit apo kolegët e tyre (Baran, 1976:469; Courtright & Baran, 1980:111). Përdorimi i pornografisë në televizion dhe lidhja sociale mashkullore mund të kombinohen për të përforcuar konceptet e të parit të femrës si objekt seksual apo lodër seksi. Pornografia tek adoleshentët mund të jetë problematike, por natyrisht minimizimi i dëmit kërkon trajtimin e faktorëve kompleks dhe jo vetëm të impaktit të aksesit të pornografisë në televizor (Bryant & Bryant, 2005:417).

Në anën tjetër, disa autorë në analizën e tyre mbi impaktin e televizionit tek studentët kanë pohuar edhe se të rinjtë mund të marrin nga televizionet mesazhe jorealiste për seksin (Bersamin et. al. , 2010:161). Sjelljet seksuale paraqiten në një këndvështrim kryesisht të favorshëm, dhe rrallëherë shoqërohen duke u bazuar në rreziqet apo pasojat negative, të tilla si ato të shtatzënisë ose infeksionet seksualisht të transmetueshme (Shih: Baxter et. al. , 1985:338; Brown & Steele, 1995:87; Buerkel-Rothfuss, 1993:16; Fisher et. al. , 2004:532; Kunkel et. al., 2003:28; Lowry & Towles 1989:351). Në lidhje me kontekstin e marrëdhënieve, seksi në televizion ndodh 4-8 herë më shpesh tek personat e pamartuar sesa tek çiftet e martuara (Brown & Newcomer, 1991:78; Lowry & Shidler, 1993:630). Gjithashtu, ekspozimi i shpeshtë ndaj përmbajtjes seksuale në televizion lidhet me rolet gjinore më tradicionale (Brown & Bobkowski, 2011:97; Herrett- Skjellum & Allen, 1996:163), besimet jofunksionale rreth marrëdhënieve si psh; fati i bashkon shpirtrat binjakë, mosmarrëveshja është shkatërrimtare për një marrëdhënie, partnerët duhet të jenë të aftë të kuptojnë mendimet dhe ndjenjat e njëri-tjetrit (Holmes, 2007:105), dhe mbështetjen e stereotipave të marrëdhënieve seksuale si psh; marrëdhëniet seksuale janë

argëtuese, burrat drejtohen nga nevojat seksuale, dhe gratë janë objekte seksuale (Ward, 2002:9; Ward & Friedman, 2006:139).

Edhe përmbajtja seksuale në filma shpesh i trajton gratë si objekte seksuale, mbështet standardin e dyfishtë seksual dhe reklamon seksin pa përfshirje marrëdhëniesh ose seksin jashtë martese, ndërsa i kushton vëmendje minimale seksit të çifteve të martuara ose planifikimit seksual. Mesazhet rezultuese janë shpesh mjaft kontradiktore, veçanërisht për gratë e reja që nxiten të jenë seksualisht tërheqëse, megjithatë jo aq seksualisht aktive dhe informohen se *“të gjithë e bëjnë këtë”*, por duhet të kenë kujdes rreth *“nxjerrjes së namit”* dhe rreziqeve të shtatzanisë (Perera, 2005:112; Ward, 2003:381). Kështu u pa se, televizori dhe filmat mund të jenë veçanërisht burime bindëse informacioni rreth romancës pasi përmbajtja seksuale dhe romantike është e aksesueshme, më e qartë dhe më pak gjykuese sesa mjete të tjera të socializimit seksual si për shembull prindërit, mësuesit dhe liderët fetarë (Ward, 2003:387), dhe sipas Howard (1985) televizioni dhe muzika pop si dy burimet më të mëdha të presionit mediatik për të rinjtë, nxisin këtë grupmoshë për t’u përfshirë në aktivitetet seksuale të parakohshme e njëkohësisht të papërgjegjshme (Ward, 2003:387; Howard, 1985:273).

Analiza të autorëve të tjerë zbuluan se ekspozimi më i shpeshtë ndaj teksteve muzikore seksualisht degraduese parashikonte gjithashtu kalim më të hershëm tek marrëdhënia seksuale (Perera, 2005:112). Që në fillim të rok & rollit në vitet ‘50, ka pasur dyshime se dëgjimi i muzikës do të çonte në performancë seksuale. Kjo lloj muzike është kritikuar gjithmonë për përmbajtje të mesazheve seksualisht provokuese (Brown & Hendee, 1989:1661), dhe për pasjen e një elementi seksual (Jones, 1991:78). Por sot me

modernizmin e teknologjisë, përveç teksteve muzikore me përmbajtje seksuale që janë evidente, edhe videoklipet muzikore kanë një qasje të madhe drejt përçimit të mesazheve seksuale. Në mbarë botën videoklipet muzikore vazhdimisht përçojnë mesazhe të tilla, ndërkohë në Shqipëri duken edhe më vulgare (Perera, 2005:113).

2. 5. 3. Impakti i internetit dhe medias së shkruar në sjelljen seksuale

Interneti konsiderohet si një burim tjetër informacioni rreth seksualitetit. Fjala seks është termi më popullor i kërkuar në internet (Cyberatlas, 2001:27). Një studim i kryer me anë të një sondazhi online të përdoruesve të internetit, tregoi se kërkimet seksuale, duke variuar nga hyrja në faqe interneti me tema seksuale tek ndërveprimet intensive seksuale online, mund të jetë përdorimi më i përhapur në internet (Cooper, Scherer, Boies, & Gordon, 1999: 158.). Përdoruesit e internetit tashmë kalojnë kufijtë ligjorë dhe fizikë që më parë e pengonin aksesin e tyre në materiale dhe informacion seksual (Durkin, 1997:59; Thomas, 1997:62). Natyrisht që interneti mund të ketë ndikime pozitive edhe tek shëndeti seksual (Brown, 2002:45). Ka shumë faqe interneti që i dedikohen nxitjes së sjelljeve pozitive seksuale. Faqe si për shembull, *American Social Health Association's - Iwannaknow.org*, nxisin sjelljen e shëndetshme seksuale dhe i ofrojnë të rinjve këshilla rreth marrëdhënieve dhe mbrojtje kundër sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (Brown, 2002:43).

Edhe në Shqipëri, mjafton që për pak minuta të ulesh në një qendër interneti kudo dhe në historikun e kërkimeve të ditës do të shohësh që ka një mori site-sh me tematikë seksuale që janë vizituar nga personat që mund të kenë frekuentuar një qendër interneti brenda një

dite, grupmosha e të cilëve fillon nga fëmijët deri tek të rriturit. Në një prej studimeve të mia të kryera rreth ndikimit të internetit në sjelljen seksuale të studentëve, rezultoi se; 70% e siteve të qendrave të internetit afër disa fakultete në Tiranë, në rreth 212 kompjutera të vëzhguar, rreth 65 % rezultuan të kenë si historik të kërkimit kryesisht tematika seksuale, video pornografike, rreth 35% me lojra dhe pjesa e mbetur filma ose faqe të ndryshme me tematika shkollore (Zenelaj, 2013:98).

Natyrisht që interneti mund të ketë ndikime pozitive dhe negative për sjelljen seksuale. Por siç vërejtën Barak, etj (1999), natyra ndërvepruese e internetit mund të krijojë një "ndjenjë përkatësie" dhe "potencialisht të gjitha efektet negative të pornografisë si një nga programet më të shikuara" (Barak et. al. , 1999:154) , që natyrisht do të shoqërohet me probleme në sjelljen e studentëve apo frekuentuesve të internetit. Në një kërkim të kryer në Tajvan nxori përfundimin se ekspozimi ndaj pornografisë në media elektronike ishte parashikuesi më i fuqishëm i sjelljes seksuale tolerante të adoleshentëve dhe të rinjve (Lo et. al. , 1999:59).

Nga studiues të tjerë pohohet se interneti ka aftësinë për të ndikuar tek rolet e socializimit dhe marrëdhënieve të adoleshentëve dhe të rinjve (Pritchard, 2008:89; Bryant & Bryant, 2005:419). Rolet gjinore, qëndrimet dhe sjelljet seksuale janë në një fazë kritike zhvillimi dhe në këtë mënyrë interneti ofron një mjet për kërkimin e emocioneve në linjat chat, lojëra ndërvepruese dhe shikimi i materialeve seksualisht eksplicite që mund të kenë ndikim tek sjellja seksuale (Pritchard, 2008:90; Weisskirch & Murphy, 2004:26).

Një grup kërkuesish theksoi se përdorimi specifikisht i internetit që lidhet me seksualitetin është patologjik. Këto studime pohuan se individët do të ishin të aftë të përfshihen në

fantazi seksuale dhe biseda provokuese seksuale që mund të varionin nga flirte të thjeshta në komunikim të hapur me fjalë të ndyra (Hollander, 2002:365). Këta kërkues mendonin se interneti do të ishte një terren për aktivitete seksuale të paligjshme, duke përfshirë pornografinë e fëmijëve dhe pedofilinë (Cooper, Scherer, Boies, & Gordon, 1999:160). Ka studiues të tjerë që pohojnë se përdorimi i internetit për qëllime përshtatëse seksuale ka krijuar një mundësi “për të normalizuar dëshirën seksuale” për të krijuar një rrugë tjetër të ndarjes së informacionit rreth seksualitetit dhe intimitetit që është e pavlefshme pa attribute fizike (Cooper et. al. , 1999:162).

Edhe revistat janë një tjetër formë popullore e masmediave që kanë shpesh përmbajtje seksuale. Gjithashtu, filmat, lojërat video, muzika dhe interneti, përmbajnë disa lloje të përmbajtjes seksuale. Përveç kësaj, njerëzit kanë më shumë zgjedhje të veçanta në përmbajtjen që shohin kur bashkëveprojnë me këto forma të mediave (Hackbarth, 2006:39). Më shumë se gjysma e djemve dhe vajzave të shkollave të mesme në një sondazh kombëtar në vitin 1997 të realizuar thanë se kishin mësuar për kontrollin e lindjes, kontracepsionin ose parandalimin e shtatëzanisë nga televizioni; pothuajse dy të tretat (63%) e vajzave (dhe 40% e djemve) thanë se kishin mësuar për këto tema nga revista (Brown, 2002:47; Sutton, Brown, Wilson, & Klein, 2002:52).

Gjithsesi, është e qartë dhe e pritshme që adoleshentët dhe të rinjtë mund të përdorin median si burim informacioni në lidhje me aktivitetin dhe sjelljen seksuale. Veçanërisht personat pa përvojë seksuale mund të përdorin median për të plotësuar boshllëqet në perceptimin e tyre rreth mënyrës sesi një skenar seksual i caktuar mund të funksionojë ,

p.sh.: puthja e natës së mirë në fund të një takimi, kryerja e seksit me shumë partnerë, etj, (Perera, 2005:98; Brown, 2002:44).

2. 5. 4. Dallimet gjinore në sjelljen seksuale të modeluar nga media

Mosha e ekspozimit të parë në median me përmbajtjen seksuale është përgjithësisht më e ulët tek djemtë sesa tek vajzat. Të dhëna të disponueshme tregojnë se shumë fëmijë më të vegjël se 16 vjeç ishin të ekspozuar ndaj pornografisë përpara përhapjes së internetit (McKee, Albury & Lumley, 2008:87). Për më tepër, megjithëse interneti mbetet problem parësor për prindërit dhe kërkohet vigjilencë, ky mjet mediatik nuk është domosdoshmërisht mënyra e parë ose e preferuar e ekspozimit tek adoleshentët më të rinj dhe mjeti i preferuar pornografik potencialisht ndryshon me moshën. Ybarra dhe Mitchell (2005), konstatuan se përhapja e ekspozimit të qëllimshëm ndaj internetit rritej me moshën, nga 8% tek 10-13-vjeçarët në 20% tek 14-17-vjeçarët, me fëmijë më të vegjël që preferojnë media më tradicionale, si për shembull revistat dhe videot. Megjithëse, ekziston një nevojë për të identifikuar natyrën dhe rreziqet e ekspozimit të parapubertetit, problemet etike për mirëqenien e fëmijës kryesisht e pengojnë këtë kërkim (Ybarra & Mitchell, 2005:476).

Gjithsesi, meshkujt raportojnë qëndrime më pozitive ndaj pornografisë nga një moshë më e hershme sesa femrat (Carroll et. al. , 2008:139; Wallmyr & Welin, 2006:293). Në të kundërt, femrat e reja në moshë zakonisht kanë qëndrime mjaft negative ndaj pornografisë, por qëndrime shumë më pozitive lindin me rritjen e moshës. Mbi moshën 20-vjeçare si meshkujt edhe femrat mund të raportojnë qëndrime në mënyrë të ngjashme pozitive

(Carroll et, al. , 2008:140). Niveli i ndryshimeve mbi baza gjinore në pranimin e pornografisë mund të cenohet nga kultura. Ndryshimet gjinore në pranimin e pornografisë, arsyet për përdorimin e saj dhe roli i saj në proceset e socializimit seksual tregohen në ndryshimet gjinore në rrugët dhe kontekstet sociale të ekspozimit. U raportua përdorim, qoftë vetëm apo dhe në grup më shpesh nga meshkujt sesa nga femrat, për shkak të rëndësisë së tij (për meshkujt) për masturbimin dhe (për femrat) për socializimin seksual (Wallmyr & Welin 2006:298). Në raport me nivelet e larta të ekspozimit të qëllimshëm ndaj internetit ndodh që meshkujt në moshë të re përdorin internetin në shtëpinë e një shoku (Wolak, Mitchell & Finkelhor, 2007:226). Ndërsa përdorimi i pornografisë nga femrat përqendrohet më tepër tek marrëdhënia, ato kanë më shumë të ngjarë të shohin pornografi me partnerin e tyre sesa me shoqet (Wallmyr & Welin, 2006:300).

Pritej që femrat që shihnin programe televizive seksuale të zhvillonin më herët akte seksuale në një marrëdhënie. Përveç kësaj, studiuesit arritën në konkluzionin se meshkujt që shihnin më shumë programe televizive seksuale ishin më të prirur për një shumëllojshmëri më të madhe të akteve seksuale edhe pas kontrollit të statusit të marrëdhënieve, një kohëzgjatje më të gjatë të marrëdhënies, kohës së shoqërimit me partnerin, dhe kënaqësisë së marrëdhënies. Përveç kësaj, shikimi i televizionit për të mësuar në lidhje me botën vlerësohet të jetë i lidhur me qëndrimet më argëtuese rreth seksit (Ward & Rivadeneyra, 1999:239).

Studiuesit kanë arritur në përfundimin se femrat, veçanërisht ato të reja, shpesh përdorin revistat për informacion në lidhje me temat me të cilat nuk ndihen komode për t'i diskutuar me miqtë, familjen apo profesionistët e fushës mjekësore (Treise & Gotthoffer, 2002:56).

Gratë që shpesh lexojnë revista të dedikuara për adoleshentët kishin më shumë gjasa për të zgjedhur një rol më të nënshtruar të seksit femër. Studiuesit konkluduan gjithashtu se sa më shpesh gratë të lexojnë revistat, aq më shumë ka të ngjarë që ato të ndjekin pikëpamjet mbi rolet e seksit të diskutuara më lart (Kim & Ward, 2004:59).

Kërkime të mëparshme kanë treguar se ndikimet e përmbajtjes seksuale mediatike ndaj qëndrimeve seksuale të shikuesve janë shpesh më të fuqishme dhe më të qëndrueshme tek femrat sesa tek meshkujt (Shih: Strouse & Buerkel-Rothfuss, 1987:123; Strouse, Buerkel-Rothfuss, & Long, 1995:18; Ward & Rivadeneyra, 1999:240; Ward, 2002:15). Disa kërkues kanë argumentuar se ndoshta burrat kanë më shumë gjasë sesa gratë që të miratojnë qëndrimet seksuale zakonisht të shqyrtuara në kërkimet mediatike. Rrjedhimisht, një efekt tavan mund të kufizojë fuqinë parashikuese të ekspozimit ndaj medias për burrat (Shih: Oliver & Hyde, 1993:41; Ward, 2002:11). Si rezultat, gratë që kanë ekspozim të shpeshtë ndaj përmbajtjes seksuale në media do të kishin më shumë gjasa sesa burrat për të modeluar sjelljen e mësuar nëpërmjet medias. Me fjalë të tjera, gjinia (feminiteti) do të funksiononte si stimul motivues për të modeluar ndërmarrjen e rrezikut seksual nëpërmjet medias (Zhang, 2012:187). Ka edhe autorë të tjerë që kanë pohuar si rezultat i studimeve të tyre se kanë konstatuar se shikimi i televizionit lidhet pozitivisht me aktivitetin seksual të vajzave adoleshente. Gjithsesi, shumë studiues pohojnë se sjellja seksuale e femrave dhe meshkujve nuk përbën dallime të thella, natyrisht pjesa më e madhe e këtyre dallimeve ka të bëjë me fiziologjinë, biologjinë apo moshën e të rinjve që sipas gjinisë ka një start të ndryshëm për interes seksual (Pritchard, 2008:99).

KAPITULLI III: METODOLOGJIA KËRKIMORE

3. 1. Popullata për studim dhe procedurat e kampionimit

Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në 15 universitete publike në vend ndjekin studimet 106. 152 në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në sistemin me kohë të plotë, për vitin akademik 2013-2014. Ndërkohë, që në 43 universitete private në vend ndjekin studimet e larta në ciklin e parë dhe të dytë, 33. 129 studentë. Në total popullata për studim është 139. 281 studentë që ndjekin studimet në të gjitha universitetet shqiptare në vitin akademik 2013-2014.

Në studim morën pjesë 1313 studentë, ku 1213 studentë morën pjesë në anketime dhe 100 të tjerë në intervistat ballë për ballë të regjistruara me diktofon. Numri i kampionit për studim u përcaktua mbështetur në punën e disa autorëve, ku sipas Hair, etj (2006),

“madhësia minimale e kampionit të studimit duhet që të jetë të paktën pesë herë më e madhe sesa numri i variabëlve të përdorur në instrumentin matës, ndërkohë që një madhësi optimale dhe e pranueshme për çdo studim do të ishte raporti 10/1, pra numri i të anketuarve të jetë 10 herë më i madh sesa variabëlët e studimit.” (Hair et.al., 2006:88).

Ndërkohë që sipas, Bartlett, Kotrlik dhe Higgins (2001), madhësia e kampionit kërkohet të jetë 5-10 herë më shumë sesa variabëlët e pavarur të studimit (Bartlett, Kotrlik & Higgins, 2001:154). Hoelter ka një version tjetër, ku sipas tij numri i anketave varet nga analizimi dhe modeli i analizës që do të përdoret në një studim, dhe sipas tij për të realizuar një analizim të dhënash sipas metodës sasiore të studimit duhet që të mbledhim 100-200 përgjigje për çdo variabël, pra rreth 100-200 anketa. Duke marrë në konsideratë të gjithë autorët më lart u pa e nevojshme që kampioni për studim të jetë mbi 1000 të anketuar, për

të bërë të mundur një analizë të regresionit linear të shumëfishtë, objektiv i cili u përmbush me 1213 anketa të përfunduara në të gjitha universitetet shqiptare.

- *Kampionimi i rastësishëm dhe me shtresëzim*

Për të pasur një ndarje të drejtë të kampionit për studim, u përdorën procedurat e kampionit të rastësishëm dhe me shtresëzim në rastin e anketimeve, ku në çdo universitet u përdor formula e shtresëzimit për të përfaqësuar në mënyrë të drejtë të gjithë fakultetet e universiteteve publike dhe private. Kështu, numri i anketave që do të realizoheshin, ku u mor për bazë numri i 1200 anketimeve u pjesëtu me numrin total të popullatës, që është 139. 281, nga ku del koeficienti 0. 0086, që do të thotë se pjesë e studimit do të jenë 0. 86% e popullatës. Kjo përqindje u shumëzua më tej me numrin total të studentëve të çdo universiteti për të përfutur numrin e anketave që do të realizoheshin mbështetur në numrin e studentëve në çdo universitet. P.sh; për Universitetin e Tiranës: $1200 / 139. 281 = 0. 0086 \times 35. 602 = 306$ anketime për tu realizuar. Sërish për të përcaktuar numrin e anketave për çdo fakultet të Universitetit të Tiranës u përdor e njëjta formulë shtresëzimi, p.sh: koeficienti 0. 0086 x me numrin total të studentëve të Fakultetit të Shkencave Sociale UT që është 16. 237 = 139 anketa vetëm në fakultetin e shkencave sociale. Më tej, të njëjtën formë u bë shtresëzimi për ciklet e studimit të parë dhe të dytë derisa përfitohej numri i saktë për çdo fakultet dhe çdo cikël studimesh në të gjitha universitetet e vendit.

Por, për të pasur një kampion sa më përfaqësues të popullatës për studim, nevojitej edhe përcaktimi i formës së pjesëmarrjes për çdo rast, ku u paracaktua që pjesë e studimit do të

ishin 1/5 studentë në listën rendore në regjistrat e çdo salle apo viti akademik ku u kërkua pjesëmarrja e studentëve për anketim.

Në studim u përfshinë studentë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, meshkuj dhe femra të universiteteve publike dhe private. Kryesisht u përzgjedhën sallat e seminareve sepse pjesëmarrja e studentëve u pa të jetë më e madhe në seminare sesa në лекsione, ku me regjistrat zgjidheshin 1/5 studentë për të marrë pjesë në studim, të cilët veçoheshin në një sallë tjetër ku realizohej edhe shpërndarja e anketave, shpjegimi i pyetësorit si dhe qëllimi, objektivat e studimit dhe çështjet etike të studimit. Në rastet kur studenti në radhë sipas listës emërore nuk ishte i pranishëm, apo refuzonte anketimin atëherë procedohej në listë me një emër më poshtë.

Duhet theksuar se në këtë studim nuk janë përdorur teknika të shpërblimit të të anketuarve, pjesëmarrja e tyre ishte vullnetare dhe shpërblimi i vetëm ishte çlirimi nga detyrimet e seminarit për orën gjatë të cilës studenti tërhiqet nga seminari për të plotësuar anketën.

Gjithashtu, duhet të theksoj se në të gjitha universitetet e vendit është kontaktuar me të paktën një pedagog të brendshëm apo shef departamenti, i cili ka asistuar më tej në gjetjen e sallave, vënien në dispozicion të orareve për çdo cikël studimi si dhe për lejen nga pedagogët e çdo salle të cilëve iu kërkua pjesëmarrja e studentëve të tyre.

Duke marrë në konsideratë faktin që studentët që ndjekin studimet në master, kryesisht kanë oraret e лекsioneve dhe seminareve në mes të javës dhe në vazhdim, u zgjedhën ditët e mërkurë, e enjte, e premte dhe e shtunë për të realizuar anketat në të gjithë universitetet dhe për çdo cikël studimi.

Janë përjashtuar nga studimi vetëm fakultetet, në të cilat unë personalisht kam qenë aktive në mësimdhënie, si Fakulteti i Shkencave të Edukimit Elbasan dhe grupi i studentëve të vitit të tretë në Sociologji-Antropologji në UET. Gjatë testit të provës u vu re që studentët të cilët kanë marrë leksione apo seminare nga unë, e patën të pamundur që të përfshihen me dëshirë dhe vullnet të plotë, kjo ishte shumë më e theksuar në rastin e intervistave ballë për ballë sesa për anketat, por gjithsesi edhe në rastin e anketimeve u vu re se studentët e mi kryesisht ndërprisnin intervistimin, pozicioni dhe marrëdhënia me ta nuk e lejonte një përfshirje objektive dhe të sinqertë prej tyre. Duke marrë në konsideratë sa më lart, si dhe ndikimin e autoritetit si lektore, e tematikën delikate që trajton studimi, këta studentë nuk u përfshinë në anketim dhe intervistim.

- Kampionimi joprobabilistik me kuota

Sipas karakteristikave të metodologjisë cilësore, u përzgjedh si procedurë për përcaktimin e kriterëve të kampionimit, kampioni joprobabilistik me kuota për të bërë të mundur shtresëzimin e popullatës në mënyrë që të garantohet përfshirja e grupeve dhe karakteristikave të popullatës në përpjesëtim të drejtë me statistikat ekzistuese të popullatës, pa pasur nevojën e përdorjes së të gjithë listës ekzistuese të popullatës për studim (Matthews dhe Ross, 2010:284). Duke marrë në konsideratë se për popullatën në studim ekzistojnë të dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Sportit mbi numrin total të popullatës, raportin mes femrave dhe meshkujve, raportin mes cikleve të studimeve, si dhe raportin e numri të studentëve që ndjekin studimet në universitete private dhe publike, u përcaktuan

kuotat mbi karakteristikat më poshtë në mënyrë që të garantohet përfaqësia e çdo karakteristike, si:

1. Në kampion u përfshin të dyja gjinitë sipas raportit total të studentëve meshkuj dhe femra që ndjekin studimet e larta në Shqipëri. Raport i cili rezulton afërsisht **1:1**
2. U përfshin studentë nga të dyja ciklet e studimeve, cikli i parë i studimeve dhe cikli i dytë i studimeve të larta, ku sipas statistikave rezulton që raporti i numrit të studentëve që ndjekin ciklin e parë të studimeve me ato që ndjekin ciklin e dytë është afërsisht **3:1**.
3. U përfshin në intervistat ballë për ballë, studentë të universiteteve publike dhe private në të gjithë vendin, ku sipas statistikave raporti është afërsisht **4:1**.
4. Një karakteristikë tjetër ishte edhe përfaqësimi i studentëve nga të gjitha universitetet në vend, brenda dhe jashtë Tirane, natyrisht mbështetur në raportin statistikor të numrit të studentëve që është afërsisht **2:1**.
5. U përcaktua kuota 100 intervista ballë për ballë me tendencën që kjo shifër do të arrij të plotësojë karakteristikat e paracaktuara për kampionin studimor. Kuota prej 100 intervistash u përpjesëtua në mënyrë të drejtë sipas karakteristikave të mësipërme për të pasur një mostër sa më të ngjashme me karakteristikat e popullatës së tërë, duke garantuar përfaqësueshmërinë e të dhënave që u përftuan nga intervistat, sipas kriterëve të kampionit me kuota joprobabilitar.

Për shembull, sipas karakteristikave të mësipërme, u përcaktua që në 100 intervista do të realizohen, 50 me meshkuj dhe 50 me femra, ndërkohë që për sa i përket raportit të studentëve në ciklin e parë me ata në ciklin e dytë nga 100 intervista në total u përllogaritën

që 75 studentë në ciklin e parë dhe 25 në ciklin e dytë. Ndërkohë raporti 4:1 për studentët në universitete publike dhe private, përcaktoi 80 intervista me studentët që ndjekin studimet në shtetet dhe 20 intervista me ata që ndjekin studimet në universitete private. Gjithashtu, raporti i studentëve që ndjekin studimet në universitete të lokalizuara në Tiranë me ata që lokalizohen në rrethe është afërsisht 2:1, që sipas përlllogaritjeve u intervistuan 63 studentë në Tiranë dhe 37 të tjerët në universitetet në rrethet e Shqipërisë.

Procedura për përzgjedhjen e çdo rasti, bazohej në karakteristikat e kampionit joprobabilitar, që nuk paracakton rastësinë apo përcaktimin e studentit pjesëmarrës për studim bazuar në lista emërore, për rrjedhojë, përzgjedhja e çdo rasti mbështetjeje në plotësimin e karakteristikave të mësipërme dhe në vullnetin e tyre të lirë për të marrë pjesë ose jo në intervistim.

3. 2. Instrumentet matës

Sipas metodologjisë së triangulacionit, instrumentet matës të përdorur në këtë studim ishin dy, anketat me pyetje të strukturuar dhe të standardizuara, ku u përdor i njëjti grup pyetjesh për të gjithë të anketuarit. Pyetjet u drejtuan në të njëjtën mënyrë për të gjithë kampionin, si dhe janë përdorur i njëjti grup përgjigjesh për të gjithë të anketuarit, pjesë e studimit.

Ndërkohë për intervistat ballë për ballë me pyetje të hapura dhe gjysmë të strukturuar (*të karakterizuara edhe si jo të standardizuara*), u përdorën të njëjtat pyetje të hapura për çdo të intervistuar, por të renditura sipas karakteristikave të çdo studenti pjesëmarrës në intervistë, duke i lejuar të gjithë pjesëmarrësit që të përgjigjen dhe të diskutojnë sipas

mënyrës së tyre, duke përdorur fjalë sipas botëkuptimit të tyre mbi tematikën e kërkuar për diskutim.

Për të dy instrumentet matës të përdorur në këtë studim janë përdorur të paktën dy teste pilot me kampionin e paracaktuar, për të testuar formulimin e pyetjeve dhe përgjigjeve, për të kuptuar nëse janë të qarta termet e përdorur në çdo pyetje, për të vlerësuar se si reagojnë studentët pjesë e kampionit ndaj pyetjeve të ngritura, për testuar më tej procedurën e përzgjedhur për analizimin e të dhënave pilot, si dhe për të testuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e instrumenteve matës.

Koha në të cilën janë realizuar anketat dhe intervistat ballë për ballë, ka zgjatur në rreth 6 muaj, duke filluar nga nëntor 2013 - maj 2014, ku muaji gjatë pushimeve të fundvitit dhe në muajin shkurt u ndërpre intervistimi dhe anketimi si shkak i pushimeve dimërore dhe periudhës së sezonit të provimeve. Pra, mbledhja e të dhënave u realizua gjatë muajit nëntor, dhjetor 2013 dhe janar, mars, prill, maj 2014.

Kohëzgjatja e një ankete varionte nga 20-30 minuta, në varësi të studentëve dhe karakteristikave të tyre, ndërkohë që një intervistë ballë për ballë ka zgjatur mesatarisht deri në 40 minuta.

Nga 1341 studentë të kontaktuar për të mbledhur të dhënat nëpërmjet anketave, 87 studentë refuzuan të bëhen pjesë e studimit që në momentin e parë që iu fol për tematikën e studimit, dhe 51 studentë kanë ndërprerë pyetësin në seksionin e dytë ose të tretë, kryesisht për efekt kohe ose mungesë interesi ndaj studimit. Ndërkohë në 147 studentë të kontaktuar për mbledhjen e të dhënave nëpërmjet intervistës ballë për ballë, 39 studentë nuk pranuan të

bëhen pjesë e studimit, pasi mësuan tematikën që do të diskutohet dhe vetëm 8 kanë ndërprerë intervistimin mesatarisht 15-20 minutat e para të intervistës, ku 7 prej tyre ishin femra dhe 1 mashkull, e në këtë rast janë që të gjithë studentë në universitete të lokalizuara në rrethe. Në të dyja rastet, qoftë me intervistat apo edhe anketimet përmbushet kriteri i autorëve më lart për një madhësi kampioni optimale të pranueshme, e përfaqësuese për popullatën e studimit.

- *Struktura e pyetësorit*

Pjesë e rëndësishme në formatin e pyetësorit ishte aktmarrëveshja me çdo student që vullnetarisht mori pjesë në studim, pjesë në të cilën u deklarua qëllimi i studimit, objektivat, numri i studentëve që do të marrin pjesë nëpërmjet plotësimit të pyetësorit. Gjithashtu me rëndësi ishin kushtet e kofidencialitetit dhe pamundësia për të identifikuar çdo rast, sepse nuk kërkohet asnjë e dhënë personale si emër apo mbiemër. Natyra e analizës së të dhënave si dhe u vu në dispozicion një adresë email-i nëpërmjet së cilës pjesëmarrësit në studim mund të informoheshin mbi rezultatet e studimit.

Pyetësori është i ndarë në disa seksione, ndarje e cila bëhet për lehtësi në analizimin e të dhënave dhe identifikimin e variabëlve kryesorë të studimit. Në seksionin e parë, u drejtuan pyetje me karakter demografik si mosha, gjinia, cikli i studimeve, universiteti, preferenca seksuale, apo mosha e marrëdhënies së parë seksuale, etj.

Në seksionin e dytë, janë ndërtuar pyetje që synojnë të mbledhin informacion mbi sjelljen seksuale dhe etikën e studentëve shqiptarë. Në pjesën e dytë të pyetësorit qëllimi ishte mbledhja e të dhënave mbi impaktin që kanë institucionet sociale në vend si familja, arsimi,

bashkëmoshatarët, feja dhe media në sjelljen seksuale etike të studentëve. Për rrjedhojë, seksionet në vazhdim u ndanë si në vijim; seksioni i tretë përmbante pyetje mbi rolin e familjes në sjelljen seksuale të studentëve, seksioni i katërt mbi rolin e bashkëmoshatarëve në sjelljen seksuale, seksioni i pestë mbi rolin e arsimit në sjelljen seksuale të të rinjve, seksioni i gjashtë mbi rolin e fesë në sjelljen seksuale të studentëve dhe seksioni i fundit përmbante pyetje mbi rolin e medias në modelimin e sjelljes seksuale të studentëve shqiptarë.

Pyetësi ka lloje të ndryshme përgjigjesh në varësi të pyetjeve dhe seksioneve përkatëse, ku kryesisht në seksionin e parë ka pyetje që kanë përgjigje që ndahen në kategori, si cikli i studimeve të larta që ndjek çdo student, ka pyetje me përgjigje të zgjedhura nga një listë e mundshme që mund të jenë *po/jo/nuk e di*, apo me alternativa të tjera. Ka pyetje të cilat kërkojnë që përgjigja të jepet nga i intervistuari në formën e një shënimi, për të dalluar se cila është përgjigja më e rëndësishme për të intervistuarin, si p.sh. rasti i lëndës prej së cilës e marrin edukimin seksual në shkollën 9-vjeçare dhe në atë të mesme. Gjithashtu, në instrumentin matës ka pyetje të cilat kanë grup përgjigjesh të kompletuara, çfarë nënkupton se përgjigjet mbulojnë të gjitha opsionet e mundshme. Lloje të tjera përgjigjesh për pyetjet e instrumentit matës janë ato reciprokisht përjashtuese, siç është rasti i pyetjes mbi statusin e çdo studenti, ku çdo rast përjashton tjetrin, si beqar, i martuar, i divorcuar, i ve, etj.

Në seksionin e dytë dhe në vazhdim, pyetjet në pjesën dërrmuese kanë përgjigje në shkallën Likert, e cila përdoret veçanërisht si një mjet për të studiuar qëndrimet dhe opinionet e rasteve për studim. Kategoritë e përgjigjeve shtrihen ndërmjet dy pozicioneve ekstreme të ndara në 5 pika që i korrespondojnë një shkalle verbale-numerike, horizontale.

Duke marrë në konsideratë faktin që ky studim ka si qëllim të studiojë sjelljen seksuale, etikën e sjelljes seksuale, dhe impaktin e 5 institucioneve sociale si familja, arsimi, shkolla, bashkëmoshatarët, feja dhe media natyrisht që numri i pyetjeve do të ishte relativisht i madh për të garantuar sa më shumë të dhëna mbështetur në qëllimin e studimit.

Përpos variabëlve të pavarur dhe varur në pyetësorë janë përdorur edhe variabëlët ndërhyrës dhe kontrollues, variabëlët dikotomikë, variabëlët raporti si dhe variabëlët rendorë. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë njëtrajtësinë e instrumentit matës, ku pyetjet janë të ngjashme në çdo seksion, si dhe gjatësinë e tij, është përdorur metoda e rrotacionit të pyetjeve, ku ka pasur 10 variante të pyetësorëve, në të cilët seksionet dhe renditja e pyetjeve janë të ndryshëm nga një i intervistuar tek një tjetër, kjo për të siguruar të njëjtën vëmendje për të gjitha seksionet dhe grup-pyetjet e drejtuara për çdo të intervistuar.

- Struktura e intervistës

Edhe në rastin e instrumentit matës cilësor, në fillim të intervistës u lexua akt-marrëveshja, e cila bën të ditur natyrën e studimit, qëllimin dhe objektivat e studimit, numrin e studentëve që do të marrin pjesë në studim, arsyen se përse është zgjedhur i intervistuari dhe mbi çfarë kriteresh iu kërkua pjesëmarrja në studim, si dhe kushtet e kofidencialitetit mbi të cilat ndërtohet e gjithë intervista, mënyrën e analizimit të të dhënave dhe deklarimi i personave që mund të kenë akses mbi materialin audio, ku u deklarua që për arsye kontrolli mund të jetë e nevojshme që udhëheqësi shkencor i temës së studimit t'i vihet në dispozicion materiali bruto, por pa të dhënat demografike që mund të identifikojnë të intervistuari, dhe natyrisht duke respektuar kushtet e kofidencialitetit. Gjithashtu, ju bë me

dije çdo të intervistuari sesi funksionon diktofoni në mënyrë që të kuptojë që diktofoni do të fiket në momentin që do të deklarojë se nuk dëshiron ta vazhdojë më intervistën, dhe se nga ndërprerja e intervistës apo mospranimi, nuk do të ketë asnjë pasojë për të intervistuarin. U deklarua që të dhënat do të përpunohen nga intervistuesi-studiuuesi i temës, si dhe u la një adresë kontakti për të interesuarit mbi rezultatet e studimit.

Në fillim u drejtuan pyetje që kishin të bënin me të dhënat demografike të çdo të intervistuari, më tej u vazhdua me impaktin e institucioneve sociale në sjelljen seksuale, ndërkohë që në fund u la pjesa që konsiderohej me intime dhe më personale për çdo të anketuar, që ishin pyetjet mbi sjelljen seksuale, format i cili është bashkangjitur shtojcës në fund të punimit. Të gjitha pyetjet kryesisht ishin të hapura që lejonin të intervistuarit të shpreheshin me fjalët e tyre, natyrisht formati i intervistës përmbante edhe pyetje orientuese e drejtuese në formën e disa pikave që duheshin trajtuar gjatë intervistës.

Në fund të intervistës, u garantua edhe njëherë i intervistuari për kofidencialitetin, mënyrën e punës me të dhënat, dhe asgjësimin e tyre pas mbrojtjes me sukses të këtij disertacioni.

3. 3. Modeli i analizës së të dhënave

- *Modeli ekonometrik/statistikor*

Për të analizuar të dhënat sasiore të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve u përdor analizimi i të dhënave nëpërmjet metodës ekonometrike statistikore. Për analizimin e të dhënave u përdorën programet statistikore SPSS. 20 dhe Excel. 2010, ku pasi u bë kontrolli i

përgjigjeve për çdo pyetësor, u hodhën në dhënat në sistem për të vazhduar më tej me analizimin e tyre.

Nëpërmjet analizës statistikore u realizuan analiza e frekuencës për grupin e parë të të dhënave demografike, për të paraqitur kështu disa karakteristika të kampionit për studim. Më tej, u përdorën analiza të tjera statistikore për të paraqitur tendencat kryesore dhe variabilitetin e variabëlve kryesorë. Natyrisht, për të shqyrtuar marrëdhëniet mes dy variabëlve u realizua analiza bivariabële dhe e korrelacionit Pearson (r) nëpërmjet formulës: $r = r(X, Y)$, ku vlera e koeficientit të relacionit (r -ja) merr vlera nga segmenti $-1 \leq r \leq 1$. U vazhdua me kontrollin e hipotezave nëpërmjet analizave ekonometrike dhe regresionit linear.

- Modeli i analizës tematike

Analizimi i të dhënave cilësore, u realizua nëpërmjet analizës tematike, ku nëpërmjet procesit të segmentimit, kategorizimit dhe rilidhjes së aspekteve dhe të dhënave përpara interpretimit të tyre përfundimtar u përfshan edhe rezultatet e të dhënave cilësore (Grbich, 2013). Pas zbardhjes së të dhënave nga audio në tekst të shkruar, të dhënat u punuan në pjesë ose seksione ku u grupuan nëpërmjet etiketimit të çdo grupi përgjigjesh sipas tematikës së trajtuar, duke emërtuar çdo numër faqesh për t'iu referuar saktësisht të dhënave.

Më tej, u hartua edhe lista e temave, të cilat u parashikuan që mund të jenë trajtuar nga i intervistuari, por natyrisht në këtë pjesë pati fleksibilitet për të shtuar edhe gjatë analizës tema të cilat në mënyrë specifike u trajtuan nga ndonjë i intervistuar. Indeksimi i temave u

bë nëpërmjet numrave, të cilët në instrumentin matës identifikonin çdo pyetje si p.sh.: 1. Informacion demografik, 2. Informacion mbi sjelljen seksuale, 3. Besimi fetar dhe ndikimi në sjelljen seksuale. . . etj. Indeksimi u përdor për të gjetur më lehtë një të dhënë të caktuar, ku në krahun e djathtë të tekstit u vendosën indekse të caktuara sipas treguesve të temave më lart.


Faza tjetër e punës me analizimin e të dhënave cilësore ishte edhe kodifikimi, ku çdo teme të trajtuar në tekstet e zbardhura iu dha një emër i caktuar në formë kodi të shkurtuar, si p.sh.: *NFSS*(*Ndikimi i fesë në sjelljen seksuale*) ose *SSE* (*Sjellja seksuale etike*), e kështu me radhë, sipas çdo teme të trajtuar. Kodet e tilla u përcaktuan më parë në formën e përkufizimeve, ku natyrisht pati fleksibilitet për kode të reja gjatë analizës.

Pas hapave të mësipërm, të dhënat e përfuara u organizuan në tabela dydimensionale (Ritchie & Lewis, 2003:96), ku u futën citimet kyçe nga burimet e të dhënave, një përmbledhje e çështjeve të ngritura dhe informacione të tjera nga të dhënat cilësore. Në tabelë u paracaktua si fillim tema paraprake, më tej interpretimi fillestar mbi këtë temë, dhe së fundi kategori përfundimtare, që mund të konsiderohen ndryshe edhe si rezultati përfundimtar i një grupi të dhënash për një temë të caktuar.

Në fund të së gjithë punës me të dhënat cilësore, u bë kontrolli përfundimtar për të verifikuar interpretimin e të dhënave, kodifikimi, indeksimin, paraqitjen e rezultateve në tabela.

KAPITULLI IV: REZULTATET E TË DHËNAVE SASIORE


4. 1. Karakteristikat demografike të kampionit sasior



Më poshtë do të shohim të dhënat demografike të kampionit sasior, ku në të gjithë grafikët e paraqitur do të përshkruhet frekuenca e karakteristikave të kampionit. Përkatësisht, grafiku 1 dhe 2 shpjegojnë përqindjet për gjininë dhe moshën e studentëve, që morën pjesë në studim, ku theksoj se numri total i tyre është


1213 studentë. Siç rezulton, numri i femrave pjesëmarrëse është gati tri herë më i madh sesa numri i meshkujve.

Nëse do të shohim pjesëmarrjen e meshkujve në leksione dhe në salla, vihet re se meshkujt janë më pak prezent sesa femrat në auditorë. Në grafikun e dytë janë përqindjet sipas moshave përkatëse që kanë qenë pjesë e këtij studimi, ku rezulton me një pjesëmarrje më të madhe në studim moshë 20 vjeç, dhe ajo me një




përqindje më të vogël, studentët në moshë më të madhe sesa 26 vjeç. Më poshtë, në grafikun e tretë, paraqiten në përqindje vitet akademike të studentëve ku aktualisht

vazhdojnë studimet. Janë marrë në anketim studentë të ciklit të parë "bachelor" të të tria viteve dhe të ciklit të dytë të studimeve master nga të dyja vitet e studimeve.




Grafiku numër katër, paraqet përqindjen e studentëve të çdo universiteti publik dhe privat në Shqipëri, ku ndjekin studimet 1213 studentët që morën pjesë në këtë studim. Natyrisht, ky grafik paraqet të dhëna për ata studentë nga universitete, që sipas formulës së kampionit u përfshinë në studim.




Grafiku me numër 5, jepen të dhëna mbi statusin e marrëdhënieve të studentëve, ku të anketuarit pyeten mbi marrëdhëniet aktuale, nëse janë në marrëdhënie intime me një person


tjetër ose jo, e konsiderojnë atë rastësore, të qëndrueshme dhe rëndësishme për ta. Janë në bashkëjetesë, të martuar, të divorcuar apo të ve.



Grafiku që paraqet të dhëna mbi rrugët nga ku studentët e marrin informacionin në lidhje me marrëdhëniet seksuale, në diferencë me grafikët më lart paraqet mesataren e përgjigjeve nga 1-5, jo frekuencën e tyre. Për, rrjedhojë, më poshtë në grafik sipas të dhënave ka rezultuar se studentët informohen më shpesh nga shokët/shoqet, partneri seksual dhe media, që kanë edhe vlerat më të larta të paraqitura në kolonat përkatëse, të dhënat jepen me përqindje.




Grafiku No. 7: Sa njohuri kanë studentët mbi marrëdhëniet seksuale




Në grafikun numër 7, paraqiten të dhëna në lidhje me njohuritë që pohojnë se kanë studentët mbi marrëdhënien seksuale, ku siç shihet në grafik vlerën më të lartë e merr kolona mjaftueshëm, çfarë do të thotë se studentët pohojnë në pjesën më të madhe që kanë mjaftueshëm njohuri mbi marrëdhëniet

seksuale. Më poshtë në grafikun 8 paraqiten karakteristika të kampionit në lidhje me preferencat seksuale të studentëve, ku edhe në këtë rast janë përgjigjur të gjithë studentët, dhe sipas rezultateve 1183 studentë kanë pohuar që janë heteroseksualë, vetëm një prej studentëve ka pohuar që është homoseksual dhe nga të

Grafiku No.8: Preferenca seksuale




Grafiku No.9: Studentë që kanë kryer ose jo marrëdhënie seksuale



dhënat rezulton të jetë i gjinisë mashkull, 14 studentë janë deklaruar si biseksualë, ku nga të dhënat rezultoi se janë 10 femra dhe 4 meshkuj, dhe 15 studentë u deklaruan si të pasigurt për preferencën e tyre seksuale. Ndërkohë që aseksual nuk është deklaruar asnjë prej studentëve që ishin pjesë e këtij

studimi. Grafiku 9, më poshtë paraqet të dhëna në lidhje me statusin e marrëdhënieve


seksuale të studentëve të anketuar, ku siç rezulton, 67, 4% kanë kryer aktin e parë seksual, ndërkohë pjesa tjetër nuk kanë kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale (*Graf. No. 9*).



Në grafikun 10, studentët pyeten, për moshën se kur kanë kryer marrëdhënien e parë seksuale, ku të dhënat paraqiten në numër rastesh për të parë më konkretisht numrin e saktë të studentëve, nga ku dhe rezultoi se në 818 studentë që kishin kryer marrëdhënie seksuale; 42 studentë pohuan se kanë kryer marrëdhënien e parë seksuale në moshën 13

vjeç, 140 prej tyre e kanë kryer në moshën 14 vjeç, dhe shihet që numri më i madh kanë kryer marrëdhënien seksuale në moshën 17 vjeç, që janë konkretisht 232 studentë.

U pa me interes të shihet nëse ka dallime gjinore për sa i përket moshës së aktit të parë seksual të 818 studentëve, të anketuar për këtë studim. Në tabelën 1, shihet qartë që janë femrat ato që kanë numër më të madh të rasteve që kanë kryer marrëdhënien seksuale në krahasim



me meshkujt, por nëse shikojmë totalin e meshkujve dhe femrave që kanë pohuar se kanë kryer marrëdhënie seksuale vërejmë se ka një përfaqësi më të madhe të femrave në studim

dhe për rrjedhojë do të nxirren përqindjet për 502 femra që kanë kryer marrëdhënie seksuale dhe për 312 meshkuj, diferencat nuk janë shumë të ndryshme.

Tabela No. 1:		D11: Moshë e marrëdhënies seksuale të parë							Totali
Kryqëzimi i variabëlve gjini dhe moshë e marrëdhënies seksuale.		13-vjeç	14-vjeç	15-vjeç	16-vjeç	17-vjeç	18-vjeç	19-vjeç	
D1: Gjinia	F	31	118	110	103	136	66	4	568
	M	11	10	34	21	96	57	21	250
Totali		42	128	144	124	232	123	23	818

Studentët u pyetën për numrin e partnerëve që kanë pasur gjatë një viti, dhe rezultoi se pjesa dërmuese pohojnë që kanë pasur 2-3 partnerë gjatë një viti akademik. Në tabelën 2, më poshtë paraqiten edhe rezultatet e dhëna nga kryqëzimi i variabëlve gjini me numrin e partnerëve seksualë brenda një viti akademik, ku duhet thënë se rreth 50 % e meshkujve pohuan të kenë 2-3 partnerë seksual në një vit akademik, ndërkohë që përqindja e femrave që kanë 2-3 partnerë në një vit shfaqet më e vogël, por gjithsesi diferenca mbetet e vogël. Dallimi më i madh qëndron tek meshkujt dhe femrat që kanë pasur 1 partner seksual ose asnjë partner brenda një viti.

Tabela No. 2: Kryqëzimi i variabëlve gjini dhe numër partnerësh seksualë		D12: Partner seksual gjatë vitit të fundit				Totali
		Asnjë partner seksual	1 partner seksual	2 partnerë seksualë	3 partnerë seksualë	
D1: Gjinia	Femër	70	241	136	99	566
	Mashkull	22	78	35	135	250
Totali		92	319	171	234	816

Në tabelën 3, jepen rezultatet nga kryqëzimi i variabëlve gjini dhe numër partnerësh njëherësh, ku rezultatet tregojnë se janë meshkujt ata që kanë pasur më shumë se një partner në të njëjtën kohë. (Tabela No. 3)


Tabela No. 3: Kryqëzimi i variabëlve gjini me variabëlin numër partnerësh në të njëjtën kohë		D13: Më shumë se një partner seksual në të njëjtën kohë					Totali
		Asnjëherë	Rrallë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë	
D1:Gjinia	Femër	457	78	29	2	0	566
	Mashkull	99	38	83	23	7	250
Totali		556	116	112	25	7	816

4. 2. Mesatarja e ponderuar e sjelljes seksuale dhe etikës

Në grafikun më poshtë jepen të dhëna mbi sjelljen seksuale të studentëve shqiptarë, ku nga të 1213 studentët, ata që pohuan se kishin kryer marrëdhënie seksuale, u pyetën në lidhje me sjelljes seksuale të mëposhtme, si: stimulimi i organit gjenital të partnerit seksual, masturbimi, lojërat seksuale, seksin oral si marrëdhënie seksuale e anasjelltë mes partnerëve seksualë, seksin anal, seksin vaginal, si dhe orgjitë ose marrëdhëniet seksuale me më shumë se një partner njëherësh, ku u cilësua me dy femra dhe një mashkull ose me dy meshkuj dhe një femër.

Siç shihet në grafikun më poshtë, vlerat më të larta të mesatares i marrin marrëdhënia seksuale vaginale, stimulimi me dorë i organit seksual të partnerit, marrëdhënia seksuale orale, duke vijuar me marrëdhënien seksuale anale. Mesatare më të vogël tregojnë


marrëdhënia seksuale me më shumë se një partner, ku vihet re që marrëdhënia seksuale mes dy femrave dhe një mashkulli në të njëjtën kohë, ka një mesatare më të lartë, por gjithsesi jo me diferencë të madhe mes asaj me dy meshkuj dhe një femër. Duhet pasur parasysh që shkalla e përgjigjeve është 1-5, ku, 1=asnjëherë dhe 5 = gjithmonë.



Në grafikun e radhës, paraqitet mesatarja e përgjigjeve për pyetjet mbi etikën e sjelljes seksuale në radhët e studentëve shqiptarë, ku përgjigjet u vlerësuan nga 1-5, 1=asnjëherë dhe 5=gjithmonë, dhe studentët u pyetën në lidhje masat mbrojtëse gjatë aktit seksual, përgjegjësia gjatë aktit seksual, vizitat periodike tek gjinekologu/andrologu, kryerjes së testit të Hiv-Sidës, abortit si shkak i shtatzanisë së paplanifikuar, tradhtisë mes partnerëve, marrëdhënieve seksuale me dëshirë reciproke mes partnerëve seksualë, dhunës seksuale, etj. Nga të dhënat rezultoi se vlerat më të larta të mesatares i marrin sjelljet si; kam kryer marrëdhënie seksuale edhe pse jam diagnostikuar me sëmundje seksualisht të

transmetueshme, që mesatarisht studentët përgjigjen ndonjëherë dhe pjesa dërrmuese janë femrat që e pohojnë këtë. Seksi oral si formë mbrojtëse nga shtatzania e padëshiruar apo sëmundjet merr një vlerë shumë të lartë të mesatareve, që do të thotë kjo sjellje është e shpeshtë tek studentët. Studentët pohojnë që gjatë aktit nuk përdorin masa mbrojtëse, ata thjesht tregohen të kujdesshëm, që merr sërish një vlerë të lartë mes ndonjëherë dhe shpesh. Marrëdhënie seksuale me prezervativë ndodhin rrallë në deri ndonjëherë, dhe ndërkohë seksi oral dhe ai anal pa dëshirën e plotë të partnerit që e kryen aktin, por thjesht për të plotësuar dëshirën e partnerit që e përfiton këtë akt, ndodh rrallë ose e interpretuar ndryshe të paktën një herë ku pjesa dërrmuese janë femrat që e pohojnë këtë.

Grafiku No. 13: Vlerat mesatare të sjelljes seksuale etike



4. 3. Testimi i hipotezave kërkimore

Hipotezat e ngritura të këtij studimi janë testuar në disa forma, në vijim paraqiten rezultatet e analizave dhe testet përkatëse. Konkretisht në hipotezën e parë të këtij studimi u pohua se: **H₁. Morali që institucionet sociale përdorin për edukimin seksual të të rinjve nuk ndikon frenimin e sjelljes seksuale.** U morën në analizë variabëlët e caktuar që kishin të bënin me moralin dhe komunikimin mbi baza morale, ku në rastin e parë u analizua marrëdhënia mes bisedave me baza morale në familje dhe ndikimit në sjelljen seksuale të studentëve. Nga të dhënat rezultoi se për: $t = 2.239$, $df = 310$, $p\text{-value} = 0.02586$, me 95 % besueshmëri në intervalin: $0.23391477 - 0.01532874$, koeficienti është pozitiv: 0.1261527 . Çfarë do të thotë se: katrori i koeficientit të korrelacionit R^2 (R Square) = 0.1261527 , tregon se proporcioni i variabëlët është rreth 13%, pra deri në 13% e variabëlët të varur shkaktohet nga variabëlët i pavarur, e thënë ndryshe sipas variabëlëve të marrë në analizë, sa më shumë biseda me bazë morale mbi seksin dhe marrëdhënien seksuale, aq më shumë aktivitete seksual.




Figura No. 2: Marrëdhëniet korrelative mes moralit të institucioneve sociale dhe sjelljes seksuale të studentëve

Më tej u analizua marrëdhënia mes bisedave me përmbajtje morale tek bashkëmoshatarët dhe ndikimit në sjelljen seksuale të studentëve, nga ku rezultoi se për ; $t = 8.457$, $df = 310$, $p\text{-value} = 1.095e-15$, me 95 % besueshmëri në intervalet :0.5190540 -0.3381898, koeficienti rezulton pozitiv me vlerë 0.4329695, çfarë do të thotë se sa më shumë biseda me baza morale mes studentëve, aq më i lartë është aktiviteti seksual. Në vazhdim u mor në analizë arsimi dhe bisedat me baza morale që realizohen nga mësuesit dhe ndikimi në sjelljen seksuale të studentëve, nga ku rezultoi se për; $t = 4.9121$, $df = 310$, $p\text{-value} = 1.461e-06$, 95% nivel besueshmërie në intervalin :0.3687636 -0.1625399, koeficienti merr vlerë pozitive 0.2687285, çfarë do të thotë se me rritjen e bisedave me baza morale në shkolla, aq më shumë rritet aktiviteti seksual i studentëve. Dhe në analizimin e bisedave me baza morale në institucione fetare dhe ndikimi në sjelljen seksuale rezultoi se për; $t = -5.9103$, $df = 310$, $p\text{-value} = 8.993e-09$, me 95% besueshmëri në intervalin: 0.4146213 -0.2147848, koeficienti merr vlerën pozitive: 0.3182338, çfarë do të thotë sa më shumë biseda morale në institucione fetare aq më shumë rritje të njësisë së sjelljes seksuale (tabela no 11, në shtojcë).

Natyrisht në këtë rast nuk u morr në analizë media, sepse njihet si një institucion social i hapur i cili nuk mbështet në moralin shoqëror apo në programacionet me baza morale.

H₂. Roli i prindërve në sjelljen seksuale të të rinjve ka rënë ndjeshëm si shkak i influencës së madhe që kanë bashkëmoshatarët dhe media.

Analizojmë me anë të koeficientit të korrelacionit Pearson, rolin e familjes, të bashkëmoshatarëve dhe mediave tek variabëliti e lidhur me shkallën e aktivitetit seksual

(sjelljen seksuale). Shënojmë me 'SS' mesataren e ponderuar të variabëlve 'SS₁-SS₁₀', me 'fm' familjen si mesatare e ponderuar e variabëlve "F7-F25", me 'b' bashkëmoshatarët si mesatare e ponderuar e variabëlve 'B₁-B₁₄', dhe me 'm' median simesatare e ponderuar e variablave 'M₃-M₂₀'. Siç vërehet nga figura më poshtë, vlerat janë relativisht të larta, pra çdo faktor mund të konsiderohet një matës i përshtatshëm i variabëlit kryesor të varur që është sjellja seksuale. Paraqesim në shtojcë edhe testet statistikore origjinale të software-t, ku vërejmë se refuzohet hipoteza zero e barazimit të këtyre koeficienteve me zero, pra me siguri të plotë kemi lidhje të fortë dhe të qëndrueshme statistikisht mes variabëlit të varur dhe atyre të pavarur të testuar për këtë hipotezë kërkimore. Ku, rezulton se familja ka impakt negativ në sjelljen seksuale, pra ekziston një korrelacion i zhdrejtë mes variabëlve; sa më pak informacion dhe biseda të hapura në familje mbi sjelljen seksuale, aq më i lartë është aktiviteti seksual i studentëve të anketuar. Ndërkohë që media dhe bashkëmoshatarët rezultojnë të kenë impakt pozitiv, korrelacion të drejtë me variabëlin sjellje seksuale, çfarë nënkupton se me rritjen e informacionit të marrë në media dhe nga bashkëmoshatarët, rritet aktiviteti seksual i studentëve (shih tabelën no. 12, në shtojcë).




Figura No. 3. Marrëdhëniet korrelative mes familjes, bashkëmoshatarëve, medias dhe sjelljes seksuale të studentëve

Duhet theksuar, që në instrumentin matës ka pasur pyetje që kishin të bënin me rritjen e studentëve me të dy prindërit biologjik ose jo, nëpërmjet të cilës kërkohej të analizohej sesi ndikon rritja me një prind biologjik ose jo, në sjelljen seksuale të studentëve. Nga analizimi i të dhënëve rezultoi se ekziston një lidhje e rëndësishme statistikore dhe pozitive, mes variabëlve prindërim dhe sjellje seksuale, ku sa më e madhe të jetë mungesa e prindërve biologjikë (pra të rinjtë që kanë pohuar se janë rritur vetëm me një prind biologjik, si shkak i divorcit mes tyre apo humbjes së jetës së njërit prej prindërve, si dhe për rastet që nuk janë rritur me asnjërin prej prindërve biologjikë), aq më i lartë ka rezultuar të jetë aktiviteti seksual i studentit, ku për; $t = 9.001$, $df = 310$, $p\text{-value} < 2.2e-16$ (vlefshmëria më e vogël se 5%), me 95% besueshmëri mes variabëlve në intervalin: 0.1672644 0.3729522, me koeficient që rezulton në vlerën 0.2732285. (Shih tabelën no. 7, në shtojcë)

Gjithashtu, u testua sesi ndikon arsimimi i nënës në sjelljen seksuale të studentëve, ku rezulton se për; $t = -4.5031$, $df = 310$, $p\text{-value} = 9.494e-06$ (vlefshmëria më e vogël se 5%), me 95 % besueshmëri në intervalin: -0.3492130 -0.1406123, vlera e koeficientit është -0.2477823, çfarë do të thotë se sa më i vogël arsimimi i nënës, aq më i madh aktiviteti seksual i studentëve.

Në këtë seksion u pa me interes edhe analizimi i impaktit që ka gjendja ekonomike e familjeve në sjelljen seksuale të studentëve. Rezultoi se për; $t = 7.1872$, $df = 310$, $p\text{-value} = 4.964e-12$ (vlefshmëria më e vogël se 5%), me 95% besueshmëri në intervalin: 0.2785807 0.4692745, koeficienti është 0.3779288, që do të thotë se sa më e ulët të ketë rezultuar gjendja ekonomike, aq më shumë është rritur aktiviteti seksual i studentëve (kujdes: variabëli ka shkallë zbritëse, ndaj merr këtë interpretim, ulja e nivelit ekonomik rrit

aktivitetin seksual). Ndërsa në rastin e të ardhurave mujore që ka një rend rritës në instrumentin matës, ka rezultuar se sa më pak të ardhurat mujore, aq më shumë e rrisin aktivitetin seksual të studentëve. Sipas testit origjinal rezulton se për: $t = -3.954$, $df = 310$, $p\text{-value} = 9.528e-05$ (*vlefshmëria më e vogël se 5%*), 95% besueshmëri në intervalin : -0.3223110 -0.1107706 , koeficienti i ndikimit ka vlerën -0.2191142.

Në analizimin e impaktit të media në sjelljen seksuale, u pa se ekziston një lidhje e qëndrueshme statistikore me vlerë pozitive, për rrjedhojë u mor në analizim impakti i kohës që frekuentohet media e preferuar e një studenti, ku rezultoi se sa më shumë orë në javë shpenzohet për të ndjekur median, studentët aq më shumë janë të përfshirë në aktivitet seksual. Ku rezultoi se për: $t = 5.001$, $df = 310$, $p\text{-value} = 9.566e-07$ (*vlefshmëria më e vogël se 5%*), 95% besueshmëri në intervalin: 0.1672644 0.3729522, koeficienti merr vlerë pozitive 0.2732285 (*tabela no. 13, në shtojcë*).

H₃. Institucionet e arsimit dhe besimi fetar (institucionet fetare) nuk ndikojnë në sjelljen seksuale të studentëve shqiptarë.

Nga analizimi i të dhënave rezultoi se që të dyja institucionet, si ato të arsimit, por edhe institucionet fetare kanë një korrelacion të zhdrejtë me sjelljen seksuale të studentëve, çfarë do të thotë se sa më pak edukim dhe biseda të hapura në institucionet e arsimit apo në ato fetare, aq më i lartë është aktiviteti seksual i studentëve në Shqipëri.

Sipas analizës së përfutur rezulton se për: $t = -7.044$, $df = 310$, $p\text{-value} = 1.212e-11$ (*vlefshmëria më e vogël se 5%*), 95% besueshmëri në intervalin: -0.4633757 -0.2716131, koeficienti që merr impakti i arsimit në sjelljen seksuale është negativ -0.3714491

(*korrelacion i zhdrejtë*). Po ashtu edhe për impaktin e institucionit fetar, rezulton se për; $t = -0.436$, $df = 310$, $p\text{-value} = 0.4631$ (*vlefshmëria më e vogël se 5%*), 95 % besueshmëri në intervalin: $-0.13542370 - 0.08651925$, koeficienti është sërish me vlerë negative, -0.02475729 (*korrelacion i zhdrejtë*). Le të shohim më poshtë edhe vlerat përkatëse sipas modelit konceptual të hipotezave (tabela no. 14, në shtojcë).




Figura No. 4 : Marrëdhënia korrelative mes institucioneve arsimore dhe atyre fetare me sjelljen seksuale

Për këtë hipotezë u pa me vlerë që të testohet, se cila prej feve apo besimeve fetare ka një impakt më të madh në sjelljen seksuale, ku nga të dhënat rezulton mesatarja e ponderuar e sjelljes seksuale për çdo besim fetar, e llogaritur më poshtë;

Tabela No. 4 : Mesatarja e ponderuar e sjelljes seksuale sipas besimit fetar të studentëve

Besimi fetar	Mesatare e ponderuar (ss)
Katolik	3,20894
Ortodoks	3,21085
Mysliman	3,49593
<i>Bektashi</i>	<i>3,10000</i>

Gjithsesi, kjo vlerë e mesatares së ponderuar të sjelljes seksuale në raport me besimin fetar, ku rezulton që ata që janë konsideruar si myslimanë kanë një mesatare më të lartë të aktivitetit ose sjelljes seksuale, duhet analizuar edhe në lidhje me frekuentimin e institucionit fetar, sepse në një pjesë dërrmuese të rinjtë pohojnë të jenë myslimanë, por shumë pak prej tyre e kanë të rëndësishëm besimin fetar apo frekuentojnë rregullisht xhaminë si institucion fetar i myslimanëve. Kështu, u mor në analizë marrëdhënia midis variabëlve frekuentim i institucionit fetar dhe sjellje seksuale. Pra, sa më shumë frekuentohet xhamia në rastin e besimit myslimanm që ka treguar një mesatare të lartë të ponderuar të sjelljes seksuale, aq më i ulët aktiviteti seksual. Vërejmë se refuzohet hipoteza zero e barazimit të këtyre koeficienteve me zero, me siguri të plotë kemi lidhje të fortë dhe të qëndrueshme statistikisht. Lidhja është pozitive, pra me uljen e frekuentimit, ulët aktiviteti seksual i studentëve dhe anasjelltas (*shih tabelën no. 19, në shtojcë*).

Gjithashtu, u pa me interes që të merret në analizë marrëdhënia ekzistuese mes institucioneve sociale dhe virgjërisë (personave që pohuan se nuk kanë kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale), për të bërë një krahasim të mundshëm me ata persona që kanë pohuar se kanë kryer aktin e parë seksual. Nga analizimi i të dhënave rezulton se; sa më i madh dhe më i hapur ka qenë komunikimi brenda familjes për tematika si marrëdhënie seksuale apo masat mbrojtëse, etj, aq më i vonë është akti i parë seksual. Mes këtyre variabëlve ekziston korrelacion pozitiv me vlerë 0. 8349849. Në institucionet e tjera, si për bashkëmoshatarët dhe për median rezulton se; sa më pak biseda mes bashkëmoshatarësh, apo sa më pak orë frekuentimi të medias, sa më pak imazhe pornografike dhe informacione të tjera mbi marrëdhënien seksuale, aq më shumë rritet mosha e aktit të parë seksual, në këtë rast ekziston korrelacion i zhdrejtë mes variabëlve, konkretisht në vlerat -0. 1790113

për ndikimin e bashkëmoshatarëve dhe në vlerën -0.09418317 për ndikimin e medias. Ndërkohë, ndikimi i arsimit rezulton të ketë vlerat, 0.02150326 , çfarë do të thotë se ekziston një marrëdhënie pozitive mes variabëlve, ku sa më i hapur edukimi seksual, aq më e madhe mundësia për të shtyrë aktin e parë seksual.

Në rastin e besimit fetar, rezultati shfaqet interesant për faktin sesi në rastet e të rinjve që kanë pohuar se kanë kryer aktin e parë seksual edhe atëherë kur nuk e kanë kryer aktin seksual korrelacioni mes variabëlve ka rezultuar të jetë me vlerë negative -0.1193997 dhe me nivel vlefshmërie për $t = -1.4448$, $df = 310$, $p\text{-value} = 0.0495$ (afërsisht 5%), çfarë do të thotë se ekziston një korrelacion i zhdrejtë mes variabëlve të varur dhe besimit fetar si institucion social, por niveli i lartë i vlefshmërisë jo më shumë se 5%. Në këtë këndvështrim përfundimet për ndikimin e fesë në sjelljen seksuale mund të jenë të ndryshme, por një gjë është e qartë, që feja apo besimi fetar nuk janë institucione që kanë impakt në sjelljen seksuale, për aq kohë sa ndikimi është negativ në të dyja rastet dhe mbi të gjitha vlera e vlefshmërisë së këtij variabëli është në të dyja rastet më e madhe se 5%. Tabela më poshtë jep detajet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë për marrëdhënien mes variabëlve (*shih tabelën no. 15, në shtojcë*).

H₄. Institucionet sociale (familja, bashkëmoshatarët, arsimi, feja dhe media) nuk ndikojnë në modelimin e një sjelljeje seksuale etike tek studentët në Shqipëri. Siç duket edhe në modelin e ndërtuar, të gjitha institucionet sociale të marra si variabël të pavarur në këtë studim, kanë korrelacion të zhdrejtë në lidhje me variabëlin e varur që është sjellja seksuale etike. Në këtë hipotezë u pa e rëndësishme që të testohesh së cilët janë institucionet sociale që mundësojnë dhe informojnë të rinjtë në lidhje me etikën në sjelljen

seksuale. Në çdo rast rezulton të ketë vlerë negative, siç paraqitet edhe më poshtë në tabelat origjinale të softwar-it, ku sa më pak informacion dhe biseda të hapura ka në familje, shkollë, mes bashkëmoshatarësh, në institucione fetare apo edhe në media, aq më tepër sjellje seksuale jo etike ka në radhët e studentëve shqiptarë. Pra, si shkak i mungesës së një informacioni të hapur, ekziston një sjellje seksuale jo etike mes studentëve.




Figura No. 5: Marrëdhënia korrelative mes institucioneve sociale dhe etikës së sjelljes seksuale

Përkatësisht, për marrëdhënies e variabëlve familje dhe sjellje etike seksuale rezulton se për; $t = -7.5083$, $df = 310$, $p\text{-value} = 6.422e-13$, 95 % besueshmëri në intervalin: -0.4822953 -0.2940320, koeficienti merr vlerën -0.3922637. Për marrëdhënien mes variabëlve bashkëmoshatarë dhe sjellje etike seksuale rezulton se për; $t = -11.9429$, $df =$

310, $p\text{-value} < 2.2 \times 10^{-16}$, me 95% besueshmëri në intervalin: -0.6329389 -0.4802485, koeficienti merr vlerën -0.5613524. Për variabëliten arsimit dhe sjelljen seksuale etike, nga të dhënat rezulton se për: $t = -1.9175$, $df = 310$, $p\text{-value} = 0.05609$, me 95 % besueshmëri në intervalin: -0.216702547 0.002803336, koeficienti merr vlerën -0.1082691.

Marrëdhëniet mes variabëlve besim fetar dhe sjellje seksuale etike, rezulton se për: $t = -1.3136$, $df = 310$, $p\text{-value} = 0.0899$, me 95 % besueshmëri në intervalin: -0.3268802 -0.1158123, koeficienti merr vlerën -0.2239708, çfarë do të thotë se besimi fetar në rastin e etikës së sjelljes seksuale është një variabël që duhet marrë me rezervë për faktin se *a (alfa e vëzhguar)* është më e madhe se 5%. Dhe institucioni i fundit që u vu në analizë, media me etikën e sjelljes seksuale, rezultoi se për: $t = -8.7869$, $df = 310$, $p\text{-value} < 2.2 \times 10^{-16}$, me 95 % besueshmëri në intervalin: -0.5312398 -0.3530064, koeficienti merr vlerën -0.4465418 (shih tabelën no. 17, në shtojcë).

H₅. Nuk ekzistojnë dallime gjinore esenciale në sjelljen seksuale të studentëve në Shqipëri.

Për këtë hipotezë u morën në analizë, variabëliten gjini e studentëve dhe sjelljen seksuale. Nga rezultatet e të dhënave dalim në përfundimin që për $t = 3.2868$, $df = 310$, $p\text{-value} = 0.00113$, dhe 95 % besueshmëri në intervalin: 0.07397674 0.28866477, koeficienti merr vlerë pozitive, 0.183508 (korrelacion i drejtë). Me gjithë këtë rezultat, duhet pasur parasysh se në këtë rast vlera e koeficientit është 0,18%, çfarë do të thotë se pavarësisht faktit se të jesh mashkull ka një frekuencë më të madhe të aktivitetit seksual, kjo nuk përbën ndonjë dallim të madh me të qenit femër që po të njëjtat sjellje seksuale kryhen por

në një frekuencë më të vogël. Kësisoj, vërtetohet hipoteza e mësipërme, duke theksuar se nuk ka dallime esenciale në sjelljes seksuale të studentëve (shih tabelën no. 16, në shtojcë)




Figura No. 6 : Marrëdhënia korrelative mes përkatësisë gjinore, sjelljes seksuale dhe etikës

Por, këto rezultate nuk janë të njëjta në rastin e etikës së sjelljes seksuale, ku ka rezultuar se të qenit femër e rrit mundësinë e kryerjeve të marrëdhënieve seksuale pa dëshirën e tyre, që rezulton se për: $t = -6.5649$, $df = 310$, $p\text{-value} = 2.19e-10$, 95% besueshmëri në intervalin: -0.2479476 -0.4432126, me koeficient -0.3493676 (korrelacion i zhdrejtë), dhe ul mundësinë e përdorimit të masave mbrojtëse gjatë aktit seksual ku rezulton se për: $t = -20.5875$, $df = 310$, $p\text{-value} < 2.2e-16$, 95% besueshmëri në intervalin: -0.14385379 0.07797968, me koeficient -0.03334777 (korrelacion i zhdrejtë). Për sa u shkrua më lart vërtetohet se ka dallime në etikën e sjelljes seksuale, por jo në frekuencën e aktivitetit seksual (tabela no. 16, në shtojcë).

4.4. Testimi i marrëdhënieve midis të gjithë variabëlve të studimit, me anë të regresionit linear

Më poshtë do të analizojnë mbështetur në modelin konceptual (*figura no. 1*), mbi të cilin u ngritën edhe hipotezat e studimit, marrëdhënien midis të gjithë variabëlve të studimit, me anë të regresionit linear, kështu pas vërtetimit të hipotezave të mësipërme, testojmë me anë të modelit ekonometrik përkatës lidhjen ekzistuese midis variabëlve në tërësi. Do të testojmë dy modele të ndryshëm, me dy variabëlët e ndryshëm të varur: sjellja seksuale (ss), dhe etikën e sjelljes seksuale (ess), ku përfshijmë në këtë model edhe variabëlët e tjerë që lidhen me karakteristikat e individëve të intervistuar që konsiderohen edhe si variabëlët kontrollues. Konsiderojmë variabëlët e mëposhtëm (te pavarur), për kryerjen e analizës ekonometrike, ku me: **d0**: variabëli binar me dy modalitete, i tipit ‘dummy’ në modelim, është koduar gjinia e studentëve pjesëmarrës në studim, përkatësisht **d0=1** nëse studenti përkatës është mashkull dhe **d0=0** nëse studenti përkatës është femër. Me **d2**: variabëli sasiar, është koduar mosha e studentëve. Me **d5**: variabëli binar me dy modalitete, i tipit ‘dummy’ në modelim, është koduar prejardhja, ku **d5=1** nëse studenti përkatës e ka prejardhjen nga qyteti, dhe **d5=0** prejardhje nga qyteti. **F3 dhe f4**: shkalla e arsimimit nënës dhe babait. Me **F6**: të ardhurat mujore të familjes, **fm**: variabëli i **familjes** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse. Me **b**: variabëli i **bashkëmoshatarëve** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse. Me **a**: variabëli i **institucionit arsimor** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse. Me **fe**: variabëli i **institucionit fetar** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse. **m**: variabëli i **mediave** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse.

4. 4. 1. Tendeca qendrore e të dhënave për të gjithë variabëlat studimore

Fillimisht jepen disa statistika përshkruese, për të krijuar një ide mbi tendencën qendrore të të dhënave, ku: min: është vlera minimale, max: ajo maksimale, 1st Qu.: është kuartili i parë (le majtas 25% të të dhënave të renditura), median: është median (le majtas 50% të të dhënave të renditura), mean: është mesatarja e thjeshtë, 3rd. Qu. : është kuartili i tretë (le majtas 75% të të dhënave të renditura).

Tabela No. 5 :Tendeca qendrore e të dhënave për sjelljen seksuale dhe etikën e sjelljes seksuale

Ss= Sjellja seksuale	Ess (Etika e sjelljes seksuale)
Min. :1. 600	Min. :1. 182
1st Qu. :3. 175	1st Qu. :1. 722
Median :3. 600	Median :1. 843
Mean :3. 319	Mean :1. 823
3rd Qu. :3. 700	3rd Qu. :1. 934
Max. :4. 000	Max. :2. 960

Tabela No. 6: Tendeca qendrore e të dhënave për disa karakteristika të kampionit si dhe institucionet sociale si familja, bashkëmoshatarët, arsimi, feja dhe media.

d0 (gjinia)	d2 (mosha)	d5 (prejardhja)
Min. :0. 0000	Min. :1. 00	Min. :0. 0000
1st Qu. :0. 0000	1st Qu. :3. 00	1st Qu. :0. 0000
Median :0. 0000	Median :4. 00	Median :0. 0000
Mean :0. 3558	Mean :4. 08	Mean :0. 4872
3rd Qu. :1. 0000	3rd Qu. :5. 00	3rd Qu. :1. 0000
Max. :1. 0000	Max. :8. 00	Max. :1. 0000
f3 (arsimi i nënës)	f4(arsimi i babait)	f6 (të ardhurat mujore)
Min. :1. 000	Min. :1. 000	Min. :2. 000
1st Qu. :2. 000	1st Qu. :2. 000	1st Qu. :3. 000
Median :2. 000	Median :2. 000	Median :5. 000
Mean :2. 087	Mean :2. 417	Mean :4. 212
3rd Qu. :2. 000	3rd Qu. :3. 000	3rd Qu. :5. 000
Max. :3. 000	Max. :3. 000	Max. :5. 000
fm (familja)	b (bashkëmoshatarët)	a (arsimi)
Min. :1. 588	Min. :2. 154	Min. :1. 750

1st Qu. :1. 706	1st Qu. :2. 231	1st Qu. :2. 656
Median :2. 235	Median :2. 846	Median :3. 208
Mean :2. 176	Mean :2. 726	Mean :3. 014
3rd Qu. :2. 529	3rd Qu. :3. 000	3rd Qu. :3. 344
Max. :2. 941	Max. :4. 000	Max. :3. 750
<i>fe (Besimi fetar)</i>	<i>m (media)</i>	
Min. :1. 526	Min. :1. 056	
1st Qu. :2. 053	1st Qu. :1. 222	
Median :2. 316	Median :2. 833	
Mean :2. 348	Mean :2. 596	
3rd Qu. :2. 684	3rd Qu. :3. 569	
Max. :3. 316	Max. :3. 778	

4. 4. 2. Variabilitetet e të dhënave për çdo variabël studimor

Disa statistika të tjera shitesë, që lidhen edhe me variabilitetin e të dhënave *ku*: **SE Mean**: devijimi standard i mesatares, **LCL Mean**: kufiri i poshtëm i Intervalit të Besimit të mesatares, **UCL Mean**: kufiri i sipërm i Intervalit të Besimit të mesatares, **Variance**: varianca, **Stdev**: devijimi standard ose rrënja katrore e variancës , **Skewness**: indeksi i asimetrisë (nëse zero shpërndarje simetrike), **Kurtosis**: indeksi i Kurtozit (sa më afër 3-shit, aq më afër shpërndarjes normale).

Tabela No. 7: Variabilitetin e të dhënave për sjelljen seksuale dhe etikën e sjelljes		
> basicStats(y)	Ss (sjellja seksuale)	Ess (etika e sjelljes seksuale)
SE Mean	0. 027797	0. 011478
LCL Mean	3. 263896	1. 800243
UCL Mean	3. 373283	1. 845410
Variance	0. 241068	0. 041101
Stdev	0. 490987	0. 202734
Skewness	-0. 931718	0. 207533
Kurtosis	-0. 262855	3. 695148


Tabela No. 8: Variabilitetin e të dhënave për disa karakteristika të kampionit si dhe institucionet sociale si familja, bashkëmoshatarët, arsimi, feja dhe media.

>basicStats(y)	d0(gjinia)	d2(mosha)	d5 (prejardhja)
<i>SE Mean</i>	0. 027147	0. 107484	0. 028343
<i>LCL Mean</i>	0. 302354	3. 868640	0. 431411
<i>UCL Mean</i>	0. 409185	4. 291616	0. 542948
<i>Variance</i>	0. 229934	3. 604491	0. 250639
<i>Stdev</i>	0. 479515	1. 898550	0. 500639
<i>Skeëness</i>	0. 599642	0. 543002	0. 051052
<i>Kurtosis</i>	-1. 645674	-0. 350462	-2. 003785
>basicStats(y)	f3(arsimi i nënës)	f4(arsimi i babit)	f6 (të ardhurat mujore)
<i>SE Mean</i>	0. 030228	0. 035142	0. 070775
<i>LCL Mean</i>	2. 027060	2. 347520	4. 072281
<i>UCL Mean</i>	2. 146016	2. 485814	4. 350796
<i>Variance</i>	0. 285092	0. 385316	1. 562825
<i>Stdev</i>	0. 533940	0. 620738	1. 250130
<i>Skewness</i>	0. 079578	-0. 567658	-1. 052227
<i>Kurtosis</i>	0. 379158	-0. 617308	-0. 764405
>basicStats(y)	fm (familja)	b(bashkëmoshatarët)	a (arsimi)
<i>SE Mean</i>	0. 126079	0. 024824	0. 028030
<i>LCL Mean</i>	0. 025514	2. 677241	2. 959004
<i>UCL Mean</i>	2. 226485	2. 774928	3. 069308
<i>Variance</i>	0. 203106	0. 192257	0. 245132
<i>Stdev</i>	0. 450673	0. 438471	0. 495108
<i>Skewness</i>	0. 292800	0. 386463	-0. 761835
<i>Kurtosis</i>	-1. 371385	0. 069337	-0. 523370
>basicStats(y)	fe (besimi fetar)	m (media)	
<i>SE Mean</i>	0. 021514	0. 057378	
<i>LCL Mean</i>	2. 305172	2. 483077	
<i>UCL Mean</i>	2. 389834	2. 708875	
<i>Variance</i>	0. 144407	1. 027191	
<i>Stdev</i>	0. 380009	1. 013504	
<i>Skewness</i>	0. 204897	-0. 467546	
<i>Kurtosis</i>	-0. 642890	-1. 379473	

4. 4. 3. Shpërndarja simetrike e variabëlve






Më poshtë janë paraqitur boxplotët për secilin prej variabëlve të varur dhe të pavaruar.


Komentet lidhen me simetrinë e shpërndarjes, nëse boxploti është simetrik, si dhe mund të krahasohen nivelet e vlerave të variabëlve me njëri-tjetrin.



Grafiku No. 14: Boxplot i shpërndarjes e niveleve të vlerave të variabëlve

Më poshtë është paraqitur histogramët për çdo variabël, që nevojiten për të njëjtin kontroll: simetrinë dhe shpërndarjen e variabëlve.






Grafiku 15: Histogramët e shpërndarja simetrike për çdo variabël të studimit

4. 4. 4. Kombinimet e mundshme të marrëdhënieve të çdo dy variabëlve të studimit

Në vazhdim është shumë e rëndësishme që të analizohen konkretisht të gjithë grafikët e mundshëm për të gjitha kombinimet e mundshme të çdo dy variabëlve, për të bërë një “inspektim” fillestar të lidhjeve midis variabëlve. Kemi dy grafikë të mëdhenj në total, për shkak sepse do të kemi më pas edhe dy ekuacione të ndryshme për dy variabële të ndryshme të varur: sjellja seksuale (ss) dhe etika e sjelljes seksuale (ess). Në grafikun më poshtë janë përfshirë variabëlët kryesorë të pavarur në marrëdhënie me variabëlën e varur (ss). Vërejmë lidhje të mundshme pozitive midis variabëlve ‘ss’ dhe ‘b’, si dhe lidhjeve të mundshme pozitive midis ‘ss’ dhe ‘m’. Me këto lidhje dhe të tjera, do të testojmë përfundimisht, me anë të modelit ekonometrik që do të paraqitet në vijim, për të vërtetuar edhe një herë variabilitetin dhe vlefshmërinë e marrëdhënieve mes variabëlve kryesor në studim.



Grafiku No. 16: Kombinimet e mundshme të çdo dy variabëlve (ss)

Modeli final ekonometrik linear me një sërë variabëlësh të pavarur i paraqitur më poshtë, ku testohet marrëdhënia e variabëlës të varur: sjellja seksuale (ss) dhe të gjithë variabëlës të pavarur dhe ato kontrollues. Metoda që përdoret është ajo tradicionale, OLS (Ordinary Least Squares). Në ekonometri, kjo metodë njihet për vlerësimin e modelit të regresionit linear. Në praktikë, optimizimi me anë të OLS-së kryhet duke minimizuar shumën e gabimeve të modelit në katror. Vlerësuesi OLS është konsistent kur regresorët janë ekzogjen dhe nuk ka *multikolinearitet*. Për të pasur parametra të vlerësuar drejt, gabimet duhet të jenë homoskedastikë (me variancë konstante) dhe të pakorreluar me njëri-tjetrin. Një hipotezë shtesë që përdoret është dhe shpërndarja normale e gabimeve. Pra, konsiderojmë variabëlën e mëposhtëm (të pavarur), për kryerjen e analizës ekonometrike: **D0**: variabël binar me dy modalitete, i tipit ‘dummy’ në modelim. D0=1 nëse individi përkatës është mashkull dhe d0=0 nëse individi përkatës është femër, **d2**: variabël sasiore që shpreh moshën e individit, **d5**: variabël binar me dy modalitete, i tipit ‘dummy’ në modelim. D5=1 nëse individi përkatës e ka prejardhjen nga qyteti dhe d5=0 anasjelltas, **F3 dhe f4**: shkalla e arsimimit të nënës dhe babait, **F6**: të ardhurat mujore të familjes, **fm**: variabël i **impaktit të familjes** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse, **b**: variabël i **impaktit të bashkëmoshatarëve** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse, **a**: variabël i **institucionit arsimor** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse, **fe**: variabël i **institucionit fetar** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse, **m**: variabël i **mediave** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse.

Nga të dhënat në tabelën e modelit ekonometrik rezulton se në modelin e parë (*shih tabelën 9*). Shenjat me yll tregojnë që variabëlën përkatës qëndron statistikisht (sa më shumë yje, aq më tepër qëndron në model, për shembull tri yje do të thotë që variabëlën përkatës qëndron

në çdo lloj niveli, edhe në nivelin 1%). Përqendrohemi tek kolona e fundit, ku është paraqitur ***Pr(>|t|)*** ose alpha e vëzhguar. Vërejmë se variabëliti që të gjithë qëndrojnë statistikisht (nën nivelin 5%). Rkatorri adjusted është 67, 77%. Pra, variabiliteti i variabëliti të varur shpjegohet në masën 67, 77% nga modeli i ndërtuar, një vlerë e kënaqshme. Variabëliti d2 dhe d5 janë dummy, nëse kanë shenjë pozitive. Për shembull, në këtë rast janë të dy me shenjë pozitive: do të thotë që të jesh mashkull, ke mesatarisht sjellje seksuale (ss) më të lartë, dhe gjithashtu të jesh nga qyteti ke mesatarisht sjellje seksuale (ss) më të lartë.

Tabela No. 9 : Analiza ekonometrike mes variabëliti të varur 'Ss' dhe variabëliti të pavarur

```
> ols <- lm(ss~d0+d2+d5+f3+f4+f6+fm+b+a+fe+m, data=y)
```

```
> summary(ols)
```

Call:

```
lm(formula = ss ~ d0 + d2 + d5 + f3 + f4 + f6 + fm + b + a +  
fe + m, data = y)
```

Residuals:

Min 1Q Median 3Q Max

-1.38733 -0.12746 0.01362 0.11390 0.98519

Coefficients:

Estimate Std. Error t value Pr(>|t|)

(Intercept) 4.30371 0.19598 21.960 < 2e-16 ***

d0 -0.14376 0.05050 -2.847 0.004725 **

d2 0.04955 0.01307 3.792 0.000181 ***

d5 0.06867 0.03725 1.844 0.066205 *

f3 -0.40360 0.06735 -5.992 5.93e-09 ***

f4 0. 57771 0. 05743 10. 060 < 2e-16 ***

f6 -0. 04600 0. 003501 -13. 314 < 2e-16 ***

fm -0. 32535 0. 11180 -2. 910 0. 003882 **

b 0. 03215 0. 001572 30. 336 < 2e-16 ***

a -0. 26411 0. 09830 -2. 687 0. 007615 **

fe 0. 08531 0. 005816 16. 467 0. 0495*

m 0. 05330 0. 004184 12. 574 < 2e-16 ***

*Signif. codes: 0 '***' 0. 001 '**' 0. 01 '*' 0. 05 '.' 0. 1 ' ' 1*


Residual standard error: 0. 2787 on 300 degrees of freedom

Multiple R-squared: 0. 6891, Adjusted R-squared: 0. 6777

F-statistic: 60. 44 on 11 and 300 DF, p-value: < 2. 2e-16

Në këtë pjesë të punimit, vlerësojmë modelin ekonometrik linear me të njëjtët variabël të pavarur, por me ndryshimin që analizohen në marrëdhënie me variabëlin e varur *etik të sjelljes seksuale*. Konsiderojmë variabëlit e mëposhtëm (të pavarur), për kryerjen e analizës ekonometrike: **D0**: variabël binar me dy modalitete, i tipit ‘dummy’ në modelim; D0=1, nëse individi përkatës është mashkull dhe d0=0, nëse individi përkatës është femër. **d2**: variabël sasior që shpreh moshën e individit; **d5**: variabël binar me dy modalitete, i tipit ‘dummy’ në modelim; D5=1, nëse individi përkatës ka prejardhjen nga qyteti dhe d5=0 anasjelltas, **F3 dhe f4**: shkalla e arsimimit të nënës dhe babait, **F6**: të ardhurat mujore të familjes; **fm**: variabëli i **impaktit të familjes** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse, **b**: variabëli i **impaktit të bashkëmoshatarëve** si mesatare e ponderuar e

përgjigjeve përkatëse, **a**: variabëli i **institucionit arsimor** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse; **fe**: variabëli i **institucionit fetar** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse, **m**: variabëli i **mediave** si mesatare e ponderuar e përgjigjeve përkatëse.



Grafiku No. 17: Kombinimet e mundshme të çdo dy variabëlve (ess)

Tabela No. 10: Analiza ekonometrik lineare mes variabëlit të varur 'Ess' dhe të gjithë variabëlve të pavaruar

```
> ols <- lm(ess~d0+d2+d5+f3+f4+f6+fm+b+a+fe+m, data=y)
```

```
> summary(ols)
```

Call:

```
lm(formula = ess ~ d0 + d2 + d5 + f3 + f4 + f6 + fm + b + a +  
    fe + m, data = y)
```

Residuals:

Min 1Q Median 3Q Max

-0.28204 -0.09362 -0.00774 0.08005 0.85081

Coefficients:

Estimate Std. Error t value Pr(>|t|)

(Intercept) 2.906886 0.101658 28.595 < 2e-16 ***

d0 0.053352 0.026197 2.037 0.042572 *

d2 -0.027232 0.006779 -4.017 7.45e-05 ***

d5 0.066666 0.019321 3.450 0.000640 ***

f3 -0.079840 0.034939 -2.285 0.023001 *

f4 -0.03857 0.0029788 -12.948 < 2e-16 ***

f6 0.03608 0.0018162 09.899 < 2e-16 ***

fm 0.205361 0.057991 3.541 0.000462 ***

b -0.405685 0.049654 -8.170 8.69e-15 ***

a -0.138541 0.050990 -2.717 0.006970 **

fe 0.064798 0.030171 2.148 0.0899 *

m -0.062186 0.021706 -2.865 0.004465 **

Signif. codes: 0 '*' 0.001 '**' 0.01 '*' 0.05 '.' 0.1 ' ' 1**

Residual standard error: 0.1446 on 300 degrees of freedom

Multiple R-squared: 0.6093, Adjusted R-squared: 0.5913

F-statistic: 28.31 on 11 and 300 DF, p-value: < 2.2e-16

Përqendrohemi tek kolona e fundit të *Tabelës No.10*, ku është paraqitur ***Pr(>|t|)*** ose alpha e vëzhguar. Vërejmë se që të gjithë variabëlët qendrojnë statistikisht (nën nivelin 5%), por variabëli i pavarur besimi fetar, ka alfa të vëzhguar në nivelin 8%, që është më e vogël sesa 10%. Pohojmë se ky variabël nuk garanton vlefshmëri dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron në model si një matës i mundshëm i sjelljes seksuale të studentëve. Ndërkohë, variabëlët e tjerë paraqesin vlerë më të ulët sesa 5%.

Rkatrori adjusted është 59, 13%. Pra, variabiliteti i variabëlët të varur shpjegohet në masën 49% nga modeli i ndërtuar, që konsiderohet një vlerë e kënaqshme.


Kujdes, edhe në këtë rast variabëlët d2 dhe d5 janë dummy, pra nëse kanë shenjë pozitive, ku në këtë rast jo të dy variabëlët marrin shenjë pozitive; do të thotë që të jesh mashkull ke mesatarisht sjellje seksuale etike (ess) më të ulët dhe të jesh nga qyteti ke mesatarisht sjellje seksuale etike (ess) më të lartë.

KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE CILËSORE

5. 1. Karakteristikat demografike të kampionit cilësor

Në grafikët e mëposhtëm, jepen disa karakteristika demografike të kampionit cilësor, si gjinia, universiteti që studentët ndjekin, prejardhja e tyre, statusi i marrëdhënies seksuale, mosha e marrëdhënies së parë seksuale dhe

Grafiku No.19: Përqindja e studentëve në universitete



studimit, të përzgjedhur sipas procedurës së kampionimit me kuota, ku rezultuan të jenë bërë pjesë e intervistave 79 studentë të universiteteve shtetërore dhe 21 studentë të universiteteve private. Ndërkohë, prejardhja e studentëve, fshat apo qytet, për intervistat


ballë për ballë rezultoi që të jetë në kuotat 68 studentë nga qytete të ndryshme të vendit, ku

Grafiku No.18: Gjinia



statusi i studentëve, të qenit ose jo në një lidhje intime. Ku nga kampioni cilësor ka rezultuar që 52 të jenë studentet femra dhe 48 studentët meshkuj. Pjesëmarrës në studim janë studentë të të gjitha universiteteve në vend nga të dyja ciklet e


Grafiku No. 20: Prejardhja e studentëve



pjesa më e madhe janë banues në Tiranë, dhe 32 studentë nga fshatra të ndryshëm të Shqipërisë. Shifra, që nëse do t'i krahasojmë me të dhënat sasiore, janë të përafërta.


Në grafikun no. 21, do të shohim numrin e studentëve sipas moshës përkatëse të tyre, ku pjesëmarrja më e madhe ka qenë nga studentët e moshës 18-vjeçare me 24 % të kampionit përfaqësues, siç shihet edhe në grafikun më poshtë, dhe pjesëmarrje më të vogël kanë të rinjtë mbi moshën 26-vjeçare, që përfaqësojnë 3% të kampionit cilësor; 100 të anketuar në total. Nga intervistat rezultoi se 73 % e studentëve kishin kryer marrëdhënien e parë

Grafiku No. 21: Moshja e studentëve




seksuale, ndërsa pjesa tjetër që është 27 %, pohuan se ende nuk e kanë kryer aktin e parë seksual. Po të shohim në grafikun no. 22 , 45% e studentëve rezultojnë të mos jenë në një lidhje intime, ku duhet përmendur se në këtë rast janë marrë në konsideratë të dhënat e 100 studentëve të intervistuar, si ata që kanë pohuar se kanë kryer aktin e parë seksual edhe ata që nuk e kanë kryer

Grafiku No.22: Moshja e marrëdhënies së parë seksuale



ende, ndërkohë që mosha më e hershme e aktit të parë seksual është ajo 13 vjeç që përfaqëson 6% të kampionit cilësor, ndërkohë që mosha më e vonë kur është kryer marrëdhënia e parë seksuale është 21 vjeç, ku ka rezultuar se vetëm një prej të anketuarve ka kryer marrëdhënien e parë seksuale në këtë moshë, dhe është mashkull. Nuk rezulton asnjë student me preferenca të tjera seksuale përveç asaj heteroseksuale, dhe numri i partnerëve seksualë në një vit akademik është më i lartë tek meshkujt sesa tek femrat, por që të dyja gjinitë kanë pohuar se shpeshtësia e marrëdhënieve seksuale gjatë një viti akademik është rritur ndjeshëm.

Studentët e intervistuar pyeten edhe për median e tyre të preferuar dhe se nga e merrni më shumë informacionin mbi marrëdhëniet seksuale, ku rezultoi se janë kryesisht, media, partneri seksual dhe shokët prej nga ku të rinjtë informohen në lidhje me marrëdhëniet seksuale. Ndërkohë studentët pohuan që media nga ku ata marrin më shumë



informacion në lidhje me seksin dhe marrëdhënien seksuale mbetet interneti dhe televizioni. Kryesisht interneti përdorej si një burim më i sigurt informacioni, për faktin se në çdo kohë të ditës mund të shohësh apo marrësh përgjigje prej tij, përgjigje që sipas të rinjve është e sikletshme të merren në forma të tjera. Ndërkohë televizioni shikohej më shumë si një mundësi për edukimin seksual, sepse ata pohojnë se nëpërmjet programeve

sociale mund të kenë mësuar në lidhje me shtatzaninë, sëmundjet seksualisht të transmetueshme apo përdorimin e prezervativëve.

Të dhënat cilësore që lidhen me pyetjet kryesore të kërkimit, do të paraqiten në vijim në formën e komenteve sipas grup-përgjigjeve të analizuara nëpërmjet analizës tematike.

5. 2. Analiza tematike e të dhënave cilësore

Siç është përmendur edhe më lart në metodologjinë e kërkimit, për analizimin e të dhënave cilësore të realizuara me diktofon u përdorën një sërë hapash sipas karakteristikave të analizës tematike të të dhënave, ku siç do të shihet më poshtë, për çdo pyetje kërkimi të ngritur në këtë studim, në formë teksti të përmbledhur nga të gjitha kategoritë përfundimtare të të dhënave jepen edhe përgjigjet ku konkretisht;

Për pyetjen e parë të kërkimit; *Cila është sjellja seksuale dhe etika e studentëve shqiptarë?*, rezultoi se studentët kryejnë marrëdhënie seksuale qoftë vaginale, orale, anale, masturbim, lojëra seksuale apo edhe orgji me më shumë sesa një partner njëherësh (*vetëm në dy raste*). Marrëdhënia seksuale anale dhe orgjitë janë me një frekuencë më të vogël, e shprehur qoftë nga meshkujt ose femrat e intervistuar, ndërkohë që masturbimi është një sjellje seksuale, e cila ndodh më shumë tek meshkujt sesa tek femrat.

Në lidhje me etikën e sjelljes seksuale, studentët e intervistuar kanë pohuar se kryesisht ata nuk përdorin masa mbrojtëse gjatë aktit seksual dhe sidomos nëse kanë një periudhë të gjatë që janë në lidhje me partnerin e tyre seksual (*periudha mbi 6 muaj për ta konsiderohej një lidhje e qëndrueshme*), kryesisht u theksua se prezervativët përdoren në të shumtën e herëve, nëse partnerët nuk njihen mirë dhe nuk kanë besim tek njëri-tjetri (*ku besimin e lidhin me tradhtinë dhe higjienën e partnerit të tyre seksual*). Ndërkohë femrat pohojnë në pjesën dërrmuese që nuk përdorin kontraktivët apo forma të tjera për një shtatzani të sigurt, ku mospërdorimi i kontraktivëve ka lidhje me frikën për efektet anësore që mund të shkaktojë përdorimi i tyre (*si efekte anësore u theksuan, kancer në mitër, të vjellat gjatë*

pjesës së parë të ditës, shtimi në peshë, etj). Vetëm në një rast u pohua që kishte kryer abort si shkak i shtatzanisë së padëshiruar, dhe sërish studentja pohoi se *nuk përdorte prezervativ apo kontraktivë gjatë marrëdhënies seksuale.*

Vizitat periodike tek gjinekologu apo andrologu, kryesisht për të dyja gjinitë kanë rezultuar se ata u drejtohen mjekëve vetëm nëse kanë vërejtur ndonjë shqetësim, ku u pohua vetëm nga dy femra që kanë kryer vizitë tek gjinekologu, si shkak i infeksioneve bakteriale të shkallës së lehtë (*që të dyja pohojnë se nuk i vunë partnerët e tyre në dijeni dhe kryenin rregullisht marrëdhënie me to disa ditë pas mjekimit të dhënë nga gjinekologu).*

Ndërkohë që vetëm në 2 të intervistuar përkatësisht një mashkull dhe një femër kanë pohuar të kenë kryer marrëdhënie seksuale njëherësh me më shumë sesa një partner seksual, me ndryshim nga studenti mashkull, studentja femër pohoi se marrëdhënien seksuale me dy partnerë njëherësh e ka kryer disa herë me prezencën edhe të partnerit të saj seksual (*i dashuri i saj prej 5 vitesh*), lidhje që ajo e konsideronte të rëndësishme për të, e për rrjedhojë është ndjerë e detyruar që t'i plotësonte dëshirën partnerit të saj për të kryer marrëdhënie seksuale me praninë edhe të një femre tjetër veç asaj, gjë të cilën ajo nuk e preferon ta bëjë, por plotëson dëshirën e partnerit në mënyrë që lidhja e tyre të mos ndërpritet (*e quan si një investim për të mbajtur gjallë pasionin mes tyre*).

Ndërkohë që studenti mashkull pohoi se kishte kryer marrëdhënie seksuale me dy partnere femra njëherësh disa herë që nga koha kur kishte kryer marrëdhënien e parë seksuale (*mosha 16 vjeç*). Vetëm në një rast, pjesë e kësaj orgjie kishte qenë një prej të dashurave të tij me të cilën kishte bashkëjetuar 3. 5 vjet. Në rastet e tjera ai pohon se janë femra, të cilat

nuk i frekuenton për një kohë të gjatë, dhe lidhjet me to i quan të rastësishme (*ai pohon se në asnjë rast nuk ka përdorur prezervativ, sepse kjo do ta bënte procesin të sikletshëm dhe do të ulte kënaqësinë seksuale, duke u shprehur i sigurt që femrat me të cilat ka kryer marrëdhënie seksuale kujdesen për higjienën e tyre seksuale*).

Thujse të gjitha femrat e intervistuar kanë pohuar se kryesisht marrëdhënien seksuale orale dhe anale e kryejnë vetëm për të plotësuar dëshirën e partnerëve, dhe se për ta nuk është një marrëdhënie seksuale e preferuar (*afërsisht në 30 % femrave theksohet se janë meshkujt ata që kërkojnë marrëdhënie seksuale orale dhe anale, gjithsesi pjesa e tjetër e kampionit femra pohuan se në rast se marrëdhëniet seksuale orale është e dyanshme mbetet një sjellje e preferuar edhe prej tyre, ndërkohë që për seksin anal në të gjitha rastet kjo nuk është një sjellje e preferuar, por që kryhet për të plotësuar dëshirat e partnerit*).

Për tradhtinë dhe lidhjet paralele me dy partnerë /e, u vu re që meshkujt kanë një numër më të madh të rasteve që kanë tradhtuar partneret e tyre dhe që pëlqejnë ta bëjnë këtë (*shohin si normale dhe shpesh aftësi të një mashkulli nëse ka dy partnere paralel*), ndërsa rastet e femrave janë më të vogla në numër, vetëm 6 prej femrave pohuan që ka ndodhur të paktën njëherë ta kenë tradhtuar partnerin ekzistues (*shohin si veprim të pahijshëm dhe të kryer kryesisht nga xhelozitë ose për hakmarrje, shfaqet pendim për aktin e kryer*).

Në vijim nga rezultatet e analizës tematike për pyetjen e kërimit: **A ndikon morali i shoqërisë dhe institucioneve sociale në sjelljen seksuale?** ka rezultuar se në familje, shkollë, institucione fetare dhe mes shokësh dhe shoqesh ka baza morale për sa iu përket bisedave rreth marrëdhënieve seksuale.

Sipas studentëve të intervistuar, në më shumë se 75 % të rasteve është pohuar se kryesisht në familje bisedat dhe informacioni për marrëdhëniet seksuale janë shumë të rralla, edhe në rastet kur ndodhin ato kanë baza të forta morale (*ku nënkuptohej se të kryerit seks nuk është një gjë e mirë, sidomos në rastin e studenteve femra, dhe të biseduarit për të në familje konsiderohej si një temë e sikletshme, e turpshme*).

Kryesisht nënat përpiqen të edukojnë fëmijët e tyre për të shtyrë moshën e aktit të parë seksual me idenë se ky është një veprim që nëse do të kuptohej nga shoqëria dhe të afërmit, sidomos në rastin e vajzave, do të paragjykohehin ato vetë, por edhe familja e tyre (*kjo është shumë e theksuar tek studentet që vijnë nga rrethet dhe ato të vitit të parë të studimeve. Për nënat e tyre ato duhet të jenë të virgjëra deri në martesë*). Gjithsesi, u pohua se në të shumtën e rasteve këto biseda bëheshin në prani edhe të personave të tjerë, të afërm, komshinj apo miq të familjes, ku synohej që nëpërmjet moralit dhe shembujve të ndryshëm të të rinjve të tjerë të edukoheshin fëmijët (*femrat edhe meshkujt pohuan se në rastet kur bisedat për marrëdhëniet seksuale ndodhnin vetëm me nënën e tyre, pa praninë e të tjerëve, vërehej se nënat ishin më të hapura për të biseduar apo edhe më pak gjykuese ndaj sjelljeve seksuale të fëmijëve të tyre*). Ndërkohë, edhe nga meshkujt dhe nga femrat është pohuar se bisedat me babin rreth marrëdhënieve seksuale janë thuajse tabu. Autoriteti i baballarëve është një nga arsyet që bën të pamundur bisedat në lidhje me marrëdhëniet seksuale. Edhe në ato pak raste, 5 prej meshkujve që pohuan se kanë biseduar me baballarët e tyre për marrëdhëniet seksuale, kryesisht rezultuan të jenë biseda të orientuara drejt funksionimit të organit gjenital që kanë pasur më shumë karakterin e shakave apo batutave,

por asnjëherë nuk u përmend që të ketë pasur biseda të hapura me baballarët për marrëdhëniet seksuale.

Me gjithë faktin që të rinjtë pohojnë se ka baza morale në bisedat rreth marrëdhënieve seksuale, madje në disa raste këto tema ishin edhe tabu, u pohua qartë dhe hapur që kjo nuk i pengonte ata që të kryenin marrëdhënie seksuale, nëse kishin pëlqim për dikë (*shprehen se maksimumi ata nuk do të tregojnë në familje që kanë kryer marrëdhënie seksuale, por dhe në rastet që ishte kuptuar përpos moralit të vazhduar, të rinjtë nuk e kishin frenuar marrëdhënien seksuale*). Kjo është e qartë edhe për faktin se pavarësisht nëse ata kanë pohuar se familjeve të tyre nuk do t'u pëlqente që të kuptonin se ata kanë kryer marrëdhënie seksuale, në 73 % të rasteve, kanë kryer marrëdhënie seksuale prej vitesh dhe kanë ndërruar disa partnerë seksualë.

Për 15 studentët(10 meshkuj dhe 5 femra) që pohuan se janë besimtarë fetarë që frekuentojnë institucionet fetare dhe kryejnë rituale të fesë së tyre, u pohua se kryesisht temat mbi marrëdhëniet seksuale janë tabu, ato nuk diskutohen (*edhe në rast se diskutoheshin flitej kryesisht për detyrimet e femrave ndaj meshkujve, për virgjërinë si një vlerë dhe detyrim të gruas ndaj burrit dhe kjo u theksua nga 6 meshkujt që ishin besimtarë (4 myslimanë dhe 2 ortodoksë), të cilët nuk kishin kryer kurrë marrëdhënie seksuale. Ndërkohë 3 prej femrave dhe 4 meshkujt që kishin kryer më parë marrëdhënie seksuale dhe ishin aktualisht në marrëdhënie seksuale, u pohua se pavarësisht se kryerja e marrëdhënies seksuale para martese ishte e ndaluar në besimin e tyre, ata shihnin të rëndësishëm faktin se ishin të dashuruar dhe se po investonin për të ndërtuar jetën me partnerin e tyre.*)

Në shkolla, ku studentët pohojnë se kanë marrë edukim seksual, por jo në cilësinë dhe sasinë e duhur, u pohua në pjesën dërrmuese të studentëve që kishin kryer shkollën 9 apo 8-vjeçare dhe të mesme në rrethe të ndryshme të vendit, se kryesisht mësuesit e tyre kishin shfaqur sjellje paragjyquese ndaj studentëve që kishin dyshuar se mund të kishin kryer marrëdhënie seksuale. Shpesh në klasa këta studentë etiketoheshin dhe orët e edukimit seksual ose shmangeshin (*u lihej nxënësve të lexonin në shtëpi kapitullin që kishte të bënte me edukimin seksual apo informacione rreth marrëdhënieve seksuale*), ose e gjithë ora e mësimit fokusohej tek morali (*si kryerja e marrëdhënieve seksuale ju bën më pak të denjë dhe ju shpërqendron nga mësimet*). Edhe në këtë rast studentët pohuan se edukimi seksual në shkolla apo bisedat rreth tematikave me përmbajtje seksuale, qoftë edhe pse me baza morale, nuk kanë arritur të frenojnë marrëdhëniet seksuale, dhe se vendimi për t'u përfshirë në marrëdhënie seksuale ishte i pavarur nga ajo çfarë mësohej në shkolla (*maksimumi që kërkonin ishte që të dinin sesi të mbroheshin*).

Mes bashkëmoshatarësh (sidomos mes femrave), pavarësisht se ka një komunikim të hapur dhe shkëmbehet informacion mbi marrëdhëniet seksuale, u pohua që ka raste të shumta që femrat si shkak i frikës së paragjykimeve nuk tregojnë histori të tyre personale, por e bazojnë bisedën mbi histori personale të dëgjuar nga persona të tretë, të cilët nuk kanë qenë prezent gjatë një bisede mbi marrëdhëniet seksuale. Gjithsesi, edhe në këtë rast ato nuk pengoheshin nga gjykimet morale të të tjerëve për të vazhduar sërish jetën e tyre seksuale. Ndërkohë në media, asnjë prej studentëve nuk pohon që të ketë pasur interes për të ndjekur programacione që kanë baza morale në lidhje me seksin (*përmenden telonovelat, sipas femrave, të cilat ishin edhe nga ato që kishin kryer marrëdhënie seksuale, por edhe jo, që i*

ndiqnin për shkak të veshjeve të bukura të aktoreve kryesore apo për të shtyrë kohën). Në asnjë rast nuk u provua që këto programe orientojnë qëndrimet e studentëve rreth marrëdhënieve seksuale.

Në analizimin e përgjigjeve për pyetjet kërkimore e radhës: ***Cilët institucione sociale ndikojnë më shumë tek të rinjtë që janë në marrëdhënie seksuale, në dallim me të rinjtë që nuk kanë kryer ende aktin e parë seksual? rezultoi se;***

Në rastin e të rinjve që kanë kryer marrëdhënie seksuale u theksua se media dhe bashkëmoshatarët janë institucione nga ata informohen në lidhje me marrëdhëniet seksuale (intensiteti i bisedave mbi marrëdhëniet seksuale me shokët/shoqet kishte qenë më i lartë kur ata pëlqenin dikë, dhe synonin të kryenin marrëdhënie seksuale me të. Ndërkohë që media e kryesisht interneti ishte një mënyrë për të stimuluar kënaqësi seksuale që mund të ndikonte në rritjen e shpeshtësisë së kryerjes së marrëdhënieve seksuale me partnerin e tyre)

Familja, shkolla dhe institucionet fetare nuk ndikonin aspak në marrjen ose jo të vendimit për të nisur një marrëdhënie seksuale (pavarësisht se prindërit nuk pëlqejnë që fëmijët kanë kryer marrëdhënie seksuale, ata e pranojnë këtë fakt pa shkaktuar probleme në marrëdhëniet prind-fëmijë).

Për studentët që nuk kishin kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale, sidomos në rastin e femrave pohohej se ekzistonte një marrëdhënie shumë e ngushtë me nënat e tyre (por që bisedat për marrëdhëniet seksuale nuk ishin të hapura, madje nuk kishin pasur kurrë biseda të tilla mes njëra-tjetrës). Por ky grup studentësh qofshin meshkuj apo femra i

përkushtoheshin njësoj medias dhe kohës së kaluar me bashkëmoshatarët (*ku shihnin imazhe pornografike për t'u informuar dhe flisnin me shokët/shoqet për marrëdhëniet seksuale*). Meshkujt pohuan që kishin një trysni më të madhe nga bashkëmoshatarët e tyre meshkuj që të kryenin marrëdhënie seksuale (*2 prej tyre pohuan që shokët e tyre mendojnë që ata kanë kryer marrëdhënie seksuale*). U vu re që pjesa më e madhe e studenteve femra që ishin të virgjëra kishin miqësi po me femra të virgjëra. Institucioni fetar dhe besimi fetar ishte arsyeja se përse 8 prej studentëve (*6 meshkuj dhe 2 femra, të cilët pjesën më të madhe të miqve të tyre e kishin të së njëjtit besim, si dhe në familjet e tyre besimi fetar ishte shumë i rëndësishëm*) nuk kishin kryer ende marrëdhënie seksuale, dhe që pohuan se pavarësisht pëlqimeve që mund të kishin për një person tjetër, ata sërish do t'iu qëndronin besnik udhëzimeve të fesë së tyre (*konsumimi i marrëdhënieve seksuale vetëm pas lidhjes me martesë*). Shkolla dhe institucionet e arsimit për të gjithë të rinjtë ishte institucioni i cili nuk kushtëzonte apo modelonte asnjë lloj qëndrimi a vendimi në lidhje me marrëdhëniet seksuale.

Gjithsesi, mbetet me rëndësi të deklarohej se pjesa më e madhe e studentëve kanë pohuar se asnjë prej institucioneve sociale të mësipërme nuk ndikojnë për të nisur një akt seksual, nëpërmjet tyre ata pranojnë të informohen për të qenë më të sigurt gjatë aktit të parë ose për të mbajtur të gjallë një marrëdhënie të nisur. Të qenit ose jo në marrëdhënie seksuale me një person, sipas tyre lidhet me mundësitë për të pasur dikë që të pëlqen, të tërheq, që e dashuron ose që të krijon mundësinë për të kryer marrëdhënie seksuale.

Në vijim për pyetjen kërkimore; ***Sa ndikojnë institucionet sociale në sjelljen seksuale etike në radhët e studentëve në Shqipëri?***, rezultoi nga përgjigjet e analizuara se;

institucionet sociale deri më sot e kanë pasur të pamundur për të nxitur të rinjtë drejt një sjelljeje seksuale etike. Sipas intervistave të analizuara, rezulton se në shkollë si një prej institucioneve që pritet të jetë edukues, nuk mësohet sa duhet në lidhje me masat mbrojtëse, shtatzanitë e paplanifikuara, sëmundjet seksualisht të transmetueshme apo mbi preferencat seksuale (*kryesisht për to nuk është folur më shumë se njëherë gjatë gjithë studimeve në shkollën fillore apo të mesme, në lëndën e biologjisë, por këto tema kanë qenë të kufizuara dhe shpesh të anashkaluara nga mësuesit përkatës*) Në shkolla nuk flitet kurrë për marrëdhëniet me dëshirë reciproke mes partnerëve.

Në familje nuk ka informacion profesional, ai mbetet në trajtën e një morali se çfarë është e keqe ose e mirë për të bërë, në mënyrë që të jesh i pranueshëm nga të tjerët. Të rinjtë që pohojnë se mund të kenë marrë informacion mbi etikën e sjelljes janë në një numër shumë të vogël, 4% e tyre (*kryesisht informacioni kishte të bënte me shtatzaninë e paplanifikuar ose sëmundjet seksualisht të transmetueshme*). Feja, është institucion nga i cili studentët kanë pohuar se nuk merret asnjë lloj informacioni që ka të bëjë me prezervativët, marrëdhëniet me dëshirë reciproke, abortet, shtatzanitë e paplanifikuara, etj, tema të tilla mbeten tabu.

Ndërkohë, u pohua që edhe pse media dhe bashkëmoshatarët janë dy institucione prej të cilave marrin informacion mbi marrëdhëniet seksuale, ato nuk rezultuan institucione që iu japin të rinjve informacion mbi sjelljen seksuale etike. U pohua se mes bashkëmoshatarëve kryesisht me interes shihej të diskutohej për eksperiencë personale dhe jo për metoda kontraceptive (*madje meshkujt e gjykonin si të panevojshëm këtë shkëmbim informacioni*). Gjithashtu, median shumë pak prej tyre pohuan ta kenë përdorur për t'u informuar për të

mësuar mbi sjelljen seksuale etike, krahasuar me kërkimet e shumta që mund të kenë bërë në internet për të shuar kuriozitetin apo dhe nxitur kënaqësinë seksuale me video dhe imazhe pornografike (*u pohua se në lidhje me sëmundjet seksuale apo metodat kontraceptive, ka më shumë informacione në gjuhë të huaj sesa në shqip, gjë që e bënte të vështirë informimin për të rinjtë*). Gjithsesi, krahasuar me internetin, në televizion si media vizive, u theksua se merret më shumë informacion mbi etikën seksuale kryesisht në disa programe me tematikë sociale.

Pyetja e fundit kërkimore e ngritur për këtë studim është: ***A ka dallime gjinore esenciale në sjelljen seksuale të studentëve shqiptarë?*** Në analizimin e të dhënave cilësore, rezultoi se: nuk ka dallime gjinore për sa i përket sjelljes seksuale të femrave për çdo lloj të marrëdhënieve seksuale mbi të cilat u pyetën të dyja gjinitë; me dallimin e vetëm në frekuencën/shpeshtësinë e kryerjes së marrëdhënieve seksuale. Të dyja gjinitë nisin marrëdhënien e parë seksuale në një moshë të hershme, ku numri më i madh mbetet për femrat, si dhe që të dyja gjinitë që pohuan të kenë kryer marrëdhënie seksuale kanë pasur më shumë sesa një partner seksual gjatë vitit të fundit. Si meshkujt dhe femrat gjykojnë se virgjëria nuk është më një vlerë morale. Dallimet qëndrojnë në faktin se në pjesën dërrmuese femrat kanë pohuar se e ndërmarrin një akt seksual edhe nëse atyre nuk iu pëlqen (*kryesisht seksin anal dhe oral*), vetëm për të plotësuar dëshirën e partnerit, me bindjen se kështu marrëdhënia mes tyre do të zgjasë më shumë në kohë dhe do të jetë funksionale. Gjithashtu, femrat pohojnë se përdorimi i prezervativit është një detyrë e meshkujve, nuk janë ato të cilat duhen të kujdesen për këtë pjesë dhe se nëse kërkohet prej tyre linden paragjykimet dhe keqkuptime (*meshkujt përdorin më shumë prezervativë sesa femrat*). Gjatë

intervistave u vu re, që përdorimi i prezervativëve shikohet si një detyrë e meshkujve, ndërsa kontraktivët oralë nuk përdoren si shkak i efekteve anësore që ato mund të kishin në trupin e një femre (*kanceri në mitër, shtimi në peshë, të vjella gjatë ditës, rrit mundësinë e fertilitetit tek femrat*).

KAPITULLI VI: DISKUTIME

6. 1. Përfundime

Nga ky studim janë anketuar 1213 studentë dhe janë intervistuar 100 të tjerë nga të gjitha universitetet në vend, nga fshatra dhe qytete të ndryshme, ku në rastin e anketimeve me studentët, raporti i femrave dhe meshkujve ishte afërsisht 3:1, kjo sepse në sallat e лекsioneve dhe seminareve numri i femrave të pranishme ishte më i madh sesa i meshkujve dhe se metodologjia e përdorur për kampionin ishte rastësore dhe e shtresëzuar, e cila parashikon edhe shifra të tilla të mostrës së përzgjedhur. Ky raport ishte 1:1 në rastin e intervistave, i cili u mbajt nën kontroll në sajë të procedurës së përzgjedhur të kampionimit me kuoata, ku sipas karakteristikave që u përcaktuan më parë u zgjodh afërsisht një përqindje e barabartë mes femrave dhe meshkujve që do të merrnin pjesë në studim, përqindje, e cila ishte e njëjtë me popullatën e tërë.

Nga anketat dhe intervistat e realizuara me studentët si fillim u pa që studentët që ishin pjesë e studimit nëpërmjet anketave me pyetje të standardizuara, kanë dhënë më shumë informacion krahasuar me ata të cilët janë intervistuar ballë për ballë me diktofon. Gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave u vu re se sa më i garantuar anonimati, dhe sa më të veçuar studentët nga njëri-tjetri, jepnin aq më shumë të dhëna në lidhje me sjelljen seksuale dhe etikën. Natyrisht, këto nuk janë diferenca të dukshme, por gjendja emocionale e të rinjve që merreshin në intervistim me diktofon, shfaqej më e tensionuar, regjistrimi i zërit i bënte të ndjeheshin deri diku më të tensionuar sesa studentët që plotësonin pyetësorët. Por

në të dyja rastet, theksoj se janë mbledhur të dhëna mjaft domethënëse që ndihmuan në testimin e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore të këtij studimi.

Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i etikës së sjelljes seksuale si dhe impaktit që kanë institucionet sociale si: familja, bashkëmoshatarët, institucionet e arsimit , feja dhe media në sjelljen seksuale dhe etikën seksuale të studentëve në Shqipëri, duke bërë të mundur analizimin e faktorëve që sjellin ndryshim në modelimin e sjelljes seksuale etike të të rinjve, si dhe nevojën për një etikë të re seksuale.

Si përfundim, rezultoi se studentët shqiptarë, kanë sjellje seksuale të hapur dhe se flasin lirshëm për të, ku pohohet se ata kryejnë marrëdhënie seksuale vaginale, anale, orale, masturbim, lojëra seksuale me partnerët etj, por u pohuan edhe raste të orgjive *(marrëdhënie seksuale me më shumë sesa një partner njëherësh, një numër më i madh studentësh e pohojnë këtë në rastin e anketimeve sesa të intervistave)*.

Në pjesën dërrmuese pohuan që ishin heteroseksualë *(në rastin e 100 intervistave ballë për ballë, të gjithë rezultuan të jenë heteroseksualë)*, ndërkohë nga 1213 studentë të anketuar vetëm një rast u deklarua si homoseksual që ishte mashkull, dhe u pa një numër prej 14 studentësh të pohonin se ishin biseksualë, ku numri më i madh ishin studente femra. Rezultoi se studentët kanë paragjykime të forta në lidhje me preferencat homoseksuale apo biseksuale dhe kryesisht ishin meshkujt ata që shfaqnin hapur paragjykimet e tyre, nga ana tjetër, edhe në institucione sociale tematikat në lidhje me preferencat e tjera seksuale, veç heteroseksualitetit, paragjykohen dhe etiketohen. Sa më larg kryeqytetit aq më të thella

qëndrimet homofobike. Studentët janë të painformuar në lidhje me preferencat seksuale, si dhe kanë tendenca homofobike, si shkak i mungesës së informacionit dhe presionit social.

Në 405 raste, që është afërsisht gjysma e studentëve që kishin kryer marrëdhënie seksuale, pohuan se kanë pasur gjatë një viti akademik 2-3 partnerë seksualë. Meshkujt shfaqeshin më aktivë seksualisht, ku kryesisht rezultuan me numër më të madh partnerësh seksualë brenda një viti. Dhe po ashtu, u vu re se përsëri meshkujt ishin ata që pohuan se kanë pasur më shumë sesa 1 partnere seksuale paralel, me të cilat kryenin marrëdhënie seksuale, por duhet theksuar se edhe femrat, pavarësisht se në një përqindje dhe shkallë më të vogël, kanë pohuar të kenë pasur marrëdhënie seksuale me 2 meshkuj paralel, çfarë do të thotë se monogamia nuk është më një koncept i cili njehsohet me të qenit grua. Si meshkujt edhe femrat në rast se nuk pëlqenin partnerin aktual seksual, preferonin ndarjen për të krijuar më tej mundësi për të pasur një partner tjetër, i cili shihej si i duhuri për ta. Gjithsesi, numri i partnerëve seksualë gjatë jetës së një femre pritej të ishte më i vogël sesa i meshkujve.

Mosha kur është kryer marrëdhënia e parë seksuale ishte 13-vjeç, ku u vu re se femrat marrëdhënien e parë seksuale në numrin më të madh të tyre e kishin kryer në moshat 13, 14, 15 -vjeç, krahasuar me meshkujt që marrëdhënien seksuale në një numër më të madh të tyre e kishin kryer në moshën 17-18 vjeç. Rezultoi se nga të dyja metodat e mbledhjes së të dhënave për studentët që morën pjesë në këtë studim, ishin femrat ato që në një moshë më të hershme sesa djemtë nisnin aktin e parë seksual, gjithmonë nëse mbështetemi tek shpërndarja e numrit të rasteve femra dhe meshkuj. Me nisjen e studimeve të larta studentët si femra apo meshkuj rrisnin ndjeshëm përfshirjen në aktivitetin seksual, krahasuar me

periudhën e studimeve të mesme, të qenit larg familjes dhe koha më e madhe që frekuentonin me bashkëmoshatarët rriste mundësinë për aktivitet më të lartë seksual.

Studentët shqiptarë të anketuar, që pohuan të kenë kryer marrëdhënien e parë seksuale ishin 818 raste, e ndërkohë që 395 nuk kishin kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale. Në rastin e intervistave, rezultoi se 73 studentë kishin kryer marrëdhënie seksuale, dhe 27 nuk e kishin kryer aktin e parë seksual. Në të dyja rastet virgjëria ishte një zgjedhje e tyre, ose një sjellje e cila ishte kushtëzuar nga fakti se nuk kishin gjetur partnerin e duhur që t'i tërhiqte drejt një akti seksual dhe jo morali i institucioneve apo frika nga gjykimet e jashtme, çfarë nënkupton se virgjëria nuk konsiderohej një vlerë për ta, as në rastin e vajzave dhe as të djemve dhe se numri i studentëve femra dhe meshkuj të virgjër nuk rezultoi të kishte diferenca.

Në pjesën dërrmuese të rasteve, studentët pohuan se kishin informacion të mjaftueshëm në lidhje me marrëdhëniet seksuale (*ku me marrëdhënie seksuale i referoheshin performancës gjatë aktit seksual*), dhe se këto informacione ata i merrnin kryesisht nga partnerët seksualë, nga media (*ku media e preferuar ishte interneti si në rastin e anketave edhe të intervistave*), dhe nga shokët dhe shoqet e tyre. Familja, institucionet, arsimi dhe ato fetare rezultuan që nuk i kishin informuar të rinjtë në lidhje me seksin dhe sjelljen seksuale.

Rezultoi se sa më e arsimuar të ishte nëna, aq më të informuar ishin studentët mbi marrëdhënien seksuale, ndërkohë që roli i babait në lidhje me edukimin dhe bisedat me tematikë seksuale ishte i munguar (*joprezent në informimin e fëmijëve mbi marrëdhëniet seksuale dhe etikën e sjelljes seksuale*), dhe studentët e shihnin si aspak komode të

diskutuarit me të si shkak i autoritetit të tij në familjet. Statusi ekonomik i familjes ishte një faktor tjetër që ndikonte në sjelljen seksuale të të rinjve, ku sa më në gjendje të mirë ekonomike, aq më i largët ishte roli i babait në edukim.

Në lidhje me etikën e sjelljes seksuale, pavarësisht faktit që studentët në pjesën më të madh kanë kryer marrëdhënie seksuale, ku as konceptet e së mirës dhe së keqes në seks ndërtuar mbi bazat e moralit të shoqërisë nuk kanë mundur të frenojnë sjelljen seksuale dhe aktin e parë seksual, sërish ata nuk përdorin masa mbrojtëse, madje përveçse ka mungesë informacioni, në shumë raste vihet re një keqinformim i tyre dhe paragjykime me baza gjinore (*si prezervativi detyrë e meshkujve, jo e femrave, dhe kontraktivët sjellin kancer ose fertilitet*).

Studentët nuk janë të ndërgjegjshëm për pasojat e kryerjes së marrëdhënieve seksuale, pa përdorur asnjë masë mbrojtëse, por bazohen mbi besime subjektive të higjienës seksuale të partnerëve apo mbështetur në kohëzgjatjen e marrëdhënies dhe dashurinë mes partnerëve.

Gjasat për dhunë seksuale ndaj femrave, janë më të mëdha për faktin se mes partnerëve kur flitet për respektimin e dëshirave seksuale gjatë aktit seksual, femrat ndjehen të detyruara të kryejnë sjellje të caktuara seksuale si ato orale dhe anale, me pretendimin se dëshirat seksuale të meshkujve janë më të mëdha sesa të femrave, dhe se në rast se nuk plotësohen ata mund të kërkojnë ndarjen prej tyre. Mungesa e informacionit që aftëson të rinjtë për barazi gjinore dhe respektimin e të drejtave dhe dëshirave të partnerëve seksualë mbështetur në dëshirat personale, çon në rritje të dhunës dhe abuzimit ndaj studenteve femra.

Që në hapat e parë të studimit, u ngritën pesë hipoteza studimore, të cilat patën si qëllim analizimin e marrëdhënieve mes variabëlve të pavarur dhe të varur të këtij studimi për të përmbushur kështu edhe qëllimin dhe objektivat e studimit, ku; ka rezultuar se në të gjitha rastet të dhënat treguan marrëdhënie të qëndrueshme statistikore që tregonin një vlefshmëri të lartë të marrëdhënieve mes variabëlve, duke marrë në konsideratë vlefshmërinë në rastin e variabëlit të pavarur *Besim Fetar*, i cili në një rast ka rezultuar me një nivel alfa më të madh se 5% (*rastit ku testohet morali fetar dhe ndikimi në sjelljen seksuale*). Në fakt, edhe për studime të tjera të kryera nga shumë autorë në vende të zhvilluara ka rezultuar që besimi fetar dhe sjellja seksuale nuk kanë një marrëdhënie të qëndrueshme mes tyre. Madje, feja nuk ka ndikim në sjelljen seksuale të të rinjve, përveç rasteve kur feja në vetvete është një kulturë makro për një shoqëri të caktuar, por nuk kanë munguar edhe studime që pohojnë se feja dhe besimi fetar i të rinjve e frenon sjelljen seksuale.

Por le të marrim me radhë hipotezat dhe pyetjet kërkimore të këtij studimi për të parë në mënyrë të përmbledhur konkluzionet e tij, ku hipoteza e parë, e dytë dhe e tretë e studimit u mbështetën në pyetjen kërkimore: *A ndikon morali i shoqërisë dhe institucionet sociale në sjelljen seksuale të studentëve shqiptarë?*, nga ku u ngritën hipotezat në vijim;

H₁:Moraliteti që institucionet sociale përdorin për edukimin seksual të të rinjve nuk ndikon frenimin e sjelljes seksuale, pati si qëllim që të vërtetojë ndikimin që kanë bisedat me përmbajtje morale në familje, shkollë, shoqëri dhe në institucionet fetare në lidhje me seksin dhe marrëdhëniet seksuale, nga ku rezultoi sesi familja, shkolla, dhe shoqëria e studentëve (*bashkëmoshatarët*), kishin ndikim negativ, çfarë do të thotë që së pari, në këto institucione ekzistonin bisedat me baza morale mbi seksin dhe marrëdhëniet seksuale, por

që kjo formë komunikim nuk bënte që të frenoheshin marrëdhëniet seksuale të studentëve, por përkundrazi ishin me një mesatare më të lartë sesa në rastet kur flitej hapur me të rinjtë për seksin dhe marrëdhëniet seksuale. Çfarë do të thotë se, të folurit me baza morale, mbi atë çfarë një shoqëri konsideron si të keqe apo të mirë në marrëdhënien seksuale, nuk çon domosdoshmërisht në frenim të marrëdhënieve seksuale. Madje nëse flitej hapur me studentët, rezultoi se marrëdhënia seksuale kryhej në një moshë më të vonë. Në këtë rast u vërtetua se morali që institucionet sociale përdorin për të edukuar të rinjtë nëpërmjet frenimit të sjelljes seksuale nuk ndikonte në sjelljen seksuale dhe shtyrjen e aktit të parë seksual në një moshë më të madhe ose deri në martesë. Gjithsesi duhet theksuar, se nuk rezultoi e njëjta marrëdhënie mes komunikimit mbi baza morale në institucionet fetare dhe sjelljes seksuale, ku rezulton që sa më shumë moral diktohet në institucionet fetare, aq më shumë kishte gjasa që studentët të frenonin marrëdhëniet seksuale, duke marrë në konsideratë faktin se numri i studentëve që pohuan të jenë besimtarë fetarë është shumë herë më i vogël sesa numri i studentëve që nuk rezultojnë të jenë besimtarë dhe që besimi fetar për ta nuk është i rëndësishëm në vendimet që marrin në lidhje me sjelljen seksuale.

Në hipotezën e dytë të këtij studimi u pohua; ***H₂: Roli i prindërve në sjelljen seksuale të të rinjve ka rënë ndjeshëm si shkak i influencës së madhe që kanë bashkëmoshatarët dhe media,*** nga ku rezultoi se prindërit kishin ndikim negativ në sjelljen seksuale. *Së pari,* rezultoi se në familjet shqiptare të rinjtë nuk marrin informacion mbi marrëdhëniet seksuale, sa më pak flitej në familje për seksin, aq më shumë përfshirje në marrëdhëniet seksuale kishin studentët. Duhet theksuar që edhe nëse ndodhnin biseda me tematikë të tillë në familje, ato kryheshin me nënat, të cilat i këshillonin fëmijët duke u mbështetur në baza

morale dhe në prani të personave të tjerë të afërm. Ishin motra ose vëllezër më të mëdhenj nga ku studentët pohonin se kishin marrë më shumë informacion. Gjinia e fëmijës nuk ishte domethënëse në rritjen ose frenimin e bisedave mbi marrëdhëniet seksuale, qoftë me nënën ose babain, por motrat preferonin dhe merrnin informacion nga motrat, dhe kryesisht vëllezërit nga vëllezërit më të mëdhenj.

Media dhe bashkëmoshatarët ishin dy variabëlët që treguan një lidhje të fortë statistikore dhe, që për të dyja metodat e përdorura në këtë studim, u pa qartë se këto dy institucione ndikojnë në sjelljen seksuale, ku sa më shumë informacion nga media dhe bashkëmoshatarët ka për seksin dhe marrëdhëniet seksuale, aq më shumë aktiv seksualisht paraqiteshin studentët. Gjithsesi, kryesisht nga intervistat ballë për ballë, studentët kanë pohuar se çon më shumë drejt një akti seksual pëlqimi mes dy partnerësh, tërheqja seksuale e mundshme mes tyre, sesa presioni që mund të kenë media apo bashkëmoshatarët. Ky rezultat është i vërtetë edhe për një numër të konsiderueshëm studimesh të kryera në vende të ndryshme të botës nga shumë studiues të tjerë.

Në hipotezën e tretë të studimit u testua marrëdhënia që kanë institucionet e arsimit dhe fesë me sjelljen seksuale të studentëve, ku u pohua; ***H₃: Institucionet e arsimit dhe besimi fetar (institucionet fetare) nuk ndikojnë në sjelljen seksuale të studentëve shqiptarë,*** ku në fakt rezultoi një ndikim negativ i të dyja institucioneve në sjelljen seksuale të studentëve. Fillimisht u pa që në institucionet e arsimit në Shqipëri, studentët pohuan që të kenë marrë një informacion të limituar në lidhje me marrëdhëniet seksuale. Madje në pjesën dërrmuese, u pohua që në shkolla mund të jetë folur jo më shumë se një herë vetëm për prezervativët, sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe më shumë për anatomicën e

njeriut dhe funksionet riprodhuese të organeve gjenitale. Edhe në institucionet e arsimit, ku pritët që mësuesit të jenë profesionistë dhe të bazohen në programet ekzistuese për edukimin seksual, me gjithë cungimin dhe mangësitë që mund të kenë, u vu re që edukimi seksual në numër rastesh të konsiderueshëm kishte baza morale, dhe shpesh nuk flitej për tema të tilla.

Nga pyetjet e ngritura për këtë seksion u pa që në Shqipëri programet e edukimit seksual mbështeten në *programe abstinencë (frenimit të marrëdhënieve seksuale)* dhe lënda nga ku i marrin këto informacione për pjesën dërrmuese kishte qenë biologjia e klasës së shtatë. Në këto programe nuk ka informacion të gjithanshëm për marrëdhëniet seksuale, dhe nxënësve nuk u jepen informacione të duhura e profesionale për shumë çështje të tilla si preferencat seksuale, respektimi i partnerëve gjatë aktit seksual, apo informacione të tjera që kanë të bëjnë me seksin anal, oral dhe vaginal, problematikat dhe rreziqet e kryerjes së orgjive apo për kënaqësinë e marrëdhënieve seksuale si aktivitet human i pashmangshëm, për ndryshimet biologjike, për orgazmën dhe koncepte të tjera që japin informacion në lidhje me anët pozitive të marrëdhënieve seksuale. Programet e edukimit seksual që përdoren në shkollat shqiptare, nuk mundësojnë barazi gjinore në sjelljen dhe etikën seksuale të studentëve.

Kësisoj, këto programe dhe këto mënyra të mësimdhënies për edukimin dhe komunikimin seksual me nxënësit, rezultuan që të kenë një impakt negativ në sjelljen seksuale; sa më pak informacion merrej në shkolla për marrëdhëniet seksuale, aq më shumë studentët ishin përfshirë në marrëdhënie seksuale. Programet e edukimit seksual nuk kishin asnjë lloj

ndikimi në etikën e sjelljes seksuale të të rinjve, dhe vlerat rezultuan të ishin domethënëse dhe të qëndrueshme statistikisht.

Institucioni fetar, gjithashtu, rezultoi të kishte një marrëdhënie negative me sjelljen seksuale të studentëve, por në këtë rast përqindja e ndikimit ishte shumë e vogël -0,024, afërsisht 2%, çfarë do të thotë se ndikimi i këtij variabëli duhet marrë me rezerva, për faktin se ka një përqindje thuajse të pandjeshme dhe se vlefshmëria e marrëdhënieve mes variabëlve tregon që ka një lidhje të fortë të qëndrueshme statistikisht mes sjelljes seksuale dhe ndikimit të institucionit fetar. Natyrisht, theksoj se në analizë janë marrë vetëm ata studentë që kanë pohuar të jenë besimtarë fetarë, të një feje të caktuar, të cilët frekuentojnë institucionet fetare të paktën një herë në muaj, dhe që për ta besimi fetar është i rëndësishëm.

U pa me rëndësi të studiohej dhe analizohej, nëse ka ndonjë dallim në ndikimin që kanë institucionet sociale tek personat që nuk kanë kryer asnjëherë marrëdhënie seksuale, ku ngrit pyetja kërkimore: *Cilët institucione sociale ndikojnë më shumë tek të rinjtë që janë në marrëdhënie seksuale, në dallim me të rinjtë që nuk kanë kryer ende aktin e parë seksual?*

Nga analizimi i të dhënave rezultoi se familja (*kryesisht për vajzat ishte shumë e rëndësishme marrëdhënia me nënat e tyre, për rrjedhojë ata ndikoheshin nga mendimet dhe vendimet e nënave për jetën seksuale të të bijave edhe pse pohuan se nuk kishte komunikim të hapur mbi tematikat e marrëdhënieve seksuale*) dhe institucionet e arsimit (*sa më shumë edukim seksual në shkollë, aq më i vonë akti seksual*) tregojnë të kenë një impakt pozitiv tek studentët që nuk kishin kryer ende marrëdhënien e parë seksuale.

Media dhe bashkëmoshatarët tek ky grup studentësh kishin impakt negativ, që do të thotë sa më pak biseda me bashkëmoshatarët për seksin dhe sjelljen seksuale, aq më shumë shtyhet akti i parë seksual (*duhet theksuar se studentët kishin bashkëmoshatarë me eksperiencë thuajse të njëjta seksuale, ku të virgjrit kishin shokë/shoqe të ngushtë një person që po ashtu ishte i virgjër*), dhe sa më pak orë që kalohej duke ndjekur median e referuar të studentëve (*internetin dhe TV*), aq më shumë rritej moshë e aktit të parë seksual. Edhe në këtë rast, të dhënat për ndikimin e institucionit fetar tek të rinjtë që nuk kishin kryer marrëdhënie seksuale, rezultoi të ishte negativ. Po të shihet me vëmendje besimi fetar dhe përkatësisht tek ata të rinj që pohonin se ishin frekuentues të institucioneve fetare, thuajse në të gjitha rastet, si për sjelljen seksuale, etikën apo virgjërinë, ekziston një marrëdhënie negative mes variabëlve.

Hipoteza e katërt u ndërtua mbështetur mbi pyetjen e kërkimit se *sa ndikojnë institucionet sociale në modelimin e sjelljes seksuale etike në radhët e studentëve në Shqipëri?*, ku në formë hipotetike u pohua, ***H₄: Institucionet sociale (familja, bashkëmoshatarët, arsimi, feja dhe media) nuk ndikojnë në modelimin e një sjelljeje seksuale etike në radhët e studentëve në Shqipëri.*** Nga analiza rezultoi se asnjëri prej institucioneve sociale nuk ndikojnë në modelimin e një sjelljeje seksuale etike tek studentët shqiptarë. Sa më pak që flitet në këto institucione në lidhje me përgjegjshmërinë gjatë aktit seksual, masat mbrojtëse, respektimin e partnerit seksual, nisjen e aktit seksual me dëshirë reciproke nga të dy partnerët (etika e sjelljes seksuale në studim), aq më shumë ka studentë të papërgjegjshëm për problematikat që mund të sjellë akti seksual pa masë mbrojtëse, dhe aq më shumë femra që përfshihen në marrëdhënie seksuale anale dhe orale pa dëshirën e tyre,

por nga frika e humbjes së partnerit seksual ose si shkak i dhunës psikologjike të përdorur nga meshkujt.

Sërish në rastin e institucionit fetar, rezulton një impakt negativ. Por nëse shikojmë rezultatet statistikore, përpos faktit që masa e ndikimit është e vogël, niveli i alfës së vëzhguar është më i madh se 5%, madje në këtë rast është afërsisht 9%. Sipas statistikave përshkruese ka rezultuar se në institucionet fetare të folurit për prezervativët është mëkat, ndaj për këto tema nuk flitet asnjëherë. Kjo vërteton edhe një herë se ky variabël i pavarur *Besim Fetar*, duhet të merret me rezerva për vërtetësinë e tij, për ndikimin dhe mundësinë që ka për modeluar sjellje seksuale etike. Si në rastin e marrëdhënies me sjelljen seksuale, ashtu edhe në rastin e marrëdhënies me etikën e sjelljes seksuale, besimi fetar ka impakt negativ, që do të thotë se sa më pak flitet për marrëdhëniet seksuale dhe etikën e sjelljes, aq më shumë të përfshirë në marrëdhënie seksuale joetike rezultojnë studentët shqiptarë. Ky variabël i pavarur tregon qartë që nuk ndikon në sjelljen seksuale dhe etikën e studentëve në radhët e studentëve shqiptarë.

Në hipotezën e pestë dhe të fundit për këtë studim, e cila u mbështet në pyetjen kërkimore; A ka dallime gjinore në sjelljen seksuale të studentëve në Shqipëri?, u pohua; ***H₅. Nuk ekzistojnë dallime gjinore esenciale në sjelljen seksuale të studentëve në Shqipëri.*** Rezultoi se nuk ka dallime esenciale në sjelljen seksuale të studentëve femra apo meshkuj, të dyja gjinitë kryejnë marrëdhënie seksuale vaginale, anale, orale, ose edhe orgji. Dallimi mund të qëndrojë në frekuencën e marrëdhënieve seksuale, që rezulton se janë meshkujt ata që pohojnë të kenë kryer më shpesh marrëdhënie seksuale të çdo lloji në krahasim me femrat.

Ajo çfarë e bën sjelljen e tyre të dallueshme është masturbimi, ku në pjesën dërrmuese të meshkujve pohohet se masturbojnë mesatarisht shpesh, e ndërkohë tek femrat kjo mesatare është mes asnjëherë dhe rrallë, dhe këto janë rezultate të ngjashme në të dyja metodologjitë e përdorura për mbledhjen e të dhënave, si në anketa edhe në intervistat ballë për ballë.

Ndërkohë, nuk rezultojnë të njëjtat të dhëna për sa i përket etikës së sjelljes seksuale të femrave dhe meshkujve, sepse femrat paraqitën shkallë më të lartë të përfshirjes në marrëdhënie seksuale pa dëshirën e tyre, gjë që tregon se gjasat për dhunë seksuale ndaj femrave janë të mëdha si shkak i stereotipave dhe pabarazive gjinore (*në intervista theksohej se shpesh ata bënin një akt të caktuar seksual vetëm për ti plotësuar dëshirën partnerit të tyre seksual ose nga frika mos partneri kërkonte ndarjen si shkak i mosplotësimin të dëshirave të tij seksuale*). Ndërsa në lidhje me masat mbrojtëse, janë meshkujt që krahasuar me femrat pohojnë se përdornin shumë më shumë prezervativët gjatë një akti seksual, ndërkohë që për të dyja gjinitë ka keqinformim në lidhje me masat mbrojtëse si prezervativët apo kontraktivët (*prezervativët shikohen si detyrë e meshkujve, ndërkohë që kontracepsioni oral shton shanset për fertilitet, kancer në mitër*). Shkencërisht, paragjykimet në lidhje me përdorimin e kontraktivëve, në dijeninë time nuk janë reale.

Në përmbledhje të të gjithë këtij studimi, rezulton se është mjaft shqetësues realiteti i sjelljes dhe etikës seksuale të studentëve shqiptarë, që pavarësisht se gjenden në valën e një revolucionit seksual, ku sjellja seksuale është e hapur, mundësitë për t'u informuar në lidhje me seksin dhe marrëdhëniet seksuale janë të pafundme. Për rrjedhojë, edhe pse mendësitë e të rinjve në lidhje me virgjërinë dhe marrëdhëniet seksuale kanë ndryshuar në krahasim me ato të para viteve '90, sërish format e edukimit të brezave të rinj në lidhje me edukimin për

një etikë seksuale e cila i shkon përshtat sjelljes seksuale të studentëve të vitit 2015, është inkoherente dhe jo realiste, për atë kohë sa ende mbështetet në bazat e të moralshmes dhe morales së trashëguar nga shoqëria e mbyllur e para viteve '90.

Në këtë mënyrë, institucionet sociale në vend, përfshirë familjen, institucionet e arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm, bashkëmoshatarët e studentëve, institucionet fetare bashkë me median, duket qartë se e kanë të pamundur që të përmbushin detyrën për një edukim seksual demokratik të të rinjve mbështetur në etikën e re, të një sjellje seksuale të re, në një realitet shqiptar të ri. Është e qartë që kohët e reja kërkojnë moral dhe etikë të re seksuale.

6. 2. Rekomandime

Ky studim ka një shtrirje të gjerë, që analizon pesë institucione sociale kryesore të shoqërisë tonë dhe impaktin e tyre në sjelljen dhe etikën seksuale, kjo për shkak se kanë munguar studime të tilla. Natyrisht, shihet e udhës që në studime të tjera fokusi i studimit të jetë më i ngushtë, kryesisht të jetë i përqendruar në impaktin që ka njëri prej institucioneve të këtij studimi, qoftë familja, arsimi, bashkëmoshatarët, feja apo media, për të nxjerrë në pah të gjithë gamën e problematikave nëpërmjet një analize që identifikon veç impaktit edhe shkaqet dhe pasojat e mungesës së një edukimi seksual të ri të mbështetur në etikën e re seksuale.

Problematikat e edukimit seksual të brezave të rinj kanë nevojë të fokusohen, jo vetëm tek studentët në universitete, por edhe ata të shkollave fillore dhe të arsimit të mesëm, duke dhënë mundësinë e një adresimi më të mirë të problematikës që nxit hartimin e politikave dhe programeve edukative në shkollat shqiptare, e duke i adaptuar ato sipas karakteristikave të çdo grupmoshe të caktuar. Natyrisht që është e rëndësishme që të ketë përfshirje të njëjtë të meshkujve dhe femrave në studim në varësi të përqindjeve të popullatës për studim, duke u përzgjedhur mënyrat e duhura të procedurës së kampionimit.

Natyra dhe karakteristikat që ka çdo institucion i analizuar në këtë studim si variabël i pavarur, nuk mundet që të realizojnë me profesionalizëm edukimin seksual të bazuar në një etikë të re seksuale. Kësisoj, media, feja apo bashkëmoshatarët e kanë të vështirë një mision të tillë, për shkak se media fokusohet tek shitja, promocioni, promovimi i subjekteve dhe tematikave që sigurojnë ndjekës të mëdhenj në numër, pavarësisht nëse tematika është etike

dhe edukative për brezat e rinj. Fokusi kryesor i saj lidhet më shumë me marketingun sesa me edukimin. Gjithsesi, edhe pse nuk e ka qëllim kryesor, ajo duhet shfrytëzuar për të përçuar mesazhe të rëndësishme tek të rinjtë, ku nëpërmjet një studimi tjetër në të ardhmen e shpejtë, të analizohet dhe testohen mundësitë për shtimin e programacioneve që kanë të bëjnë me informimin e të rinjve dhe mbarë popullsisë për seksualitetin, marrëdhëniet seksuale dhe atë çfarë është e mira të kuptojmë me etikë seksuale në një kohë moderne të cilën po jetojmë. Konceptimi i programeve televizive me tematika të ndryshme sociale që synojnë kryesisht edukimin seksual të të rinjve, fokus mbi përdorimin e masave mbrojtëse gjatë aktit seksual, programe informuese mbi preferencat seksuale, me qëllimin e nxitjes së tolerancës dhe pranimin e të tjerëve, pavarësisht preferencave homoseksuale, biseksuale apo heteroseksuale. . etj, ndërgjegjësimin e shoqërisë për të kryer vizita periodike tek mjekët specialistë të shëndetit seksual, etj, si video, imazhe apo edhe rubrika e website në internet të dedikuara edukimit seksual të të rinjve dhe mbarë shoqërisë, për të bërë të mundur ndërgjegjësimin, edukimin, informimin dhe sensibilizimin e shoqërisë mbi çështjet e shëndetit seksual dhe etikës seksuale në tërësi.

Media mbetet një mundësi e mirë për ndërhyrje, edhe për faktin se kryesisht interneti dhe televizioni, të cilët rezultuan dy mediat më të preferuara të të rinjve, mundet që të jenë më afër nevoja reale të të rinjve. Natyrisht, tematikat mbi marrëdhëniet seksuale dhe etikën e sjelljes seksuale kërkojnë një trajtim profesional, ku një hap i mirë mund të jetë vlerësimi i mundësive që ka çdo universitet të krijojë hapësira në Websitet e tyre, për të shfaqur e shkarkuar video me këshilla profesionale në lidhje me nevojat e të rinjve për njohuritë mbi marrëdhëniet seksuale, demonstrimin e përdorimit të masave mbrojtëse për seks të sigurt

dhe edukimin seksual në tërësi. Kjo mund të jetë një risi për rastin e Shqipërisë, që natyrisht mund të ketë impaktin e duhur, nëse gjithçka mbështetet mbi baza profesionale dhe etike.

Ndërkohë feja që e ngre edukimin, qoftë seksual ose jo, mbi baza morale e dogmatike, sërish e ka të vështirë që të orientojë jetën seksuale të të rinjve drejt etikës së re. Po ashtu edhe bashkëmoshatarët janë një grup social, të cilët nuk i orientojnë dot bisedat mes tyre në edukimin seksual profesional dhe etikën seksuale, për aq kohë sa kjo mungon në institucionet bazë të edukimit si familja dhe shkolla. Gjithsesi ky grup social janë një hallkë e zinxhirit shoqëror, që natyrisht nëse ndërhyhet në një institucion, impakti do të jetë i ndjeshëm edhe mes bashkëmoshatarëve, të cilët i orientojnë bisedat dhe komunikimin seksual bazuar mbi atë çfarë e tërë shoqëria ofron për ta.

Mbetet me rëndësi që në studime të ardhshme t'i kushtohet vëmendje maksimale edukimit seksual në institucionet arsimore, orientimit të tij drejt një qasjeje të re mbështetur mbi nevojat imediate për shtimin e përgjegjshmërisë gjatë marrëdhënieve seksuale, duke u mbështetur kryesisht në programet gjithëpërfshirëse të edukimit seksual, të cilat mund të aftësojnë të rinjtë të jenë të ndërgjegjshëm për hapat që ndërmarrin gjatë përfshirjes në marrëdhënien e parë seksuale dhe më tej. Lind nevoja për një tekst të posaçëm për edukimin seksual, trajnime të vazhdueshme me stafet akademike. Këto programe duhet të aftësojnë të rinjtë të orientohen drejt barazisë gjinore dhe respektit reciprok të partnerit seksual. Nevojiten programe që aftësojnë të rinjtë të jenë pranues ndaj preferencave seksuale të të tjerëve, që mund të jenë të ndryshme me të tyret, duke zbutur kështu tendencat homofobike në radhët e tyre, e duke përshtatur modelin e edukimit dhe komunikimit seksual me nevojat e kohës dhe të moshës së tyre.

Nuk duhet harruar se të japësh edukim seksual për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë, nuk është një sfidë e lehtë. Ajo kërkon aftësi të caktuara komunikuese, të cilat mund të ndihmojnë një mësues që të çojë në formën dhe cilësinë e duhur çdo informacion që lidhet me seksin dhe edukimin seksual. Është e nevojshme gjithashtu që në studime të tjera të identifikohen mundësitë dhe aftësitë që kanë mësuesit tanë dhe stafet akademike në shkolla për të ofruar një edukim seksual cilësor, gjithëpërfshirës dhe etik, ku duke identifikuar problematikat, qoftë në tekste e programe shkollore apo edhe në metodologjinë e mësimit mund të adresohen më mirë nevojat për ndryshime dhe ndërhyrje nëpërmjet trajnimesh, seminaresh, konferencash e formave të tjera akademike që lehtësojnë dhe përmirësojnë punën e edukatorëve seksualë, duke rritur mundësinë për një edukim seksual demokratik, kreativ dhe etik.

Familja është edhe një institucion tjetër, i cili në bashkëpunim me institucionet e arsimit, shkollat dhe mësuesit, mundet që të risi ndikimin në sjelljen seksuale të të rinjve. Natyrisht është e vështirë që të ndryshosh qëndrimin dhe moralin e çdo familjeje në lidhje me marrëdhëniet seksuale dhe format e edukimit seksual të fëmijëve, dhe po aq e vështirë të besohet që çdo familje, nënë apo baba ka mundësitë profesionale dhe njohuritë e duhura për edukimin e të rinjve mbështetur në një etikë të re. Ndaj, sërish kërkohen të identifikohen forma të reja bashkëpunimi mes prindërve dhe mësuesve si edukatorë seksualë për të shkuar drejt arritjes së qëllimit për një shoqëri më të ndërgjegjshme seksualisht, më të hapur dhe të mbështetur në një etikë të re seksuale.

BIBLIOGRAFIA

- Adamczyk, A. , & Hayes, B. E. (2012). Religion and Sexual Behaviors: Understanding the Influence of Islamic Cultures and Religious Affiliation for Explaining Sex Outside of Marriage. *American Sociological Review*, 77(5) 723–746.
- Adler, N. E. , Kegeles, S. M. , Irwin, C. E. , & Wibbels, C. (1990). Adolescent contraceptive behavior: An assessment of decision processes. *Journal of Pediatrics*, 116, 463-471.
- Agatha, S. (2010). *Gender and Modernity in Central Europe: The Austro- Hungarian Monarchy and Its Legacy*. Ottawa: University of Ottawa Press.
- Ajzen, I. , & Fishbein, M. (1980). *Understanding attitudes and predicting social behavior*. Englewood Cliffs, NJ: PrenticeHall.
- Alan Guttmacher Institute. (1994). *Sex and America's teenagers*. New York: Author.
- Ali, H, K. , & Naidoo, A. (1999). Sex education sources and attitudes about premarital sex of Seventh Day Adventist youth. *Psychological Reports*, 84, 302-312.
- Altemeyer, B. , & Hunsberger, B. (1992). Authoritarianism, religious fundamentalism, quest, and prejudice. *International Journal for the Psychology of Religion*, 2, 113–133.
- Allgeier, E. R. , & Allgeier, A. R. (2000). *Sexual Interactions (5th. ed)*. Boston: Houghton Mifflin Company.
- American Social Health Association. (1996). *Gallup study: Teenagers know more than adults about STDs*. Durham, NC: Author.
- Anagurthi, C. , Johnson, A. C. , & Somers, L. Ch. (2012). Individual and Family Correlates of Adolescents' Sexual Behavior: Multiethnic Findings. *Michigan Journal of Counseling*, (7), 14-18.

- Ansuini, C. G. , Fiddler-Woite, J. , & Woite, R. S. (1996). The source of accuracy, and impact of initial sexuality information on lifetime wellness. *Adolescence*, 31, 283-289.
- Argys, L. M. , Rees, D. I. , Averett, S. L. & Witoonchart. B. (2006). Birth order and risky adolescent behavior. *Economic Inquiry*, 44(2), 215-233.
- Arnett, J. (1995). Adolescents' uses of media for self-socialization. *Journal of Youth and Adolescence*, 24(5), 519-534.
- Arnett, J. (2000). Emerging adulthood: A theory of development from the late teens through the twenties. *Am Psychology* 50, 437-477.
- Arnett, J. (2007). *Adolescence and emerging adulthood: A cultural approach*. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall.
- Aubrey, J. , Harrison, K. , Kramer, L. , & Yellin, J. (2003). Variety versus timing: Gender differences in college students' sexual expectations as predicted by exposure to sexually oriented television. *Communication Research*, 30, 432–460.
- AVERT (2006). *Sex education that works*, (Vol. 3 Ed.). Handbook of child psychology: Vol. 3. Social, emotional, and personality development (3rd ed. , pp. 463–552). New York: Wiley
- Marrë në: <http://www.avert.org/sexedu.htm>. (Parë më: 09.06.2012).
- Bailey, J. , Fleming, Ch. , Henson, J. , Catalano, R. , & Haggerty, K. (2008). Sexual Risk Behavior 6 Months Post-High School: Associations with College Attendance, Living with a Parent, and Prior Risk Behavior. *Journal of Adolescent Health*, 42, 573- 579.
- Baldwin, S. E. & Baranoski, M. V. (1990). Family interactions and sex education in the home. *Adolescence*, 25, 573–582.
- Ballard, Sh. M. , & Gross, K. H. (2009). Exploring Parental Perspectives on Parent-Child Sexual Communication. *American Journal of Sexuality Education*, 4, 40–57.

- Bandura, A. (1973). *Aggression a Social Learning Analysis*. Englewood Cliffs, NJ: Prentice- Hill.
- Bang, E. , Hall, M. E. L. , Anderson, T. L. , & Willingham, M. M. (2005). Ethnicity, acculturation, and religiosity as predictors of femalecollege students role expectations. *Sex Roles*, 53, 231–237.
- Baran, S. J. (1976). How TV and Film Portrayals Affect Sexual Satisfaction in College Students. *Journalism Quarterly*, 53, 468-473.
- Bartlrtrt, J. E, Kotrilik, J. W. , & Higgins, C. C. (2001). Determining appropriate sample size in survey research. *Information technology, Learning and Performance Journal*. Vol. 19. No. 1, 43-50.
- Barriga, A. Q. , et al. (2001). *Test Manual for the How I Think Questionnaire*. Champaign, IL:Research Press.
- Bassett, R. L. , Smith, H. L. , Newell, R. L. , & Richards, A. H. (1999). Thoushalt not like sex: Taking another look at religiousness and sexualattitudes. *Journal of Psychology and Christianity*, 18, 205–216.
- Baumer, E. P. , & South, S. J. (2001). Community effects on youth sexual activity. *Journal of Marriage and Family*, 63, 540-554.
- Baxter, R. L. , De Riemer, C. , Landini, A. , Leslie, L. , & Singletary, M. W. (1985). A content analysis of music videos. *Journal of Broadcasting and Electronic Media*, 29(3), 333–340.
- Bazerman, M. H. , & Gino, F. (2012). Behavioral Ethics: Toward a Deeper Understanding of Moral Judgment and Dishonesty. *Annual Review of Law and Social Science*, 8, 85–104.
- Beal, E. W. & Hochman, G. (1991). *Adult Children of Divorce: Breaking the Cycle and Finding Fulfillment in Love, Marriage and Family*. New York: Bantam.

- Bearman, P. , & Brückner. H. (1999). Peer effects on adolescent sexual debut and pregnancy: an analysis of a national survey of adolescent girls, in: *Peer Potential: Making the Most of How Teens Influence Each Other*, Washington, DC: National Campaign to Prevent Teen Pregnancy, 7-26.
- Bears, M. A. (2009). Following the leader: Examining peer influence on sexual behavior. *Thesis submitted to the Faculty of the Graduate School of the University of Maryland, College Park, in partial fulfillment of the requirements for the degree of Master of Arts.*
- Beckwith, D. H. (2007). Risky behavior in college students:the influence of religiosity and spirituality. *A Dissertation Submitted to the Faculties of The College of William and Mary Eastern Virginia Medical School Norfolk State University Old Dominion University.*
- Beit-Hallahmi, B. (2004). Religion, Religiosity, and Gender. In Ember, C. R. & Ember, M. (Ed.), *Encyclopedia of sex and gender: Men and women in the world'scultures*. (f. 117-127). Norwell, MA: Kluwer Academic.
- Belsky, J. , Steinberg, L. & Draper P. (1991). Childhood experience, interpersonal development, and reproductive strategy: An evolutionary theory of socialization. *Child Development*. 62(4), 647-670.
- Berger, B. & Berger, P. L. (1983). *The War Over the Family*. Capturing the Middle Ground. Garden City, New York: Anchor Press/ Doubleday.
- Berman, S. M. , & Hein, K. (1999). Adolescents and STDs. InK. K. Holmes, P. ESparling, P. Mardh, S. M. Lemon, W. E. Stamm, P. Piot, & J. N. Wasserheit (Eds.), *Sexually transmitted diseases* (3rd ed.). NewYork: McGraw-Hill, f. 129-142.

- Bersamin, M. M. , Bourdeau, B. , Fisher, A. D. , Grube, J. W. (2010). Television Use, Sexual Behavior, and Relationship Status at Last Oral Sex and Vaginal Intercourse. *Sexuality & Culture* 14, 157–168.
- Biller, H. B. & Kimpton, J. L. (1997). *The father and the school aged child*. In M Lamb (Ed.), *The Role of the Father in Child Development* (3rd ed.). New York: John Wiley & Sons, f. 143-161
- Biller, H. B. (1993). *Fathers and Families: Paternal Factors in Child Development*. Greenwood Publishing Group, Inc.
- Billy, O. G. , Joseph, L. R. , Udry, J. R. (1984). Adolescent sexual behavior and friendship choice. *Social Forces*, 62:3, 653-678.
- Blanchard, R. W. & Biller H. B. (1973). Father availability and academic performance among third grade boys. *Developmental Psychology*, 4(3), 301-305.
- Blanton, J. , Hart, J. , Tonya, D. (2005). Peer influences on risk behavior: an analysis of the effects of a close friend. *Developmental Psychology*. 41(1): 135-147.
- Bleakley, A. , Hennessy, M. , & Fishbein, M. (2011). A Model of Adolescents' Seeking of Sexual Content in Their Media Choices. *Journal Of Sex Research*, 48(4), 309–315.
- Bleakley, A. , Hennessy, M. , Fishbein, M. , & Jordan, A. (2008). Itworks both ways: The relationship between exposure to sexualcontent in the media and adolescent sexual behavior. *Media Psychology*, 11, 443–461.
- Blum, R. W. , Beuhring, T. , & Rinehart, P. M. (2000). *Protecting teens: Beyond race, income and family structure*. Minneapolis, MN: Center for Adolescent Health, University of Minnesota, Vol, 12, 171-201.

- Boas, M. E. (2013). Inappropriate Lessons:Elementary Schools and the Social Organization of Sexuality. *A dissertation submitted in partial satisfaction of the requirements for the degree of Doctor of Philosophy in Education and the Designated Emphasis in Women, Gender, and Sexuality in the Graduate Division of the University of California, Berkeley.*
- Bogart, L. , Cecil, H. , Wagstaff, D. , Pinkerton, S. , & Abramson, P. (2000). Is it "sex"?: Collegestudents' interpretations of sexual behavior terminology. *The Journal of Sex Research. , 37(2), 108-117.*
- Boies, S. C. (2002). University students' uses of and reactions to online sexual information and entertainment: Links to online and offline sexual behaviour. *The Canadian Journal of Human Sexuality, 11(2), 59- 77.*
- Booth-Butterfield, M. & Sidelinger, R. (1998) The influence of family communications on the college-aged child: openness, attitudes and actions about sex and alcohol. *Communication Quarterly, 46, 295–301.*
- Brock, L. J. & Jennings, G. H. (1993). Sexuality education: what daughters in their 30s wish their mothers had told them. *Family Relations, 42, 61–65.*
- Brody, S. , Rau, El. , Fuehrer, N. , Hillebrand, H. , Rudiger, D. , & Braun, M. (1996). Traditional ideology as an inhibitor of sexual behavior. *Journal o f Psychology, 130, 615-626.*
- Brown, D. J. (2002). Mass Media Influences on Sexuality. *The Journal of Sex Research* Vol. 39: 1, f. 42-55.
- Brown, D. J. , & Bobkowski, P. S. (2011). Older and Newer Media: Patterns of Use and Effects on Adolescents' Health and Well-Being. *Journal Of Research On Adolescence, 21(1), 95 – 113.*

- Brown, D. J. , & Keller, S. N. (2000). Can the Mass Media Be Healthy? *Sex Educators, Vol 32, No5*, 187-225.
- Brown, E. F. , & Hendee, W. M. (1989). Adolescents and their music: Insights into the health of adolescents. *Journal of American Medical Association*, 262, 1659-1663.
- Brown, J. D. , & Newcomer, S. F. (1991). Television viewing and adolescents' sexual behavior. *Journal of Homosexuality*, 21(1/2), 77–91.
- Brown, J. D. , & Steele, J. R. (1995). *Sex and the mass media*. Menlo Park, CA: Kaiser Family Foundation.
- Brown, J. Steele, J. , & Walsh-Childers, K. (2001). *Sexual teens , sexual media: Investigating media's influence on adolescent sexuality*. Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.
- Browning, C. R. , Leventhal, T. , & Brooks-Gunn, J. (2004). Neighborhood context and racial differences in early adolescent sexual activity. *Demography*, 41(4), 697-720.
- Brown, J. , & Newcomer , S. (1991). Television viewing and adolescents' sexual behavior. *Journal of Homosexuality*, 21 (1), 77-91.
- Bryant, P. , & Bryant, J. A. (2005). Adolescents and the internet. *Adolescent Medicine Clinics*, 16: 2, 413-430.
- Buerkel-Rothfuss, N. L. (1993). *Background: What prior research shows*. In B. Greenberg, J. Brown, & N. L. Buerkel-Rothfuss (Eds.). *Media, sex, and the adolescent*. Cresskill, NJ: Hampton Press, Inc. f. 5–18
- Buhi, E. , & Goodson, P. (2007). Predictors of adolescent sexual behavior and intention: A theory-guided systematic review. *Journal of Adolescent Health*, 40, 4–21.
- Burdette, A. M. , Ellison, C. G. , Hill, T. D. , & Glenn, N. D. (2009). Hooking up at college: Does religion make a difference? *Journal for the Scientific Study of Religion*, 48:3, 535-551.

- Burris, J. L. , Smith, G. T. , & Carlson, C. R. (2009). Relations among religiousness, spirituality, and sexual practices. *The Journal of Sex Research*, 46:4, 282-295.
- Byers, E. S. , Sears, A. H. , & Weaver, A. W. (2008). Parents' Reports Of Sexual Communication With Children In Kindergarten To Grade 8. *Journal Of Marriage And Family*, 70: 86–96.
- Byno, L. H. , Mullis, R. L. , & Mullis, K. (2009). Sexual Behavior, Sexual Knowledge, And Sexual Attitudes Of Emerging Adult Women: Implications For Working With Families. *Journal Of Family Social Work*, 12:309–322.
- Carvajal, S. C. , Parcel, G. S. , Hasen-Enquist, K. , Banspach, S. W. , Coyle, K. K. , Kirby, D. , & Chan, W. (1999). Psychosocial predictors of delay of first sexual intercourse by adolescents. *Health Psychology*, 18, 443-452.
- Carr, D. (1987). Freud and Sexual Ethics. *Philosophy*, Vol. 62, No. 241, 361-375.
- Carroll, J. S. , Padilla-Walker, L. M. , Nelson, L. J. , Olson, C. D. , McNamara B. C. , & Madsen, S. D. (2008). Generation XXX: Pornography acceptance and use among emerging adults. *Journal of Adolescent Research*, Vol. 23: 1, 6-30.
- Castaneda, D. , & Bums-Glover, A. (2004). *Gender, sexuality, and intimate relationships*. In *Praeger guide to the psychology of gender*, 69-91. Westport, CT: Praeger Press.
- Chapin, J. R. (2000). Adolescent sex and mass media: A developmental Approach. *Adolescence*, Vol. 35, No, 140-156.
- Chia, S. , & Gunther, A. (2006). How media contribute to misperceptions of social norms about sex. *Mass Communication & Society*, 9, 301–320.
- Chng, C. L. , & Moore, A. (1994). AIDS: Its effects on sexual practices among homosexual and heterosexual college students. *Journal of Health Education*, 25, 154-160.
- Clayton, R. R. (1969). Religious orthodoxy and premarital sex. *Social Forces*, 47, 469 – 474.

- Cochran, J. K. , Chamlin, M. B. , Beeghley, L. , & Fenwick, M. (2004). Religion, religiosity, and nonmarital sexual conduct: An application of reference group theory. *Sociological Inquiry*, 30, 45–62.
- Coleman, J. S. (1986). Social Theory, Social Research and a Theory of Action. *American Journal of Sociology* , 91:1309–1335.
- Colleen, B. (2010). Adolescence, pornography and harm. *Youth Studies Australia*, 29:1, 19-27.
- Collins, R. (1981). On the Microfoundations of Macrosociology. *American Journal of Sociology*, 86: 984–1014.
- Collins, R. , Elliot, M. , & Miu, A. (2009). *Linking media content to media effects: The RAND Television and Adolescent Sexuality (TAS) study*. In A. Jordan, D. Dunkle, J. Manganello, & M. Fishbein (Eds.), *Media messages and public health: A decision approach to content analysis*. New York: Routledge, f. 154–172.
- Collins, W. A. (2003). More than myth: The developmental significance of romantic relationships during adolescence. *Journal of Research on Adolescence*, 73:1, 1- 24.
- Cooper, A. , Scherer, C. R. , Boies, S. C. , & Gordon, B. L. (1999). Sexuality on the internet: From sexual exploration to pathological expression. *Professional Psychology: Research and Practice*, 30, 154-164.
- Cooper, M. L. , Shapiro, C. M. , & Powers, A. M. (1998). Motivations for sex and risky sexual behavior among adolescents and young adults: A functional perspective. *Journal of Personality and Social Psychology*, 75, 1528-1558.
- Coreil, J. & Parcel, G. S. (1983). Sociocultural determinants of parental involvement in sex education. *Journal of Sex Education and Therapy*, 9, 22–25.

- Courtright, J. A. & Baran, S. J. (1980). The Acquisition of Sexual Information by Young People. *Journalism Quarterly*, 57, 107-114.
- Coyle, K. K. , Kirby, D. , Martin, B. V. , Gomez, C. A. , & Gregorich, S. E. (2004). Draw the line/respect the line: a randomized trial of a middle school intervention to reduce sexual risk behaviors. *American Journal of Public Health*, 94(5), 843-851.
- Coyle, K. , Basen-Enquist, K. , Kirby, D. , Parcel, G. , Banspach, S. , Harrist, R. (1999). Short-term impact of Safer Choices: a multicomponent, schoolbased HIV, other STD, and pregnancy prevention program. *Journal of School Health*, 69(5), 181-188.
- Crawford, M. , & Popp, D. (2003). Sexual double standards; a review and methodologicalcritique of two decades of research. *Journal of Sex Research*, 40, 12-26.
- CyberAtlas (2001). Search engines, browsers still confusing many web users. Marrë në: <http://cyberatlas.internet.com> (Parë më: 12.02.2013)
- Cyr, L. , & Willis, K. (2010). Sex and God: The Impact of Religiosity on the Sex-Related Decisions of College Students. *American Sociological Association, Atlanta Georgia*.
- Cyranowski, J. M. , & Andersen, B. L. (2000). Evidence of self-schematic cognitive processing in women with differing sexual self-views. *Journal o f Social & Clinical Psychology*, 19, 519-543.
- Darling, C. A. , & Hicks, M. W. (1983). Recycling parental sexual messages. *Journal of Sex & Marital Therapy*, 9:3, 233-243.
- Davidson, J. K. , Moore, N. B. , & Ullstrup, K. M. (2004). Religiosity and sexual responsibility: Relationshipsof choice. *American Journal of Health Behavior*, 28, 335 – 346.

- Davidson, J. K. , Nelwyn Sr. , Moore, B. , Earle, J. R. , & Davis, R. (2008). Sexual Attitudes And Behavior At Four Universities: Do Region, Race, And/Or Region Matter? *Adolescence*, Vol. 43, No. 170, 128-144.
- Davidson, J. K. , Sr. , Moore, N. B. , & Ullstrup, K. M. (2005). Religiosity and sexual responsibility: Relationships of choice. In J. K. Davidson & N. B. Moore (Eds.), *Speaking of sexuality: Interdisciplinary Readings*. Los Angeles: Roxbury Publishing Company. f. 362-369.
- Davies, J. M. & Frawley, M. G. (1994). *Treating the Adult Survivor of Childhood Sexual Abuse: A Psychoanalytic Perspective*. New York; Basic Books.
- Davis, C. , Sloan, M. , MacMaster, S. , & Kilbourne, B. (2007). "HIV/AIDS knowledge and sexual activity: An examination of racial differences in a college sample. *Health and Social Work*, 32: 211-218.
- Day, R. D. (1992). The transition to first intercourse among racially and culturally diverse youth. *Journal of Marriage and the Family*, 54, 749-762.
- Di Blasio, E. A. , & Benda, B. B. (1992). Gender differences in theories of adolescent sexual activity. *Sex Roles*, 27, 221-239.
- DiIorio, C. , Kelley, M. , & Hockenberry-Eaton, M. (1999). Communication about sexual issues: Mothers, fathers, and friends. *Journal of Adolescent Health*, 24, 181-189.
- Dilorio, C. , Resnicow, K. , Dudley, W. N. , Thomas, S. , Wang, D. T. , Van Marter, D. F. , Manteuffel, B. , & Lipana, J. (2000). Social cognitive factors associated with mother-adolescent communication about sex. *Journal of Health Communication* 5, No. 1: 41-51.
- Dobson, J. (1982). *Dr. Dobson answers your questions*. Wheaton, IL: Tyndale House Publishers, Inc.

- Donnelly, J. , Duncan, D. F. , Goldfarb, E. , & Eadie, C. (1999). Sexuality attitudes and behaviors of self-described very religious urban students in middle school. *Psychological Reports*, 85, 607-610.
- Doran, R. M. (1977). *Subject and psyche: Ricoeur, Jung and the search for the foundations*. Washington, DC: University Press of America.
- Downie, J. , & Coates, R. (1999). The impact of gender on parent-child sexuality communication: Has anything changed? *Sexual and Marital Therapy*, 14(2), 109- 121.
- Drew, L. C. (2012). Influential factors on adolescent males' non-relational sexual attitudes and behavior. *A Doctoral Dissertation Research Submitted to the Faculty of Argosy University San Francisco Bay Area College of Psychology of Behavioral Science In Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Education, Counseling Psychology*.
- Du Bois-Reymond, M. , & Ravesloot, J. (1996). The roles of parents and peers in the sexual and relational socialization of adolescents. In K. Hurrelmann & S. Hamilton(Eds.), *Social problems and social contexts in adolescence* (175-197). New York: Aldine De Gruyter.
- Durkheim, E. (1951). *Suicide, a Study in Sociology*. Glencoe, IL: The Free Press.
- Durkheim, E. (1995). *The Elementary Forms of the Religious Life*. New York: The Free Press.
- Durkin, K. F. (1997). *Implicit content and implicit processes in mass media use*. In K. Kirsner, C. Speelman, M. Mayberry, A. Obrien-Malone, M. Anderson, & C. Mcleod (eds.), *Implicit and explicit mental processes*(273-390). Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum.
- Dutra, R. , Miller, K. S. , & Forehand, R. (1998). The process and content of sexual communication with adolescents in two-parent families: *Associations with sexual risk taking behavior*. *AIDS and Behavior*, 3(1), 59-66.

- Pluhar, E. I. , DiIorio C. K. , & McCarty, F. (2008). *Correlates of sexuality communication among mothers and 6–12-year-old children. Child: care, health and development*. Blackwell Publishing Ltd.
- Earle, J. R. , Perricone, P. J. , Davidson, J. K. , Moore, N. B. , Harris, C. T. , & Cotten, S. R. (2007). Premarital sexual attitudes and behaviors at a religiously-affiliated university: Two decades of change. *Sexuality and Culture*, 11(2), 39-61.
- Eaves, S. H. (2007). Attachment style, self-esteem, and perceived peer norms as predictors of sexually risky behavior among 17-24 year old college students. *A Dissertation Submitted to the Faculty of Mississippi State University in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Doctor of Philosophy in Education in the Department of Counseling, Educational Psychology, and Special Education Mississippi State, Mississippi*.
- Edger, K. (2012). Evangelicalism, Sexual Morality, and Sexual Addiction: Opposing Views and Continued Conflicts. *Journal of Religion & Health*, 51:162–178.
- Eggermont, S. (2005). Young adolescents' perceptions of peer sexual behaviors: The role of television viewing. *Child: Care, Health and Development*, Vol. 31, No. 4, 459–468.
- Ekerwald, H. (1995). *Unpublished report, Uppsala University*. Department of Sociology, 30, 222-253.
- Elia, J. P. , & Eliason, M. J. (2010). Dangerous omissions: Abstinence-only-until-marriage school-based sexuality education and the betrayal of LGBTQ youth. *Journal of Sexuality Education*, 5, 17-35.
- Elliot, E. (2006). *Passion and purity: Learning to bring your love life under Christ's control*. Grand Rapids, MI: Fleming H. Revell.

